Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7-8 (179-180) KORRIK-GUSHT 2021. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
PESHKOPI MAQELLARË
MBI 100 PRODUKTE 1+1 FALAS
— Faqe 24

TURIZËM

Lura - shtatë sy të kaltër me qerpikë të gjelbër

Nga **GJERGJ MARKU** — Faqe 5

SPORT

Një "kala" në Kalanë e Bashtovës

Ismail Keta i ka dhënë sportit të boksit kampionë të mëdhenj

Nga **GAFUR MUKA** — Faqe 13

SPORT

Luiza - kampionia olimpike përpara së cilës duhet të ndjehemi të turpëruar

Nga **ARBEN MALAJ** — Faqe 12

BOTIME

Këngë dhe fjalë të urta popullore

Tubë këngësh e fjalësh të urta popullore, të mbledhura në krahinën e Ujemujës

Nga **FEJZULLA GJABRI** — Faqe 17

VLERËSIM



Akademiku shqiptaro-britanik Gëzim Alpion nderohet me Dekoratën "Nënë Tereza"

— Faqe 10



"Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj"

Monografia "Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj" është studimi më i fundit i Gëzim Alpion për figurën dhe personalitetin e humanistes së madhe shqiptare.

Nga **ARBEN ÇOKAJ** — Faqe 11

Hidhet asfalt në RRUGEN E ARBRIT, por trafiku i makinave është akoma i kufizuar



Me gjithë premtimet për nisjen e trafikut gjatë verës së këtij viti, përmes bypass-it që kalon nga Qafa e Murrizës, kjo nuk është e mundur për të gjithë qytetarët. Lëvizja mbetet një privilegj për zyrtarët lokalë, deputetët, njerëzit pranë qeverisë dhe të afërmit e tyre. — Faqe 2-3

REPORTAZH

ZERQANI, fshati që duhej të ishte turistik, por që po braktiset çdo ditë

Fshati Zerqan në Bashkinë e Bulqizës është përzgjedhur si një nga fshatrat turistik në programin e qeverisë, për t'i dhënë një fytyrë të re turizmit në këtë zonë, por mesa duket edhe në terren, investime në kuadër të këtij projekti ambicioz nuk kanë ardhur ende deri në këtë zonë, duke i bërë banorët skeptik për procesin.

Nga **DRITAN KURTI** — Faqe 6

NË BRENDËSI:

■ Dibranët në diasporë mbledhin **ndihma për spitalin** e Dibrës së Madhe ■ **Shqipëria** ka bukuri të pamata ■ Libri "Kongresi i Dibrës" **i Qenan Zija Manastirit**, dokumenti monumental ■ Me **Ulvi Shehun**, dibranin që më bëri mik të librit ■ **Zeni Talja** i Dibrës së Madhe, modeli i modestisë dhe i bujarisë ■ Gëzuar festën Dibër! ■ Kush e shëmton bulevardin "**Elez Isufi**"?! ■ Ansambli Artistik "**Hazis Ndreu**"- "Nderi i Kombit" fiton çmimin e parë në Festivalin e Deçanit ■ **Shi lotësh** te praku i derës ■ **Një libër** për traditat, fisnikërinë dhe vlerat kombëtare ■ "Histori qëndrese" në romanin e katërt të **Dogjan Dervishit** ■ Bota fëmijënore në poezinë e **Selim Çerpes** ■ Këmisha e **njeriut të lumtur** ■ **Arif Vladi**, këngëtari emblematik i Lurës... ■ **Disa mbiemra** në trevën e Dibrës ■ **Vasilika Vladi**, bija e Lurës, që i kishte hije fisnikëria... ■ Dr. **Fatmir Doda**, mjeku i përkushtuar, personaliteti mjekësisë shqiptare

Rruga e Arbërit | rrugaearberit | Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 179 180

vëzhgim

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 7-8 (179-180). Korrik-Gusht 2021
Gazeta doli nga shtypi, 4 shtator 2021.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit shtator 2021.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Dritan KURTI
Frank SHKRELI
Arben ÇOKAJ
Selman MËZIU
Fejzulla GJABRI
Haki PËRNEZHA
Valdrin VLESHA
Xheladin ÇEKA
Halil RAMA
Gëzim LOKA
Beqir SINA
Mevlud BUCI
Ilmi DERVISHI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.



**Pamje nga rruga e asfaltuar në Xibër, mat.
Pas bllokimit të rrugës për disa javë menjëherë pas zgjedhjeve, trafiku ka filluar të lëvizë sërish, megjithëse rruga vazhdon të ketë akoma statusin e një kantieri ndërtimi.
Foto e datës 2 shtator 2021.**

Hidhet asfalt në RRUGËN E ARBRIT, por trafiku i makinave është akoma i kufizuar

Me gjithë premtimet për nisjen e trafikut gjatë verës së këtij viti, përmes bypass-it që kalon nga Qafa e Murrizës, kjo nuk është e mundur për të gjithë qytetarët. Lëvizja mbetet një privilegj për zyrtarët lokalë, deputetët, njerëzit pranë qeverisë dhe të afërmit e tyre.

Nga **BUJAR KAROSHI**

"Kur të piqen qershitë, do të më thoni mua dhe do t'ju lejojmë të kaloni nga rruga e re, në mënyrë që ta kapni pazarin e Tiranës sa më shpejt".

Kështu premtonte një kandidat për deputet në prill 2021, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare. Dhe kjo ishte e besueshme gjatë fushatës, pasi rreth 200 makina në ditë kalonin trarët e vendosur gjatë kantierit të ndërtimit përgjatë Rrugës së Arbrit nga Klosi deri në Qafën e Tujanit në Tiranë.

Por kalimi i makinave në këtë aks gjatë fushatës elektorale ka sjellë shqetësime për drejtuesit e kompanisë, aq sa presidenti i kompanisë "Gjoka Konstruksion", Rrok Gjoka, ia shprehu shqetësimin kryeministrit Rama gjatë vizitës në kantier me 14 prill 2021.

"Për tu vu në qarkullim, duke marrë parasysh bashkëpunimin, bëhet shumë shpejt. Nga tuneli i Murrizit tek Ura e Vashës ne kemi edhe 1-2 muaj punë. Pastaj e gjithë rruga është e shtruar me asfalt, përveç Planit të Bardhë dhe atij segmentit rreth 2 km në Qafë të Tujanit. Kam hallin e trafikut, por njerëzit nuk e kuptojnë, vijnë dhe zihen me rojet"...

Prej atëherë kanë kaluar 4 muaj, por punimet nuk kanë mbaruar. Aksi lidhës me Klosin, rreth 3 km, nuk ka mbaruar ende, ndërsa vazhdojnë punimet për hapjen e tunelit të Murrizit. Fushatë përpara nuk duket të ketë, ndaj edhe premtimet për hapjen e rrugës për trafik nuk duken në skenë.

Premtimet për hapjen e qarkullimit të mjeteve nisën që tre vjet më parë, më 17 qershor 2018, kur u zhvillua ceremonia e inaugurimit të punimeve në Klos.

"Do ta hapim rrugën 6 muaj para afatit", pati premtuar presidenti i kompanisë ndërtuese.

Këtë premtim ia kujtoi kryeministri presidentit të kompanisë edhe më 9 qershor 2019, gjatë një vizite në kantierin e rrugës, tek Ura e Vashës. Pyetjes së kryeministrit se kur do të mbarojë, ministrja Balluku iu përgjigj: Nëntor 2021.

"Jo, jo - ia ktheu kryeministri. Ju nuk keni qenë fare atëherë" dhe, duke iu drejtuar presidentit të kompanisë Gjoka, i tha: "Ne e kemi lënë këtë në pranverën e 2021".

Disa ditë më pas, më 15 qershor 2020, kryeministri njoftoi nisjen e asfaltimit në 10 km e para të rrugës, ai shkroi në faqen e tij në facebook se rruga "pritet të jetë e aksesueshme brenda verës së vitit 2021!".

Të njëjtin qëndrim për nisjen e qarkullimit në rrugë e ka mbajtur edhe ministrja e Infrastrukturës, Belinda Balluku. Gjatë analizës vjetore të kësaj Ministrie në tetor 2020, ajo tha se "mes rrugëve që duhen përfunduar gjatë 2021 është Rruga e Arbrit, e cila do të përfundojë përpara afatit të parashikuar".

Të njëjtin besim për përfundimin e punimeve para afatit ka shfaqur edhe Elisa Spiropali, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. "Rruga e Arbërit do të përfundonte para zgjedhjeve të 25 prillit (2021)", deklaroi ajo në emisionin "Zonë e Lirë" në TV Klan.

Që nga mesi i vitit 2019, kur u shemb një pjesë e tunelit të Murrizit, afatet zyrtare për përfundimin e punimeve mbeten të paqarta.

Ministrja Belinda Balluku në emisionin "Absolut 2" në televizionin A2, tha, megjithëse nuk ishte e sigurt, se afati i kontratës është deri në nëntor 2022".

ECURIA E PUNIMEVE NË RRUGËN E ARBRIT

Segmenti 1: Dalje në Tiranë - Ura e Brarit, 1.153 km: **E asfaltuar.**
Segmenti 2 : Ura e Brarit - Zall Bastar, me 5.46 km: **E asfaltuar pjesërisht. 2 km akoma e pa asfaltuar.**
Segmenti 3: Zall Bastar – Dalja e Urës së Vashës, 23.188 km. **E hapur për trafikun dhe e asfaltuar.**
Segmenti 4: Dalja e Urës së Vashës – Bulqizë, me gjatësi L=9.715 km. **E mbyllur për trafikun. E pa asfaltuar.**
Segmenti 5: Bulqizë-Ura e Çerenecit, me L=20.12 km, i përfunduar në v. 2009 dhe 2011 ***(E hapur për trafikun. Nuk është pjesë e koncesionit).***
Segmenti 6 Urën e Çerenecit - Maqellarë - Pika kufitare Bllatë; 9.111 km: **Jo zyrtarisht, e hapur për trafikun. E asfaltuar.**
Segmenti D (7): Maqellarë-Pika kufitare Bllatë - **E hapur për trafikun. E asfaltuar.**
Segmenti K (8) Dalje Ura e Vashës - Klos, me L= 3.092 km. **Në proces ndërtimi.**



Hyrja në Tunelin e Murrizit në Xibër, Mat. Punimet priten të mbyllen në dhjetor 2021.

aktualitet



Pamje nga sheshi i ndërtimit përpara hyrjes në tunelin e Murrizit. Deri më tani thuhet se kompania ka realizuar mbi 75% të punimeve. Tuneli i Murrizit, vepra më e rëndësishme e këtij aksi rrugor, parashikohet që dy anët e tij të bashkohen në fund të këtij viti. Foto e datës 2 shtator 2021.

Pas bllokimit të rrugës për disa javë menjëherë pas zgjedhjeve, trafiku ka filluar të lëvizë sërish, megjithëse rruga vazhdon të ketë akoma statusin e një kantieri ndërtimi. "Përderisa rruga ka statusin e një kantieri ndërtimi, aty nuk duhet të lëvizë asnjë makinë, përveç atyre të punës", tha një ekspert i sigurisë rrugore për gazetën.

Më 19 prill 2021, në një përgjigje të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për *faktoje.al* thuhet se "përfundimi i punimeve në total sipas kontratës është në prill 2022. Sipas ecurisë së faktit pritshmëritë dhe mundësitë janë edhe më herët se ky afat".

Por, ndërkohë që zgjatet afati, nuk u la asnjë fije dyshimi se qarkullimi do të niste më herët. Kompania dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ranë dakord për asfaltimin e by-passit, 9 km të gjatë, e cila do të mundësonte nisjen e trafikut para mbarimit të tunelit të Murrizit.

"Kemi folur me ministren për një zgjidhje, e cila më kushton mua, por përfitojnë fshatrat që lidhin Xibrin me Bastarin" – tha Rrok Gjoka në prill 2020, gjatë një vizite të kryeministrit Rama dhe ministres Balluku në kantier. Sipas tij, do të ndërtohet një by-pass 9 kilometra, i cili do të bëjë bashkimin nga njëra anë e tunelit në anën tjetër.

***

Zyrtarë lokalë dhe njerëz pranë qeverisë nuk kanë ngurruar vazhdimisht të bëjnë publikë në rrjetet sociale "besimin dhe durimin që duhet kemi te kryeministri Edi Rama, si burrë i fjalës së mbajtur". Kur ata kalojnë nga rruga, hedhin fotografitë e tyre bashkë me lavdet për kryeministrin dhe urimin: "Ta gëzojnë dibranët e matjanët rrugën".

Për nisjen e qarkullimit në rrugë kërkohet një vullnet bashkëpunimi me kompanisë ndërtuese dhe qeverisë. Ndërsa deputetët, të zgjedhurit vendorë dhe zyrtarët lokalë, përpara se ta përfitojnë lëvizjen në këtë rrugë si privilegj të pushtetit, duhet të ushtrojnë presion te institucionet vendimmarrëse që rruga të jetë e lirë për publikun sa më shpejt të jetë e mundur.

KOSTO E RRUGËS: 33.6 MILIARDË LEKË

Buxheti i shtetit ka paguar deri më tani mbi 7.5 miliardë lekë

Rruga e Arbërit është dhënë me koncesion nga qeveria shqiptare për 13 vite, ku përfshihet ndërtimi dhe mirëmbajtja gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Kontrata është miratuar nga Këshilli i Ministrave më 28 mars 2018 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare më 11 prill 2018.

Kompania ka marrë një kredi nga Banka Kombëtare Tregtare me një garanci shtetërore në kuadër të programit të qeverisë shqiptare për infrastrukturën, të njohur ndryshe si programi "1 miliardë dollarë".

Kompania "Gjoka 87", duke nisur nga 22 janar 2019, ka marrë deri më tani 7 miliardë e 560 milionë lekë (mbi 61 milionë euro), ndarë në këste të barabarta prej 630 milionë lekësh.

Kosto totale e rrugës, sipas kontratës së firmosur në vitin 2018 është 33.6 miliard lekë.

Revista "Monitor" e specializuar në lajmet ekonomike, pati njoftuar në nëntor 2019 se, pas shembjes së Tunelit të Murrizit, kosto e rrugës ishte rritur me 45 %, pra nga 33.6 miliardë lekë në 58 miliardë (460 milionë euro), por kjo shifër është kundërshtuar nga autoritetet zyrtare.

Ish-kryeministri Erion Braçe më 25 prill 2020 publikon një foto të Urës së Fshatit Fshat në ndërtim, ku mes të tjerash shkruan se rruga e Arbrit kushton 33.6 miliardë lekë. Të njëjtën shumë konfirmon edhe Ministria së Infrastrukturës dhe Energjisë për *faktoje.al*.

Deri më tani thuhet se kompania ka realizuar mbi 75% të punimeve. Tuneli i Murrizit, vepra më e rëndësishme e këtij aksi rrugor, parashikohet që në fund të këtij viti të bashkohen dy anët e tunelit.



Pamje nga Tuneli T3 i Rrugës së Arbërit. Në sfond ura e fshatit Fshat. Asfaltimi i rrugës në këtë segment nisi në korrik dhe ka mbaruar në gusht 2021.



Zyrtarë lokalë dhe njerëz pranë qeverisë nuk kanë ngurruar vazhdimisht të bëjnë publikë në rrjetet sociale "besimin dhe durimin që duhet kemi te kryeministri Edi Rama, si burrë i fjalës së mbajtur". Kur ata kalojnë nga rruga, hedhin fotografitë e tyre bashkë me lavdet për kryeministrin dhe urimin: "Ta gëzojnë dibranët e matjanët rrugën".

Në realitet, fjala e mbajtur ka qenë vetëm për të zgjedhurit vendorë, zyrtarë lokalë, deputetët apo ndonjë i "fortë" pranë tyre, ndërsa populli duhet të vazhdojë t'ia mbajë nga rruga e vjetër.

Pas bllokimit të rrugës për disa javë menjëherë pas zgjedhjeve, trafiku ka filluar të lëvizë sërish, megjithëse rruga vazhdon të ketë akoma statusin e një kantieri ndërtimi.

Gjatë një vëzhgimi në terren me 2 shtator, nga ora 14.00 deri në orën 16:00, mbi 40 makina kaluan Qafën e Murrizit.

"Përderisa rruga ka statusin e një kantieri ndërtimi, aty nuk duhet të lëvizë asnjë makinë, përveç atyre të punës", tha një ekspert i sigurisë rrugore për gazetën.

Ne iu drejtuam në emailin zyrtar kompanisë për një leje për ta vizituar zyrtarisht kantierin dhe për të marrë informacion më të hollësishëm për ecurinë e punimeve, por nuk morëm përgjigje.

Një burim pranë kompanisë tha në kushtet e anonimatit se "rruga tashmë mund të hapet që nesër, por janë shërbimet e policisë rrugore që nuk janë të gatshme për ta marrë rrugën nën kontroll".

Gjatë këtij viti ka pasur disa aksidente në disa segmente të rrugës, me pasojë tre të vdekur dhe dy të plagosur.

"Aksidentet kanë ndodhur si pasojë e shkeljeve të rregullave të qarkullimit, - tha një ekspert i sigurisë rrugore. Në rrugë mungojnë pothuajse krejtësisht tabelat informuese, sinjalistika e përkohshme si dhe vizimet në rrugë".

"Aksidente në rrugë do të ketë edhe kur ajo do të vihet në shfrytëzim, tha eksperti, për sa kohë ka drejtues mjetesh që nuk i respektojnë rregullat e qarkullimit, por kjo nuk duhet të shërbejë si pengesë për hapjen e rrugës për trafikun e makinave".

Më herët këtë vit u vu në shfrytëzim by-passi i Vlorës, megjithëse punimet nuk kanë përfunduar.

Për nisjen e qarkullimit në rrugë kërkohet një vullnet bashkëpunimi me kompanisë ndërtuese dhe qeverisë. Ndërsa deputetët, të zgjedhurit vendorë dhe zyrtarët lokalë, përpara se ta përfitojnë lëvizjen në këtë rrugë si privilegj të pushtetit, duhet të ushtrojnë presion te institucionet vendimmarrëse që rruga të jetë e lirë për publikun sa më shpejt të jetë e mundur.

Rruga e Arbërit nr. 179-180

BUJTINAT MIKPRITËSE



BUJTINA KONAKU I DIBRËS
Vendndodhja: **Tomin** Tel: **0692053492**
E-mail: **aminasalkurti@gmail.com**



BUJTINA E JUFKAVE
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **069 937 7337**
E-mail: **agro_zerja@yahoo.com**



GUEST HOUSE SABRIU
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 511 4003**
E-mail: **guesthousesabriu@gmail.com**



KULLA HUPI
Vendndodhja: **Dushaj, Bulqize**
Tel: **068 837 3793**
E-mail: **kullahupi5@gmail.com**



BUJTINA ARBRI
Vendndodhja: **Arras, Fushë-Çidhën**
Tel: **068 650 6061**
E-mail: **markuvladimir@yahoo.com**



GUESTHOUSE TERSHANA
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **0218 20306**
E-mail: **bujtina.tershana@outlook.com**



BUJTINA GOLECI
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 642 9888**
E-mail: **fitimgoleci1@gmail.com**

Lura - shtatë sy të kaltër me qerpikë të gjelbër



Nga **GJERGJ MARKU**

LURA - Shtatë sy të kaltër me qerpikë të gjelbër. Duhet të jetë ndër simbolikat më të goditura për këtë vend të mrekullueshëm. Lura është quajtur si perla e maleve shqiptare. Historianë të huaj, kalimtarë e udhëpërshkrues, i ka lënë pa mend kjo bukuri e rrallë. Austriaku Stinmestz shkruan se "Pamja nën shkëmbin e Kunorës është kaq e këndshme sa s'ka shoqe në tërë Shqipërinë", ndërsa një mjeshtër projektesh sportive, që kishte ardhur të shihte këndej thotë se "për dy ditë isha në Zvicrën e Shqipërisë, aty ku Zoti ka falur shumë, ndërsa njeriu ka punuar pak". Ndërsa aty nga viti 1908 Edit Durham do të shënonte në ditarin e saj se "kur dola në Qafë Lurë, pashë një fushë kaq të bukur, që nuk e kisha parë në asnjë vend të Ballkanit".

Kush është në të vërtetë Lura? Mjafton të ngjitesh në Majën e Kurorës, 2121 metra e lartë, ku syri të kap një hapësirë të gjerë, para ke një "det" të tërë me male dhe lugina. Shikon prej këtu tërë vargun lindor të maleve që matanë kufirit, të cilat vijnë vargas: Kërçini, Skërteci, Korabi, Sorokoli, Gjallica e Lumës e deri malet e Hasit. Nga veriu shikon malet e Mirditës e të Shkodrës, kurse nga jugu, me një dylbi kundron edhe Durrësin deri thellë në det.

Mbi 1800 metra ndodhet Guri i Neshtës, një shkëmb interesant, ndër shekuj prej andej janë shembur miliona metër kub gurë, këtu gjindet dhe Lerasi ku dëbora është gjithëstinore, një çudi më vete kjo. Poshtë Gurit të Neshtës vijnë një pas një liqenet e bukur të Lurës, ose "sytë e kaltër" të natyrës. Më duhet t'i përshkruaj këto liqene si të ishin para 15 vitesh në ekosistemin e plotë rrethues të tyre. Më i moçmi është Liqeni i Madh, rreth 8 ha, i veshur dikur rreth e rrotull me pisha. Në të tri anët e tij ka lëndina dhe kodrina të ngritura butas, kurse nga perëndimi mali vjen e ngrihet thiktasi. Ç'mund të bëjë këtu dorë e njeriut, me motele e hotele, ngrehina alpine për rrotull tij dhe ato që mund të shtrihen me panela mbi ujët e kthjellët; rreth e qark me burime të bollshme uji të pijshëm.

Ka legjenda të thurura kushedi se në ç'kohë ky liqen. Thonë se dikur jetonte këtu "e bukura e liqenit", kjo dilte në breg dhe kur shihte njeri zhdukej në ujë. I zoti i Liqenit (lurasit i kanë vënë dhe emrin Kolë Koçeku), e diktoi dhe për ta zënë, mori një këmishë pa grykë, një pasqyrë dhe një krëhër, i vendosi aty ku ajo dilte. Një ditë ajo doli, mori pasqyrën dhe filloje të krihej, pastaj veshi këmishën. Kola i fshehur diku, tërhoqi litarin e lidhur në këmishë dhe e zuri të bukurën e liqenit, për ta çuar në shtëpinë e tij. Pas një kohe lindi djalë, por ajo nuk fliste. Dikush e mësoj Kolën, të tentonte të therte djalin. Befas "e bukura e liqenit" bërtiti fort. Ajo i tha Kolës që të priste një vit, atëherë të mirat do t'i vinin pa masë. Dhe ra e vdiq bashkë me djalin duke e nemun Kolën.

Nuk e di se si e ka mbledhur këtë gojëdhënë pasardhësi i Koçekëve, por sa herë kaloj m'atanë më duket se më shungullon në veshë ajo legjendë e hershme, dhe kur je aty pranë të duket vetja se je në pritje të daljes nga uji të ndonjë zane!...

Legjenda kanë në vetvete dhe liqenjtë e tjerë. Nuk mund të ngelnin këto bukuri akullnajore pa legjenda e gojëdhëna të atribuara. Në veri vjen Liqeni i Rrasave e pak më tutje ai i Lopëve, me një pamje shumë të bukur të rrethuar me livadhe e pyje. Mesi i tij është shumë i thellë, mendohet që këtu sipas gojëdhënave të përcjella, të jetë mbytur një lopë me 12 qe, ndaj mori këtë emër. M'atanë liqenit është Blaçi, një lëndinë shumë e bukur me ujëra të ftohta, ndërsa ujë i Krojit të Bardhë është shumë kurativ për gurët në veshka.

Në jug të Liqenit të Madh vjen Liqeni i Bruçit, me një pamje përrallore nga sipër ku shquan uji i kristaltë, rrethuar me pisha dhe ahe të lartë. Po nga jugu vijnë liqeni i Hotit, ata të Kallabës dhe pak më tej Liqeni i Zi, me ngjyrë tepër të kaltërt dhe i rrethuar me pisha të dendura e lëndina ku buron dhe ujë i ftohtë. Nga liqenet lurasit marrin dhe ujin e bollshëm në dimër për të vënë në punë turbinat e dy hidrocentraleve të vegjël.

Ngrihesh pak më sipër dhe para ke një ndër "mrekullitë e botës", një margaritar i vërtetë. Liqeni i Luleve, në mes të një lëndine të butë, mbushur me bar të jeshiltë dhe hijeshuar me lule të shumta shumëngjyrëshe. Liqeni, sidomos në pranverë është i mbushur tej e tej me një lloj zambaku, një pamje mahnitëse. Pylli rreth e rreth ka qenë tepër i bukur, nuk mund të gjeje vend të dytë si këtu.

Tërë ky brezar liqenesh dhe pyllnajesh ka qenë i jashtëzakonshëm, me pamje magjepsëse. Dhe kështu ulesh deri poshtë në qendër Lurë. Pak më në jug të liqenit të Luleve vjen Fusha e Pelave, rreth 7 kilometra lëndinë e mrekullueshme. Prej kohësh duhet të jetë banuar ky vend, ose së paku të ketë patur fushime, madje gojëdhëna thotë se ky vend ka qenë vendqëndrimi dhe përgatitjeje ushtarake për kalorës dhe kuaj, ndaj dhe i mbeti ky emër. Rrënojat duken dhe sot atje. Po sipas gojëdhënës Filipi i Maqedonisë kishte qytezën verore për përgatitjet e tij luftarake këtu, ndaj vjen dhe një poezi e Murat Toptanit, ku thuhet: "...dimrit në Selanik zbriste/ Verën në Mat-Dibër qiste/ Aty ku i thonë qytet/ Ku përpiqen malet dhe retë.

Afër këtyre lëndinave ndodhet qyteti i Varoshit, pranë kalasë së Stelushit (Skënderbeut). Zbulimet arkeologjike kanë nxjerrë një qytezë të vërtetë, ka mundësi që i biri i Filipit, Aleksandri i Madh, në kujtim të qytezës të të atit, i vuri emrin kryeqendrës së tij të re "Pela" afër Selanikut, ka spjeguar me studimin e tij Ali Koçeku.

Kodër pas kodre e lëndinë pas lëndine vijon Lura e bukur, Pllaun e gjelbërt, deri sa ngushtohet dhe zbret në Sheun e Thatë ku është "kalaja e Skënderbeut" dhe përballë saj në anën tjetër rri madhështor "Karakolli", vendroja e kalasë, më tej zbresim në një gropë disa hektarë të rrethuar me shkëmbinj tejet të thepisur që quhet Xhaxhani. Këtu duket një gur i sheshtë disa metra katrorë, me një gropë ovale në mes, lurasit i thonë "dybeku i kafesë". Mendohet se aty bluhej kafeja e Skënderbeut. Ky vend këtu ka qenë dhe strehë e muhaxhirëve dibranë që ndiqeshin nga serbët. Prej këtu lurasit i merrnin në shtëpitë e tyre për t'i mbrojtur...

reportazh

Reportazh
nga trojet shqiptare

Shqipëria ka bukuri të pamata

Nga **OSMAN XHILI**

Ekush mund ta refuzonte një ftesë zemre, për të vizituar disa atraksione të turizmit malor në Kosovë dhe në Shqipëri? Dy miqtë e mi të nderuar Izet Shulku dhe Lulzim Plaku e kishin menduar mirë e bukur programin e udhëtimit tonë dhe nuk na ngelej tjetër, vetëm se për ta zbatuar atë. Paketa e kësaj fundjave, në këtë fund korriku përfshinte një vizitë në Pejë të Kosovës dhe një tjetër në Valbonë të Tropojës.

Udhëtimi nisi herët në mëngjes, në mënyrë që ditën ta kishim përpara. Shumë shpejt lamë pas qytetin e Peshkopisë, Kalanë e Dodës, Qafën e Kolesjanit, Aeroportin e ri të Kukësit. Pasi kaluam dhe doganën, u drejtuam për në destinacionin tonë, që e arritëm pa shumë vështirësi.

UJËVARA DHE SHPELLA E KAVADARCIT

Ishte ora dhjetë. Vendi gëlonte nga turistë të huaj e vendas. Pak minuta më pas një ujëvarë e bukur na u shfaq para syve tanë dhe ne u afruam akoma më tepër. Uji i kristaltë binte nga dhjetëra metra lartësi, duke u shpërbërë në miliona grimca të vogla, ashtu siç ishin bashkuar në fillim, për të krijuar atë masë gjigante uji. Natyrisht, po të kishim ardhur pak muaj më parë përmasat e ujëvarës do të kishin qenë akoma më të mëdha dhe hiret e saj do të ishin akoma më dinjitoze. Ujëvara kishte zhurmën e saj, që më mirë duhet quajtur gjuha e saj, melodia e saj. Nuk është faji i saj, që ne nuk e kuptojmë këtë gjuhë, që mund të jetë adhurim për Krijuesin e Gjithësisë, që mund të jetë ftesë për ne njerëzit, muzikë për ne vizitorët, për të na hequr stresin dhe shqetësimet tona.

Izet Shulku, i çmenduri pas natyrës, nuk pret gjatë. Bën gati kostumin e notit dhe merr me vete flamurin. Flamuri për Izetin ka kuptim të madh. Ai duhet të jetë në lartësitë dhe majat e maleve, ai duhet të jetë aty ku ka bukuri, për ti shtuar ato akoma më shumë, ai duhet të jetë në evente dhe gëzime familjare, për tu dhënë atyre akoma më shumë kuptim e vlerë. Ai duhet të lartësohet sa më shumë të jetë e mundur, siç e lartësuan të parët tanë në mbrojtje të trojeve kombëtare. Vajmedet, në ç' duar të pista e grabitqare ka rënë sot flamuri shqiptar! Vajmedet, për ne që bëjmë shqiponjën me duar, duke vjedhur e shitur pasuritë kombëtare për pak interesa vetjake!

Izeti vendos flamurin në një shkëmb pranë ujëvarës dhe hidhet në ujërat e kristalta. Ata janë tejet të ftohta, por trupi i Izetit është mësuar me gjëra të tilla. Unë dhe miku tjetër, Lulzim Plaku vetëm filmonim këto pamje të rralla e të mrekullueshme, duke freskuar duart e fytyrën.

Nuk duhet të ecësh shumë për të vizituar mrekullinë tjetër të këtij qyteti, shpellën e Kavadarcit. Falë një bashkëpunimi të komunës me Bashkimin Europian, ajo është bërë e vizitueshme për njerëz të ndryshëm dhe emrin e shpellës e lexojmë si "Sleeping beauty



cave". Në hyrje të saj janë dy vajza cicerone, të gatshme për të dhënë shpjegimet për historinë e shpellës. Mjafton një pagesë prej vetëm dy eurosh për të shijuar mrekullitë e kësaj shpelle, bashkë me shpjegimet për të.

Vajza me emrin Arona na thotë se shpella ka një moshë dy milion vjeçare dhe është formuar si rezultat i kalimit të ujit, pikërisht në këtë shtrat e në këto hapësira. Ajo është e gjatë 3.6 kilometër, por deri tani vetëm 250 metra janë të vizitueshme. Shpella ka si të thuash katër ndarje, ose katër kate, ku e para është pjesa hyrëse. Më tej vijon pjesa e shkëmbinjve, ajo e lakuriqëve dhe mbyllet me pjesën e vaskave, që ndoshta është dhe më e bukura. Uji duke rrjedhur pa shumë forcë në këtë pjesë, ka krijuar disa vaska të madhësive të ndryshme, që ngjasojnë dhe me hoje bletësh. Lulzim Plaku, që punon mrekullisht me allçi e çimento, i kishte zili këto punime shumë interesante.

Gjithë shpella ishte një mozaik i mrekullueshëm. Hyrje e dalje, kthesa e gjarpërime pa mbarim, gurë me madhësi e forma të ndryshme, që asnjë piktor e skulptor nuk bën dot të ngjashme si këto. Stalaktitet dhe stalagmitet janë vërtet si ato erëzat që i japin gjithë shijen gjellës. Specialistët thonë se një centimetër i tyre të jep njëqind vite moshë. Aty pranë kemi një shkëmb të madh, në formën e dorës së njeriut të krijuar nga bashkimi i stalaktiteve dhe stalagmiteve, duke krijuar një ide se sa e vjetër është shpella që ne po vizitojmë.

Zbresim ngadalë, ashtu siç dhe u ngjitëm ngadalë, për të mos lënduar këmbën, apo për të mos përplasur kokën diku. Brenda ishte një freski shumë e madhe, në kontrast të madh me temperaturën jashtë. U ndjemë të kënaqur e të çlodhur dhe menduam se vërtet ja kishte vlejtur të vije deri këtu. Gjithandej lokale e mjedise çlodhëse rreth e qark dhe ne u ulëm tek



njëri prej tyre për të drekuar. Izeti ngriti sërish flamurin tek tavolina ku ishim ulur. Dikush na pyeti nëse kishim ndonjë festë. Izeti u përgjigj se kur njeriu është i lumtur ka gjithmonë festë e gëzim.

Një mesoburrë nga Istogu, që punonte në Amerikë, kishte ardhur për pushime, bashkë me dy djemtë e tij. Ai e njohu Izetin dhe i tha, mos je ti, ai që bën video në borë. Vërtet ai nuk gabohej. Izeti ishte i bërë i njohur me atë dashuri e pasion për të njohur, eksploruar e promovuar natyrën e bukur shqiptare.

DON PAULO DHE BUJTINA "ADORA"

Morëm rrugën e kthimit sërish për në Shqipëri, në drejtim të Tropojës. Ishte pasdite vonë dhe mbrëmja po lëshonte mantelin e saj të zi mbi tokën, pemët, njerëzit. Izeti kishte lexuar në internet për një bujtinë të re, që ishte promovuar kohët e fundit. "Adora" duhet të ishte emri i saj. Ndoshta mund të qëndronim tek ajo për të fjetur. U nisëm drejt saj dhe pasi ndoqëm për dy kilometra një shteg të paasfaltuar, gjendeshim pranë bujtinës. Lokali funksiononte, kurse për të fjetur jo, akoma. Shumë njerëz punonin për të bërë gati nëntë pushimore, me një kapacitet total prej 50 shtretër. Një mesoburrë po qëndronte ulur në një stol, bashkë me një grua të imët, të vjetër, që mund të ishte nëna e tij. Menduam se pikërisht ai ishte pronari i këtij kompleksi dhe nuk u gabuam. U përshëndetëm me ta dhe u thamë se donim të qëndronim aty atë natë. Bujtina akoma nuk ishte gati për të pritur vizitorët e shumtë,që donin të bënin prenotime. Pronari që ishte ulur në stol, bashkë me nënën e tij, nuk ishte tjetër, veçse Paulo Gjoka, ose Don Paulo, siç e thërrisnin shumë njerëz. Më pas e kuptova se kisha parë një emision televiziv, që i kushtohej atij dhe sipërmarrjes së tij.

Ai kish bredhur shumë shtete europiane dhe mund të kishte ndenjur rehat në ndonjërin prej tyre. Kishte vendosur të qëndrojë në Tiranë, ku kishte një dyqan të famshëm lulesh e sërish zemra nuk i bënte rehat. Kujtime të hershme i dilnin përpara, sa herë që i trazohej gjumi. I bëhej se ishte atje në shtëpinë e vjetër, mes kodrinave të gurta, atje ku Valbona përfundonte rrugëtimin e shkrihej me ujërat e liqenit të Komanit. Donte të shkojë atje ku kishte kullotur bagëtinë në fëmijërinë e hershme dhe gjakoste gjunjët, duke luajtur futboll me topa lecke.

Tani, pas shumë e shumë vitesh, pasi kishte grumbulluar shumë eksperiencë, pasi kish mësuar disa gjuhë të huaja, donte të bëjë diçka. Jo thjeshtë për vete, por dhe për ata njerëz që vazhdonin të qëndronin aty, në trojet e hershme. Don Paulo do të donte ta shohë krahinën e tij të lulëzuar e të begatë. Vendlindja e tij i takonte Nikaj Mërturit, një zonë që ndodhet gati në mes të Tropojës, Shkodrës e Pukës. Akoma pa mbaruar punimet, vizitorë të shumtë vinin e drekonin në bujtinë. Ai kishte zbarkuar me mijëra metër kub dhè, kishte bërë mure të gurta antike, kishte shtruar qindra metra katrorë pllaka, kishte mbjellë shumë lule e pemë dekorative dhe ky ishte vetëm fillimi. Sa projekte të tjera kishte në kokë ky njeri ! Do të mbillte perime e pemë frutore, të mbarështonte qingja e keca, për klientët e tij të shumtë, si dhe të vendoste një teleferik, që vizitorëve tu shërbehej më lehtë e më bukur. Don Paulo kishte tre varka, me të cilat mund të vozitej lehtësisht për në lumin e Shalës. Sa do të donim dhe ne ta realizonim një vizitë të tillë! Por tjetër herë ndoshta do të na mundësohej kjo dëshirë. Atëherë, ndoshta dhe kampingu do ishte gati, bashkë me shtretërit e shumtë. Ishim dhe miq me don Paulon, pasi nusen e kishte nga Maqellara. Djali i tij studionte për arkitekturë dhe për shef kuzhine në të njëjtën kohë. Sa njerëz punëtorë e vizionarë dhe sa pak ndihmohen nga shteti. Por nëse nuk e kanë ndihmën e shtetit, shpresojmë ta kenë ndihmën e Zotit, pasi ajo është më e rëndësishme nga çdo gjë.

VALBONA

U kthyem nga kompleksi "Adora", duke i uruar don Paolos shumë suksese në biznesin e ri që kish nisur dhe atë natë pushuam në një hotel të zakonshëm, diku në mes të qytetit " Bajram Curri". Pimë kafen e mëngjesit dhe ashtu të çlodhur e të freskët morëm për nga lugina e Valbonës. Kishim lexuar që kur ishim nxënës për bukuritë e kësaj lugine e të këtij lumi e ja tani që ishim fare pranë. Ecnim me makinë dhe hera herës ndalonim pranë ndonjë bujtine, që në fakt ishin të shumta në numër. Pema e arrës ishte shumë e përhapur në Luginë. Jo vetëm vila, por kishte dhe banesa fshatarësh, ku tek e tek e herë tjetër më të shumta në numër. Kishim arritur në Dragobi, një qendër e vogël, që mund të kishte rreth 50 shtëpi. Shpella e Dragobisë kishte lidhje me Bajram Currin, trimin e maleve, por nga Dragobia ishte dhe këngëtarja e njohur dhe e dashur për publikun, Fatime Sokoli. Njeriu që na shpjegonte ishte Hysni Sokoli, kryetar i këshillit, por dhe kushëriri i këngëtares.



Pak më tej ndalojmë tek një tjetër resort, "Kosova Relaks". Punime të bëra me gur dhe dru. Guri e druri, gjithnjë në harmoni me natyrën, me lumin, me malet rreth e rrotull. Rasti e solli që të takojmë dhe Velidin nga Arabia, që kishte ardhur që larg, bashkë me familjen e tij, për të shijuar natyrën e bukur shqiptare.

Bëjmë dhe pak kilometra, por Izeti nuk mund të duronte pa u larë në ato ujëra të ftohta e të kristalta. Këtë radhë e ndoqa dhe unë me Lulzimin. U freskuam mirë e mirë, bëmë ca foto dhe u nisëm. Një çift të rinjsh, që mesa dukej ishin të huaj, na nxorën dorën për ti marrë në makinë. Po, normalisht, nuk mund ti refuzonim. Ecëm së bashku deri aty ku mbaronte rruga e asfaltuar. Për të shkuar deri tek burimi i Valbonës duhej të ecje dhe dy orë në këmbë, kështu që u mjaftuam me kaq. Të huajve u propozuam një kafe dhe ata e pranuan me kënaqësi. Vajza ishte nga Holanda dhe studionte në Izrael për biologji, kurse djali për shkenca kompjuterike. Që aty do të shkonin në Theth, që mbante 6 orë në këmbë që aty.

U përshëndetëm me miqtë dhe morëm rrugën e kthimit. Sa energji pozitive kishim fituar! Sa ajër të pastër kishim thithur e sa gjëra të reja kishim parë. Na u shtua akoma më shumë ideja se Shqipëria ka bukuri të pamata, se Zoti na ka bekuar me malin, me ujin, me detin, me minerale e shumë gjëra të tjera. Sikur të shtonim dhe pak dashurinë për Atdheun, shumë shtete të tjera do të na kishin zili.



Fshati Zerqan në Bashkinë e Bulqizës është përzgjedhur si një nga fshatrat turistik në programin e qeverisë, për t'i dhënë një fytyrë të re turizmit në këtë zonë, por mesa duket edhe në terren, investime në kuadër të këtij projekti ambicioz nuk kanë ardhur ende deri në këtë zonë, duke i bërë banorët skeptik për procesin.

ZERQANI, fshati turistik, por që po braktiset çdo ditë

Nga **DRITAN KURTI** *

Fshati Zerqan në Bashkinë e Bulqizës është përzgjedhur si një nga fshatrat turistik në programin e qeverisë, për t'i dhënë një fytyrë të re turizmit në këtë zonë, por mesa duket edhe në terren, investime në kuadër të këtij projekti ambicioz nuk kanë ardhur ende deri në këtë zonë, duke i bërë banorët skeptik për procesin.

Fshati Zerqani , në njësinë administrative me po të njëjtin emër, ndodhet jo më larg se 17 kilometra nga qyteti i Bulqizës dhe 7 kilometra nga rruga nacionale Tiranë – Peshkopi. Në vitin 2018 qeveria shqiptare e përzgjodhi atë në paketën e 100 fshatrave turistik, mes propozimeve të bëra nga drejtues të Bashkisë Bulqizë në atë periudhë. Por që nga ajo periudhë fshati nuk ka përthithur investime, megjithëse mund të shërbente shumë mirë si një atraksion turistik për turistë vendas e të huaj për shkak të historisë që mbart.

Në hyrje të fshatit ndeshesh me një tabelë të madhe, e cila mesa duket ka shumë vite që është aty, pasi shkrimet apo fotot në të, i ka djegur dielli dhe është vështirë të dallohen. Ajo që dihet me siguri është që kjo tabelë është vendosur para vitit 2015, pra para se të kryhej reforma administrative territoriale, pasi mbishkrimi në të është KOMUNA ZERQAN. Madje në këtë tabelë janë stampuar edhe fotografi të fshatit Zerqan. Por ndryshe nga shumë fshatra të tjerë të përzgjedhur turistik, për këtë fshat nuk ekziston asnjë tabelë e tillë informimi, edhe pse është bërë një tender publik mbi sinjalistikën informuese, e cila do të ishte edhe A-ja e këtij projekti tejet ambicioz i qeverisë shqiptare. Për këtë, autoritet kontraktor ishte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me një fond limit 4.1 milionë lekë, që daton në vitin 2018, por mesa implementimi i këtij projekti nuk ka mbërritur ende në këtë fshat.

Rruga që të dërgon për në fshatin Zerqan është e gjitha e asfaltuar. Para se të hysh në fshat ndeshesh me një tabelë e cila të informon se aty pranë ndodhet një park natyror që banorët e quajnë "Vakuf". Në tabelë nuk ka shumë informacion, veç datës se kur është shpallur monument natyror, që daton nga viti 2002. Por banorët kanë një legjendë për të, ndaj dhe e shohin si të shenjtë këtë park me një sipërfaqe prej 15 HA. Parku i cili përbëhet nga pemët e larta të Lisit, është një vend i shenjtë për banorët dhe askush nuk prek asgjë në të. Besohet se kush ka tentuar të presë dru në këtë masiv pyjor i ndodhin fatkeqësi, ndaj dhe ai është "shenjtëruar" prej tyre, duke e shpëtuar kështu nga masakra për prerjen e pyjeve, si pak zona në këtë qark.



Banesa e Mustafa Shehut në Zerqan. Foto: D. Kurti

Poshtë parkut natyror ndodhen tre burime të mëdha uji të njohura si "Gurrat e Zerqanit". Ato burojnë në sasi të mëdha ndërsa shfrytëzohen për të vaditur tokat bujqësore jo vetëm fshati Zerqan, por edhe fshatrat e tjerë përreth.

Rruga për në fshat është vërtetë panoramike dhe tejet tërheqëse me malin e Bardhë në të majtë të saj. Por hyrja në brendësi është vërtetë e trishtë. Në afërsi të qendrës së fshatit ndeshesh me banesa të rrënuara e të braktisura prej kohësh. Pothuajse të gjitha banesat kanë të njëjtin material ndërtimi, tullën prej balte, e përdorur masivisht në këtë zonë edhe pse me risk sizmiologjik, i kanë rezistuar kohës për dekada e të mos themi shekuj me radhë.

Sinjalistika rrugore nuk mungon në këtë fshat, ku në brendësi të tij informohesh për qendrën e fshatit, por edhe për daljen e tij që është në rrugën nacionale tek "Tre Çezmat". Në qendër të fshatit ku dhe ndodhen disa biznese bar-kafe, takojmë Sabah Gurrën. I pyetur nëse ka patur investime në kuadër të shpalljes si fshat turistik, Gurra tha se në këtë fshat prej 1 dekade nuk është bërë asnjë investim.

"Zero investime, asgjë nuk është bërë. Asfalti e ndriçimi janë bërë që para 10 vitesh. Është vlerësuar në përzgjedhje si fshat turistik pasi ka shumë bukuri natyrore e histori që mund t'ju ofrohen vizitorëve", thotë ai për Portën Vendore. E në fakt kjo është e vërteta, pasi infrastruktura, vaditja dhe ujë kanë pas ekzistuar para vitit 2018, vit kur hapi siparin ky projekt për fshatrat turistik në vend. Favorizuese për këtë fshat është fakti se është qendër e njësisë administrative të Zerqanit, çka fshatrat e tjerë nuk e kanë pasur njësoj vëmendjen në investime.



Çezma e fshatit. Foto: D. Kurti

Shitësja e dyqanit ushqimor të vetëm që ndodhej në qendër të fshatit, na tregon se banorët e mbetur aty janë kryesisht të moshës së tretë, ndërsa shton se aktivitetin e mban hapur vetëm se e ushtron prej shumë vitesh.

Pak më tutje, takojmë dy të moshuar të tjerë. Shkëlqim Disha e Muharrem Bardhi janë dy pensionist që kohën e lirë e kalojnë me moshatarët e tyre në qendër të fshatit. Ata thonë se Zerqani i ka të gjitha për të qenë një atraksion turistik, ama investimet kanë mbetur në vendnumëro prej 10 vitesh.

"Zerqani i ka të gjitha. Atje lart është një masiv shumë i bukur me Lisa që ne e quajmë Vakuf. Është si ta kesh bërë me kompas, është vend i shenjtë. Ka 5 gurra uji që rrjedhin sipër fshatit dhe e mbajnë atë verë dimër të gjelbëruar. Ka banesa shumë të bukura të ndërtuara shumë e shumë kohë më parë. Në funksion të asaj që e ka shpallur qeveria si një ndër 100 fshatrat turistik nuk është bërë asgjë. Fshati po braktiset çdo ditë e më shumë", thotë Shkëlqimi.

Zerqani dikur kishte spital të mirëfilltë me një godinë të madhe në lindje të fshatit. Objekti kishte kushte bashkëkohore me 16 dhoma dhe me shumë mjek specialist. Por ndër vite, në mungesë të investimeve në të, kjo godinë sot është totalisht e boshatisur dhe në rrezik për tu rrënuar. Të vetmit "banorë" të përkohshëm në të, janë shpendët shtegtarë. Dallëndyshet kanë ndërtuar me dhjetëra fole brenda këtij objekti, pasi nuk shqetësohen nga asgjë e askush për t'i larguar nga aty. Spitali u rrënua me kohën deri sa u kthye në një qendër shëndetësore, por as në këtë fazë nuk i mirëmbajt, ndaj dhe qendrën e transferuan brenda ambienteve të Njësisë Administrative.

Historia na tregon se në fshatin Zerqan shkolla e parë shqipe është hapur që në vitin 1916, për tu mbyllur e rihapur disa herë për shkak të luftërave që u zhvilluan në këtë krahinë. Deri pak vite më parë, në këtë fshat kryenin të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar fëmijët e të rinjtë, ndërsa sot ka mbetur me vetëm 13 fëmijë parashkollor, ndërsa të tjerët do të duhet të udhëtojnë deri në fshatin Valikardhë për të marrë arsimin 9-vjeçare.

Buran Snallën e gjejmë pranë godinës së shkollës, teksa kosiste barë në livadhin e tij para institucionit të dijes. Burani na thotë se për mungesë të zhvillimit, nga 190 familje që kishte dikur fshati, sot nuk kanë mbetur më shumë se 40.

"Kur drejtonte PD këtu deri në 2015 u bënë investime. U asfaltua rruga, u bënë



"Vakufi", monument natyre në Zerqan. Foto: D. Kurti

"Projekti 100 fshatrat si dokument është thellësisht me objektiva teorike, që do të thotë mungojnë indikatorët e matshëm dhe strategjia si do realizohen këto objektiva. Në këto kushte kemi një lançim të një programi populist duke qenë se në Shqipëri zhvillimi rural/agrokultura ka peshën kryesore të ekonomisë dhe ndjeshmëria ndaj mobilizimit të zhvillimit të fshatrave është relativisht e lartë".

BESA MANAJ,
eksperten e qeverisjes vendore

kanalizime dhe u vendos ndriçimi në fshat. Më pas jo vetëm që nuk u bë asgjë, por u shkatërruan, pasi u mbyll shkolla, u shkatërrua spitali e nuk u bë asnjë investim. Zerqani ka qenë 190 familja e tani nuk kanë mbetur më shumë se 40 familje. Është bërë shumë mirë që është përzgjedhur si fshat turistik sepse e Meriton Zerqani, por duhen investime dhe për fat të keq fshati është braktisur. Ne nuk kemi shpresë që do të investohet më në fshatin tonë", thotë Burani për Portën Vendore.

Edhe pse i përzgjedhur si fshat turistik, përveç historisë dhe natyrës të pakta janë aktivitetet që turistët mund të kryejnë në Zerqan, kjo pasi në fshat nuk ofrohen as bujtina e as restorante agro-turizmi që mund ti ofronin një prespektivë tjetër vizitorëve vendas e të huaj, duke i ofruar ushqime bio e tradicionale të zonës.

Zerqani ka një pamje fantastike kur në këtë fshat shkon nga rruga e parë që kalon përmes Valikardhës. Ndërtesat me mure të kafet e përballë mali i Bardhë. Ajo që bie në sy është banesa komplekse e Mustafa Shehut që mbart një histori të çmuar jo vetëm për zonën, por për historinë e Shqipërisë, shpallur Monument Kulture që në vitin 1977. Mustafa Shehu ishte udhëheqës i luftës së Gjoricës në 1844 që kryesohej nga Hajredin Pasha. Në vitin 1893 Sulejman Shehu i kthyer nga Turqia, arriti të hapë shkollën e parë private fetare në gjuhën shqipe.

Gjurmët më të hershme të këtij fshati janë gjatë shek XIII, me emrin Zirclan që në latinisht do të thotë vend i artë. Ky emër provohet më vonë nga dokumentet turke të vitit 1467. Shkolla e parë shqipe në këtë zonë u hap në vitin 1910, për tu mbyllur e rihapur disa herë për shkak të luftërave të zhvilluara deri në 1944. Historia e lavdishme e kësaj zone mund të jetë mjaft mirë një pikë e fortë për ta kthyer Zerqanin në një atraksion turistik.

Bashkia e Bulqizës pranon se nuk ka bërë asnjë investim në këtë fshat në kuadër të zhvillimit të tij turistik. Madje në përgjigjen zyrtare dhënë për Portën Vendore, Bashkia Bulqizë shprehet se as projekte nuk ka hartuar, por që një gjë të tillë, do ta realizojë e planifikojë në buxhetin e vitit 2022, sikundër do t'i kërkojë qeverisë qendrore që të ketë në prioritetet e saj të mbështetjes financiare dhe projektet për zhvillimin turistik të Zerqanit.

E pyetur nga Porta Vendore FSHZH që është institucioni që po zbaton projektet e ndryshimeve infrastrukturore tha se të gjitha investimet që janë planifikuar në këtë fshat janë në proces vlerësimi dhe tenderimi të projektit. Në fshat do të ketë 3 investime, përkatësisht në asfaltim e rrugës së "Tre çezmat", ndëtim rruge Zgozht – Ura e Cerenecit, dhe Rikonstruksionin e rrugëve të lagjes e re Metallaj, lagjia e re Bodinak.

Lidhur me mungesat në investime në fshatin Zerqan të Dibrës Porta Vendore kontaktoi gjithashtu edhe eksperten e qeverisjes vendore Besa Manaj e cila u shpreh skeptike lidhur me këtë program të iniciuar nga qeveria 3 vite më parë.

"Projekti 100 fshatrat si dokument është thellësisht me objektiva teorike, që do të thotë mungojnë indikatorët e matshëm dhe strategjia si do realizohen këto objektiva. Në këto kushte kemi një lanccim të një programi populist duke qenë se në Shqipëri zhvillimi rural/agrokultura ka peshën kryesore të ekonomisë dhe ndjeshmëria ndaj mobilizimit të zhvillimit të fshatrave është relativisht e lartë. Domethënë instrumenti i përdorur nuk ka në thelb transformimin e këtyre zonave me zhvillim periferik dhe as ndonjë strategji të matshme për rivitalizim resursesh dhe koordinim të aktorëve publike dhe atyre kapitale (humane ose private)", thotë Manaj për Portën Vendore.

*(Marrë nga **portavendore.al**)*



Banesë e rrënuara në hyrje të fshatit. Foto:D. Kurti

Dibranët në diasporë mbledhin ndihma për spitalin e Dibrës së Madhe



Ndihmat financiare mblidhen përmes GoFundMe. Brenda 48 orësh janë mbledhur mbi 63 mijë dollarë nga 124 donatorë dhe synimi i Shoqatës Atdhetare Dibra në New York është që të mblidhen 100 mijë dollarë. Dy donatorët më të mëdhenj deri më tani janë biznesmeni Avdul Bajro me 11 mijë dollarë dhe këngëtarja Bebe Rexha me 10 mijë dollarë.

Nga **BEQIR SINA** – New York

Spitali i Dibrës nuk ka mjaftueshëm furnizime, ndërsa ditët e fundit është i stërmbushur me pacientë me koronavirus. Për këtë arsye dibranët në diasporë kanë ngritur një fushatë për ngritjen e fondeve financiare që të ndihmohet Spitali i Dibrës së Madhe në Maqedoninë e Veriut.

Dibra e Madhe, qyteti ku u shfaq rasti i parë me Covid 19 në Maqedoni në muajin mars, nuk mund ta përballojë e vetme një valë të re, më të fortë të të infektuarve. Shtypit lokal njofton se aktualisht ka 53 raste aktive, por mjekët thonë se nuk ka shtretër të mjaftueshëm për pacientët në spital dhe nuk ka personel mjekësor.

Kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibra në Staten Island (NY), Dashnor Miftari, në një bisedë për gazetën tha se "gjendja në spitalin e Dibrës është shumë e keqe".

"Sapo jam kthyer nga sesioni veror në vendlindje, tha ai. Spitali i Dibrës, i cili është ndërtuar në kohën e ish-Jugosllavisë, ka një mungesë të madhe të pajisjeve spitalore, sidomos në këtë kohë të kësaj pandemie globale dhe gjendjes së rënduar në Maqedoninë e Veriut. Spitali nuk kishte as oksigjen për trajtimin e pacientëve, as aparatura për skaner dhe as ilaçe të tjera të tjera që janë më se të nevojshme në këtë pandemi", -tha Miftari.

Miftari tha se "kemi bërë një thirrje për ndihmë financiare, linku i së cilës është i lidhur me GoFundMe, ku mund të dhurohen online të ardhura për të ndihmuar spitalin". Sipas tij, vetëm gjatë 72 orëve të para janë mbledhur mbi 63 mijë dollarë, ndërkohë që qëllimi është të mblidhen 100 mijë dollarë".

Në spitalin e Dibrës ishte këto ditë z.Bekim Paçuku, drejtues i degës bamirësisë nga Shoqata Atdhetare Dibra (SHAD), i cili bëri pagesën në vlerë prej pesë mijë dollarë për furnizimin me oksigjen për nevojat e pacientëve të shtrirë me Covid-19.

Për këtë qëllim, një ndihmë të madhe ka dhënë edhe këngëtarja Bebe Rexha, e cila ka dhuruar 10 mijë dollarë për spitalin e Dibrës. Ajo u bëri thirrje ndjekësve të saj që të vazhdojnë të dhurojnë.

Bebe Rexha, "Dibranja nga Brooklyni", nuk e harron asnjëherë prejardhjen e saj, pasi shpeshherë në intervista ajo përmend vendin nga vjen e flet edhe për traditat. E kur vendi i saj i origjinës ndodhet në vështirësi, duket se ajo nuk heziton që të ndihmojë me aq sa ka mundësi. Nga pasqyra e bërë mbi këtë fondacion online, mund të shihet se vet Bebe Rexha ka dhuruar plot 10 mijë dollarë (rreth 8,400 euro) për të ndihmuar furnizimin e spitalit.

Rekordin e donacioneve e theu deri më tani Avdul Bajro, i cili ka dhuruar shumën prej 11 dollarësh.

Nga 5 mijë dollarë kanë dhuruar Reggie dhe Jule Ballanca, Argjent Duka, Fato Koxha dhe Eglantina Kica kanë dhuruar nga 2 mijë dollarë, ndërsa Valon Duka, Bedri Qoku, Bleron Canka, Atdhe Canka, Vebi Canka, Bedri Sela, Rober Mela, Arti Mela, Feta Fishta, Shpëtim Dema, Fatmir Duka kanë dhuruar nga 1 mijë dollarë secili.

Veprimtari dibran në Florida – SHBA, Turan Rusi, i cili së bashku me fëmijët e tij, në emër të Familjes Rusi, vitin e kaluar kur nisi pandemia dhe masat u shtuan, ka bërë dy donacione njëri pas tjetrit, duke ndihmuar fillimisht 100 familje dibrane me paketa ushqimore, dhe një ndihmë të dytë për 200 familje të tjera.

Ndërkohë, bëhet e ditur se Turan Rusi, së bashku me fëmijët e tij, në emër të Familjes Rusi, sipas bisedës telefonike që ka pasur ai me drejtorin e spitalit, Dr. Baki Alili, këto ditë në ambientet të Spitalit - Dibër bëri pagesën të faturave për bombolat e oksigjenit. Për çka ai mori edhe një Mirënjohje nga drejtori dhe të punësuarit të Spitalit në respekt për familjen Rusi.

Reparti kirurgjik në Dibër është kthyer në repart për trajtimin e pacientëve me Covid19 në Dibër.

"Për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të të prekurve me Covid19 edhe reparti kirurgjik e kemi kthyer ne repart për trajtimin e të prekurve nga virusi, pasi atij te Internos" - i tha Baki Alili, drejtor i spitalit, një media lokale në Dibër.

Sipas Alilit, momentalisht janë të hospitaliziar 30 pacientë, 28 prej tyre janë në aparatet respiratore.

Dhuro duke klikuar mbi linkun: **https://tinyurl.com/57b9uxst**

Rruga e Arbërit nr. 179 180

portret

Zeni Talja *i Dibrës së Madhe, modeli i modestisë dhe i bujarisë*

Nga **OSMAN XHILI**

Rënjët e kësaj familje janë në fshatin Shtushnje të Dibrës tonë, ashtu siç janë dhe të shumë familjeve të tjera. Mbiemrat Pocesta, Kllobçishta, Dovolani, Maqëllara, Erebara, Grezhdani e shumë të tjera si këto, tregojnë qartë fshatrat nga janë larguar këto fise e janë ngulur në Dibër të Madhe, ku jetojnë dhe sot e kësaj dite.

Arsye të ndryshme, ndoshta ekonomike, ndoshta dhe hasmërie, mund ti kenë detyruar të parët e kësaj familje e të këtij fisi, për tu vendosur në fshatin Kojnarë të Dibrës së Madhe. Në atë kohë, ky qytet shkëlqente për nga kultura, ekonomia, besimi e patriotizmi.

Ndoshta po të gërmosh më shumë në histori do të gjesh dhe shumë njerëz të shquar e me vlera, por ne po e nisim me gjyshin Islam, një burrë i ditur, punëtor e besimtar. Ai kish kryer shkollën e mesme për agronomi dhe kur bëhet fjalë për para 80 viteve, kjo nuk ishte pak. Në vitet 1948 – 1952 zgjidhet kryetar komune për pesë fshatra, duke punuar me nder e përkushtim. Më vonë merret me bujqësi e blegtori, duke shtuar mjaftueshëm sipërfaqen e tokës dhe numrin e blegtorisë me gjedhë e të imta.

Djali i tij, Zeni Talja, i ruajti fort këto vlera e tradita të punës, shkollimit dhe bujarisë, ndoshta për ti ngritur akoma më lart. Ai mbaroi shkollën e mesme mekanike dhe punoi për shumë vite në ndërmarrjen komunale të qytetit. Herë me mirëmbajtjen e sistemit të pompimit e herë si shofer i kësaj ndërmarrje. Në vitin 1982 ai hap një biznes familjar, një gatër sharre dhe zdrukthëtari. Aty përpunohej druri e bëheshin dërrasa të një cilësie të lartë, aty bëheshin dyer e dritare, por bëheshin dhe divane, që ishin një luks për kohën. Gjithë familja ishte punësuar, por dhe pesë apo gjashtë punëtorë të tjerë kanë qenë vazhdimisht prezentë në aktivitetin e këtij biznesi.

Kështu vazhdoi puna deri në rrëzimin e sistemit të vjetër, që më shumë se sa atje, tek ne kishte qenë akoma më i rëndë dhe i vështirë. Ai vazhdimisht kishte kthyer shikimin nga kufiri, andej nga kishin ardhur të parët e tij dhe mendonte se a do të vinte ajo ditë, kur të shkonte lirshëm për në Shqipëri. Ajo ditë tashmë kishte ardhur. U çel kufiri, sikur u çel dhe shpirti e zemra e Zeni Tales. Shtëpia e tij i hapte dyert tej për tej, për të njohur e të panjohur. Jo vetëm tenxhere, por dhe kazanë ndonjëherë, me supë, fasule, mish e çdo gjë tjetër viheshin për mysafirët e shumtë. Ata hanin e pinin e lusnin Zotin, që ti shtonte jetën dhe kurrë mos ja pakësonte riskun këtij njeriu bujar të pashoq.

Një ditë, teksa bënte punët e zakonshme, pa disa policë, që shoqëronin rreth dhjetë veta të arrestuar. U afrua dhe pak dhe e dalloi që ishin shqiptarë, nga matanë kufirit. I kishin kapur duke bërë ndonjë tregti të vogël dhe i kishin keqtrajtuar. Fytyra të mavijosura, rroba të grisura nëpër ferra për ti ikur policisë, trupa të dobët e të paushqyer. Por kjo nuk ishte asgjë me atë ç'farë i priste, dënimi me disa vite burg. Zeniut i pikëlloi zemra për këto njerëz hallexhinj, dhe pse nuk njihte asnjërin prej tyre. Po ç'rëndësi kishte kjo? Duhej bërë diçka sa nuk qe akoma vonë e nuk ishte dhënë dënimi! Takoi kryetarin e gjyqit dhe ju lut të mos i dënonte. Kryetari i tha Zeniut, se nëse e konvertoj dënimin nga burgim në gjobë, a e paguan ti?

- Sa është gjoba për to?

- Njëmijë marka, - u përgjigj kryetari i gjyqit.

Në vend të përgjigjes, Zeniu hapi një portofol të madh, ku mbante kursimet e familjes dhe u bë gati të nxjerrë shumën e kërkuar, por kryetari i bëri me shenjë të mos vazhdonte



më tej. I bëri përshtypje kjo sjellje dhe ky veprim dinjitoz i këtij burri. Do ti falnin ato njerëz, le të shkonin të patrazuar në shtëpitë e tyre. Nga sytë e tyre dolën lot mirënjohje, për këtë njeri të habitshëm, që i kishte ndihmuar pa asnjë lloj interesi.

Lufta e Kosovës ishte një sfidë e madhe për Zeni Talen dhe familjen e tij. Shumë shpejt shtëpia e tij u bë një bazë e rëndësishme për të koordinuar punët e veprimet në dobi të saj. Njerëz dhe armatime hynin e dilnin nga shtëpia e tij për në drejtime të ndryshme. Ushtarë të plagosur mund të rinin me ditë të tëra, kurse të plagosurit më rëndë transportoheshin në bazat e tjera më të specializuara. Njohjet i tij të shumta bënin që gjërat të bëheshin me lehtësi e siguri të madhe. Zeniu nuk thoshte kurrë jo, dhe kur misioni ishte shumë i vështirë, në dukje i pamundur.



Si një hero i heshtur, ai nuk kërkoi kompensim pas lufte. Shumë mirënjohje i sollën nga Kosova dhe ai vihej në pozitë të vështirë, kur i përmendnin vlerat dhe meritat. "Unë kam bërë aq sado të bënte çdo shqiptar tjetër", thoshte Zeniu me modesti. Duke gjykuar kontributin e tij të madh kosovarët kishin vendosur ti akordojnë dhe një pension, por Zeniu nuk e pranoi kurrsesi. Sa familje kishte akoma në Kosovë që kishin humbur shtëpitë dhe njerëzit e duheshin rehabilituar sa më parë!

Lufta e Kosovës mbaroi. Shumë gjak e viktima, shumë nder e shkëlqim. Zeni Talja kishte hapur konak në shtëpinë e vet, por dhjetëra të tjera në Kosovë, u hapën për të më pas, në këmbim të kësaj miqësie e të këtij heroizmi të pashoq. Ishte një miqësi e farkëtuar mes gjakut e barotit. Sa herë që ata kishin fejesa, dasma e gëzime, Zeniu do të ishte i ftuar në mesin e tyre.

Djali i tij, Artani, tregon për një nga vizitat e tyre të shumta atje: "Shkuam në Ferizaj, tek Etem Bajraktari dhe u çmallëm me njerëz. Mjaftoi një foto e nxjerrë në fejsbuk me ne miqtë nga Dibra, kur vërshuan postimet nga shumë qytete të tjera, si Ferizaj, Prishtinë, Mitrovicë, Kaçanik e Prekaz. Ata e donin Zeni Talen dhe familjen e tij në mesin e tyre. Kudo e prisnin si një mik të madh, si një hero". Ja, kjo ishte ajo që do të kishte dashur Zeni Talja, respektin e miqësinë e vëllezërve kosovarë dhe jo paratë e pensionin, që donin t'ia jepnin në këmbim.

Lufta nuk preku vetëm Kosovën, por dhe Maqedoninë, pak vite më vonë. Zeniu sërish ishte në ballë të saj, me të gjitha mundësitë që kishte. Porse një ditë maji e vitit 2001, gati tingëlloi fatale për jetën e tij. E thirrën në rajonin e policisë, gjoja për të dhënë një intervistë. Në fakt punët shkuan ndryshe. Pesë ditë e net vetëm tortura e vuajtje të pafund. E pyetnin për emra luftëtarësh, për bazat e luftës dhe çdo pyetje shoqërohej me dhjetëra lloje torturash. Por, shpirti luftëtar i Zeni Tales, nuk u mposht. Ai e dinte se një vdekje e kishte dhe nëse kishte bërë detyrën ndaj atdheut e kombit, nëse kishte qenë në anën e drejtësisë, vdekja ishte nder e lavdi. Në një natë të errët pus, kur ai ishte gjysmë i vdekur e hedhin diku në pyjet mes Kërçovës e Ohrit. Rrigonte një shi i lehtë. Ai sikur e zgjoi nga kllapija, ia freskoi plagët dhe i ktheu vetëdijen. Mund të ishte dhe në të aguar. Dëgjoi një zhurmë makine dhe e kuptoi që rruga mund të ishte vetëm disa dhjetëra metra larg. Me forcat që i kishin mbetur u zvarrit deri atje.

Një taksi po vinte në krahun drejt Dibrës. I nxori dorën dhe mjeti u ndal. Shoferi i hodhi vështrimin dhe në dritat e makinës dalloi një fytyrë e një trup të dërmuar. Po ta kishte ditur se si ishte e vërteta nuk do ta kishte marrë.

- Punoj në mal, me dru, - u shpjegua Zeniu dhe më zunë përfundi. Më ço deri në Dibër dhe të paguaj!

Shoferi sikur u bind dhe pranoi. Në pak orë e dërgoi drejt te shtëpia dhe Zeniu e ftoi për kafe. U mblodhën shpejt njerëzit e rrethit familjar dhe u habitën se si ishte gjallë, kur e dinin për të vdekur. Ndoshta duatë dhe lutjet e atyre mijëra njerëzve, që kishte ndihmuar me bukë e ushqime e kishin bërë efektin e duhur! Vetëm atëherë shoferi e kuptoi të vërtetën.

Vite më parë, në Maqedoninë e Veriut u krijua shoqata 'Nënë Tereza", ku Zeniu jo vetëm ishte në rrethin drejtues, por dhe një nga financuesit e rëndësishëm të saj. Sa e sa ton oriz, sheqer, vaj dhe asortimente të tjera u përcollën në Kosovë dhe në vise të tjera, sa herë që ishte nevoja për këto ushqime jetike për popullsinë . Në jo pak raste dhe makinën e tij nuk e kurseu për transportin e këtyre mallrave.



Zeni Talja është modeli i modestisë dhe i bujarisë. Dhe tani që po shkruajmë këto rreshta, falë tregimit të Artanit për babain e tij, pasi vetë Zeniu ndodhet në Amerikë. Artani është më i vogli nga tre djemtë. Ka mbaruar universitetin e Shkupit për ekonomi dhe financë dhe sot punon si inspektor i tregut të qytetit. Djali tjetër, Islami ka emrin e gjyshit dhe është përgjegjës i biznesit familjar të zdrukthëtarisë, kurse djali i madh, Zudiu jeton e punon në Amerikë. Familja e Zeni Tales është e shpërndarë në Amerikë, në Itali dhe në origjinë, në Dibër të Madhe. Nipër e mbesa të shumtë po e shtojnë dhe po e fuqizojnë këtë familje të nderuar, modeli punës, i dijes, i bujarisë dhe patriotizmit.

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.
Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.
Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi.
Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të tregojë pavarësi politike në shkrimet për gazetën.
Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.
Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

reportazh

Reportazh nga
festa e çlirimit të Peshkopisë

GËZUAR FESTËN DIBRA HEROIKE

Nga **BESNIK LAMI**



Qielli i pastër e me ca avuj flakërues në horizont na tregon se edhe sot do të jetë ditë e bukur dhe e nxehtë si shumë ditë të tjera të kësaj vere të jashtëzakonshme. Bulevardi i bukur i Peshkopisë, bulevardi i blinave, që mban emrin e patriotit Elez Isufi, ka ditë që hijeshon nga flamujt, banderolat dhe parullat për 77 vjetorin e krijimit të Brigadës 18 S dhe 77 vjetorin e çlirimit të qytetit. Dita e sotme më duket më e freskët e më gjallëruese, sepse qytetarët dhe të rinjtë e të rejat e Dibrës do të kujtojnë e do të festojnë ditën e çlirimit të rrethit. Sheshi para Pallatit të Kulturës "Haki Stërmilli" gjallëron e hijeshon më shumë. Fasada e tij e zbukuruar me flamuj kombëtarë dhe parullën: "Rroftë 23 gushti", si dhe muzika popullore e dalë nga qendra e zërit e Pallatit të Kulturës që në orët e para të mëngjesit ndezin atmosferën e qytetit. Peshkopia është në festë. Populli dibran sot do të festojë 77 vjetorin e krijimit të Brigadës 18 S dhe çlirimin e Dibrës nga pushtuesit nazifashistë e forcat kolaboracioniste, por do të kujtojë dhe heroizmin partizan të atyre viteve të stuhishme, si dhe gjakun e dëshmorëve e heronjve të rënë për çlirimin e Dibrës.

Ora 10.00. Para Pallatit të Kulturës "Haki Stërmilli" janë mbledhur qindra qytetarë e veteranë, pasardhës veteranë, të rinj e të reja. Pushon muzika. Moderatori Defrim Methasani dhe një grup vajzash të reja, valltare të talentuara, hapin siparin e festës së Çlirimit. Pastaj për këto dy evente e sidomos për ditën e çlirimit të Dibrës dhe gjakun e dëshmorëve të rënë e rëndësinë historike të kësaj lufte çlirimtare që është faqja më e lavdishme e historisë së popullit tonë në shekuj, foli kryetari i bashkisë Shkëlqim Murrja e kryetari i Organizatës së Veteranëve të rrethit shoku Alush Stojku. Përveç dhjetëra qytetarëve, të rinj e të reja e pasardhësve të veteranëve merrnin pjesë dhe përfaqësues të pushtetit lokal si kryetarja e Këshillit të Qarkut Dibër zonja Valentina Haliti, sekretarja e përgjithshme e Prefekturës Dibër, zonja Donika Hyseni, deputeti i zonës Lavdrim Krashi, përfaqësues të Luftëtarëve të Maqedonisë së Veriut nga Dibra e Madhe, z. Nazmi Kurtishi e Sami Strikcani si dhe përfaqësues të organizatës së veteranëve nga të gjithë zonat e rrethit. Merrte pjesë dhe ish deputetja e Dibrës, ish Ministre e Arsimit, shoqja Tefta Cami, bijë dëshmori. Pas përshëndetjeve të autoriteteve të sipërshënuar, nën udhëheqjen e bandës së qytetit, përfaqësues të pushtetit vendor dhe të Organizatës së Veteranëve dhe qindra qytetarë të thjeshtë e punonjës të institucioneve shtetërore u vunë në radhë për të shkuar te varrezat e dëshmorëve.

Ora 11.00. Pas ekzekutimit të Himnit kombëtar u vunë kurora me lule te lapidari i dëshmorëve të rrethit nga Prefektura, Bashkia, Këshilli i Qarkut, Org. e Veteranëve dhe ajo e Dëshmorëve të rrethit, nga grupi i deputetëve dhe pastaj u bënë homazhe nëpër varrezat e dëshmorëve të Luftës NÇl, ku prehen eshtrat e 220 dëshmorëve. Veprimtarinë e kësaj dite festive, ditë përkujtimore, e ndoqën dhe e filmuan 2-3 stacione televizive, si kujtim të kësaj dite plot lavdi e nder për të rënët e kombit. Pas kryerjes së homazheve në varrezat e dëshmorëve të rrethit, njerëzit u kthyen në qytet grupe-grupe, duke biseduar e kujtuar heroizmin e lavdinë e partizanëve tanë trima.

Ora 13.00, përfaqësues të organizatave të veteranëve nga qendra e zonat, përfaqësues të pushtetit lokal e të familjeve të dëshmorëve morën pjesë në një drekë te Hotel- Turizmi i qytetit, organizuar e përgatitur nga bashkia Peshkopi, e cila kaloi bukur e bollshëm, pasi u ngritën dhe shëndete.



Siparin e kësaj dite të bukur festive e mbylli koncerti i bukur artistik i përgatitur nga Shtëpia e Kulturës Peshkopi me regjisor z. Xhelil Imeri dhe skenarist e prezantues z. Defrim Methasani. Koncerti qe i bukur e mbresëlënës. Atë e hapi tenori Kastriot Tusha, i ardhur apostafat nga Tirana, me këngën "Rrjedh në këngë e ligjërime", të cilin e pasuan me këngët e tyre të bukura patriotike e lirike këngëtarët e njohur dibranë si Arif Vladi, Dritan Jashari, Lirie Rasha, Vera Laçi, Elida Shehu, Agim Skara, Ingrit Lushi, Edmond Përnezha si dhe këngëtari nga Dibra e Madhe, Ivzi Kraja (Xiu) e një grup këngëtarësh nga Mirdita. Tingujt e muzikës dhe tekstet e këngëve dibrane shpërndahen e mblidhen nëpër bulevard si ujëvarat e Korabit e valët e Drinit. Koncerti i përgatitur nga shtëpia e kulturës dhe i dirigjuar e prezantuar bukur nga gazetari Defrim Methasani e Vali Zhuka me plot improvizime e batuta kënaqi qytetarët dibranë, të rinjtë e të rejat e këtij qyteti dhe na kujtoi nostalgjinë e dikurshme, kur këto festa e evente historike organizoheshin e festoheshin me krenari e rigorizitet, me një organizim perfekt e të gjithanshëm. Me intervistat e shkurtra e zhbiruese të D. Methasanit, këngëtari me zë Arif Vladi, që është dhe drejtor i Pallatit të Kulturës "Haki Stërmilli" thotë:

-Dibra më rriti, Dibra më dha emër e më dha shpirt, Dibra më dha krenari. Kurse kryetari i bashkisë këtë natë do ta cilësonte si natë të bukur, natë magjike. Këngëtari mirditor Kol Zefi në intervistën e shkurtër të bërë nga prezantuesi tha: - Kështu siç bëri Dibra sot, duhet të bëjnë të gjitha rrethet e Shqipërisë në kujtim të ditës së çlirimit dhe gjakut të dëshmorëve, ngahera e çdo vit se kështu trashëgojmë vlerat e bukura qytetare e liridashëse të brezave të kaluar. Në fund të koncertit me këngën e Dritan Jasharit: "Hej, kjo Dibra maja-maja" publiku u çua në këmbë e në valle për të përjetësuar fjalët himn të kësaj kënge patriotike dibrane.

Autori i këtij reportazhi ka marrë pjesë vazhdimisht në ceremonitë festive të festës së 23 gushtit, por festimi i kësaj ngjarje sot me 23 gusht 2021 ka qenë i bukur e madhështor, më mirë se çdo herë tjetër, pasi kryetari i bashkisë z.Shkëlqim Murrja i dha rëndësinë e duhur organizimit të kësaj feste në të gjitha aspektet. U morën masa organizative 2 javë para festës, pjesëmarrja e popullit dhe e kuadrove në homazhe të varrezat e dëshmorëve qe më e mirë se çdo herë tjetër, dekori festiv i qytetit u bë herët e bukur dhe organizimi i koncertit u bë shkëlqyer në sajë të impenjimit maksimal të drejtorit të Pallatit të Kulturës Arif Vladi e të regjisorit Xhelil Imeri. Sharm i dha kësaj feste dhe prezantuesi dibran Defrim Methasani, mjeshtër i organizimit të eventeve të tilla. Kështu festofsh ngahera Dibra e kuqe, Dibra e pushkës dhe e punës, Festen e Çlirimit të rrethit, në kujtim të dëshmorëve që dhanë gjakun për lirinë që ne gëzojmë sot.

Peshkopi, 23 gusht 2021

Opinion

Kush e shëmton bulevardin "Elez Isufi"?!

Peshkopia është qytet verilindor i Shqipërisë, me një klimë të freskët e të ftohtë gjatë dimrit dhe me verë të ngrohtë e ajër të pastër. Ajo ka bulevardin kryesor "Elez Isufi", si një nga bulevardet më të bukura të Shqipërisë. Bukurinë këtij bulevardi ia japin blinat e mbjellë në të dy anët e tij, që në vitet '50-të,të cilët në pranverë e verë lëshojnë aromë të këndshme, e freskojnë bulevardin me hijet e tyre. Ky bulevard, që mban emrin e patriotit dibran Elez Isufi, pas viteve '90-të është bërë dhe më i bukur me ndërtimet e reja 3-4 katëshe e fasadat e lyera.

Ky bulevard fillon me godinën 5-katëshe të Prefekturës e pastaj me godinën e postë-telegrafës, të ndërtuara në vitet 1980. Më tej, në krah të djathtë të tij ndodhet Pallati i bukur i Kulturës, trekatësh, i ndërtuar në vitet e socializmit, por i përfunduar në vitin 2001. Më tej ndodhet godina e bukur e gjimnazit "Said Najdeni", e ndërtuar që në vitin 1948, por e restauruar dhe e rregulluar më mirë pas viteve 1990. Para Pallatit të Kulturës "Haki Stërmilli" ndodhet monumenti madhështor i Heroit tonë Kombëtar Skënderbeut, si dhe më tej, para godinës së gjimnazit bustet e patriotëve dibranë: Iljaz Pashë Qoku, Said Najdeni, Dom Nikoll Kaçorri. Më tej ndodhet



godina e ish kinemasë së qytetit, e cila këtë vit është restauruar dhe rregulluar mirë nga bashkia e qytetit dhe ka vite që është kthyer në QEK të fëmijëve. Ky bulevard vazhdon më tej me godinën e Raiffeisen-Bank dhe 2 ndërtesat e hotel "Korabit",duke përfunduar me ndërtesën 6-katëshe të sigurimeve shoqërore.

Po ku qëndron shëmtia e këtij bulevardi të bukur? Shëmtia e këtij bulevardi qëndron në dy ndërtesa të amortizuara plotësisht në fillim të bulevardit, krahu i djathtë, të ndërtuara në kohën e Zogut. Ndërtesa e dytë, ku poshtë ndodhet pika e shitjes së gazetave, s'ka as çati, fasadat e shkërmoqura nga erozioni i kohës e shëmtojnë me të vërtetë bulevardin tonë të bukur. Në vitet '70-'80-të të shekullit të kaluar ndërtesa e dytë pa çati ka shërbyer si rezidencë e këshillit të qytetit tonë, me drejtues shokët Destan Aga, Irfan Zebi, etj., kurse sot këto 2 ndërtesa jo vetëm që shëmtojnë bulevardin tonë, por përbëjnë dhe rrezik për jetën e njerëzve.

Pse bashkia Peshkopi nuk nxjerr fond për restaurimin e këtyre dy ndërtesave, siç bëri me ish kinemanë, t'u vërë çati e t'i përdorë për nevojat e saj si zyra apo banesa sociale. Në vendet e tjera të Europës si Zvicër, Austri , Suedi, Francë, etj., restaurimi e lyerja e fasadave është detyrë e bashkive, kurse këtu tek ne kjo shëmti nuk u vret syrin autoriteteve të bashkisë dhe ata s'e vënë ujin në zjarr për riparimin e kësaj shëmtie të bulevardit tonë të bukur.

Nga Besnik Lami

Rruga e Arbërit nr. 179 180

dekorim

Dekorimi i Akademikut shqiptaro-britanik, Profesorit Gëzim Alpion nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta është një nder për të dhe për punën e tij prej akademiku.

Akademiku *shqiptaro-britanik* **Gëzim Alpion** *nderohet me* **"Medaljen Nënë Tereza"**

Nga FRANK SHKRELI

Ditën e martë, më 27 korrik 2021, studiuesit shqiptaro-britanik Gëzim Alpion, sociolog në Universitetin e Birminghamit në Angli dhe biograf i njohur ndërkombtarisht i jetës dhe veprimtarisë së Nenë Terezës, i është akorduar "Medalja Nënë Tereza" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Ilir Meta me motivacionin: "Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e tij të çmuar akademik në studimin thelbësor të jetës dhe aktivitetit si dhe promovimin e Shën Nenë Terezës, duke e lartësuar modelin unik të vlerës së saj kombëtare shqiptare në mbarë btën. I vlerësuar nga kritika botërore si studiuesi më autoritar në gjuhën angleze i Shën Nenë Terezës dhe si një ndër njohsit më inteligjent dhe më të mprehtë të kulturës shqiptare".

Në njoftimin me ketët rast thuhet se, Sipas dekretit No. 13163 të datës 14 Korrik 2021, dekorimi është pra, në shenjë vlerësimi dhe mirënjohje për kontributin e çmuar akademik të Profesorit Alpion, në studimin thelbësor të jetës dhe aktivitetit, si dhe promovimin e Shën Nenë Terezës duke e lartësuar nivelin unik të vlerës së saj kombëtare shqiptare në mbarë botën. Z. Alpion, thuhet më tej në dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, "Është vlerësuar nga kritika botërore si studiuesi më autoritar në gjuhën angleze i Shën Nenë Terezës dhe si një ndër njohësit më inteligjentë dhe më të mprehtë të kulturës shqiptare."

Siç dihet, 'Medalja Nënë Tereza' është një nga çmimet më të larta që akordohet nga Presidenti i Shqipërisë. Sa për të pasur një ide dhe për informacion të lexuesit, disa nga personalitetet e huaja dhe shqiptare që janë nderuar me këtë çmim të Republikës së Shqipërisë, ndër vite, përfshijnë Kryeministrin e Italisë Massimo D'Alema, Presidentin e Kroacisë Stjepan Mesić, Presidentin e Lituanisë Valdas Adamkus, Presidentin e Kosovës Behgjet Pacolli, Mary Jean Eisenhower, Kryetare e Programit 'People to People International' (PTPI), i krijuar në vitin 1956 nga gjyshi i saj Presidenti Dwight D. Eisenhower, dhe ish-Senatori amerikan, Sam Brownback, Ambasadori i SHBA-së për Lirinë Ndërkombëtare Fetare.

Në njoftimin për media për dekorimin e Profesorit Gëzim Alpion me "Medaljen Nenë Tereza", thuhet se kjo është hera e dytë që Profesori shqiptaro-britanik Gëzim Alpion nderohet në Shqipëri. Në vitin 2019, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama i akordoi Z. Alpion çmimin, "Ambasador i Kombit".

'Medalja Nënë Tereza' është një nga çmimet më të larta që akordohet nga Presidenti i Shqipërisë.
Sipas dekretit No. 13163 të datës 14 Korrik 2021, dekorimi është pra, në shenjë vlerësimi dhe mirënjohje për kontributin e çmuar akademik të Profesorit Alpion, në studimin thelbësor të jetës dhe aktivitetit, si dhe promovimin e Shën Nenë Terezës duke e lartësuar nivelin unik të vlerës së saj kombëtare shqiptare në mbarë botën.





Z. Alpion, thuhet në dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, "Është vlerësuar nga kritika botërore si studiuesi më autoritar në gjuhën angleze i Shën Nënë Terezës dhe si një ndër njohësit më inteligjentë dhe më të mprehtë të kulturës shqiptare."

Libri më i ri i Profesorit Alpion titullohet "Mother Teresa — The Saint and her Nation", ose "Nënë Tereza – Shenjtëresha dhe Kombi i Saj", botuar një vit më parë nga shtëpia botuese britanike "Bloomsbury". .

Ky libër është i pari i këtij lloji, në anglisht, që e trajton Nënë Terezën në kontekstin e rrënjëve të saja etno-shpirtërore, duke e shikuar misionin dhe thirrjen e saj fetare prej murgeshe, si një pasqyrim i historisë së trazuar të popullit shqiptar gjatë dy mijë vjetëve të kaluara. Dr. Alpion sugjeron, në librin e tij, "Nënë Tereza – Shenjtëresha dhe Kombi i Saj", se ekziston nevoja për studime objektive të mëtejshme që të pasqyrohet roli vendimtar i fesë, gjatë shekujve, në përcaktimin e identitetit kombëtar, por edhe roli fetar në justifikimin e aneksimeve territoriale të rajonit të Ballkanit.

Dekorimi i Akademikut shqiptaro-britanik, Profesorit Gëzim Alpion nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Ilir Meta është një nder për të dhe për punën e tij prej akademiku – i cili duke e paraqitur Nenë Terezën në konteksin e rrenjëve të saja etno-shpirtërore i paraqet, njëkohësisht, botës një frymë të njomë, më fisnike dhe më frytdhënse, se ato për të cilat fatkeqsisht na njeh bota si shqiptarë, për arsye të historisë tonë të shekullit të kaluar por edhe më mbrapa.

Prof. Gëzim Alpion — duke u folur të huajve dhe duke shkruar për Nenë Terezën në gjuhën e tyre — ai po ben një shërbim të madh për t'i kujtuar botës anglisht-folëse, traditat dhe zakonet tona shekullore të cilat mund të jenë ndryshkur gjatë shekujve, duke zbuluar kështu — sidomos për të huajt por edhe për shqiptarët — bukurinë që fshihet në thellësitë shpirtërore dhe stërgjyshore të Kombit shqiptar, ashtu siç pasqyrohen edhe nga jeta dhe veprimtaria e Shën Nenë Terezës. Urime Prof. Dr. Gëzim Alpion. Një dekoratë e merituar!

* * *

Kush është prof. dr. Gëzim Alpion:

Profesori Alpion është arsimuar në Universitetin e Kajros dhe në Universitetin Durham, ndërsa ka ligjëruar në universitetet britanike, Huddersfield, Sheffield Hallam dhe Neëman, para se të emërohej në vitin 2002 në Departamentin e Sociologjisë në Universitetin Birmingham. Prej aty, në vitin 2010, ai kaloi në Departamentin e Shkencave Politike dhe Studimeve Ndërkombëtare dhe në vitin 2016, ai iu bashkua Departamentit të Politikave Sociale, Sociologjisë dhe Kriminologjisë, po në Universitetin e Birminghamit. Specializimet e Profesorit Gëzim Alpion janë në disa fusha akademike, përfshirë sociologjinë e fesë, nacionalizmin, famën, racën, median, filmin dhe autorësinë. Mbi të gjitha, Dr. Alpion konsiderohet si autori më i njohur, në gjuhën anglisht, i jetës dhe i veprimtarisë së Shën Nënë Terezës dhe është, njëkohësisht, edhe themeluesi i "Studimeve mbi Nënë Terezën".

Nga **Arben ÇOKAJ**
Frankfurt am Main, Gjermani

Alpion është një ndër studiuesit dhe autorët më të shquar anglisht-shkrues të kohës sonë, që merret me sociologji dhe me historinë e zhvillimet shqiptare, dhe ndër autorët më të besueshëm të përshkrimit të historisë rreth Nënë Terezës, murgeshës së famshme, që u bë e njohur me kontributin e saj humanitar. Besueshmëria e Alpion vjen nga fakti se ai bazohet në burime të ndryshme, ku deduktimi i të dhënave që ai merr, bëhet nga një filtër sociologjik e historik, dhe jo fetar, duke e ngritur figurën e Nënë Terezës në një nivel diskutimi akademik. Ky ishte edhe misioni i tij edhe në këtë monografi.

Libri në fjalë është me vlerë të madhe, sidomos për shqiptarët, me një dendësi dhe koncentrim faktesh e historish, që lidhen me Nënë Terezën e rreth saj, me shqiptarët dhe rrënjët kulturore të murgeshës, me kombin që e nxori atë si personalitet të veçantë në kulturën dhe ndërgjegjen shoqërore mbarë-botërore.

Alpion e ndan librin e tij në 3 pjesë, ku përfshihen 15 kapituj. Pjesa e parë merret me "*Kush ishin shqiptarët e Nënë Terezës?*", me 6 kapituj. Pjesa e dytë, "*Historia nga poshtë: Rrënjët shqiptare të Nënë Terezës dhe vitet në Shkup*", me 5 kapituj. Dhe pjesa e tretë, "*Marrëdhëniet e Nënë Terezës me Selinë e Shenjtë dhe kombin shqiptar*", me 4 kapituj.

Në hyrjen e librit autori ndalet që në fillim te origjina e Nënë Terezës, të cilën ajo e pranoi botërisht në vitin 1979, kur mori çmimin Nobel për paqe në Oslo. Ajo tha: "Me gjak dhe me origjinë, unë jam shqiptare". Alpion thekson: "*Nënë Tereza është një hibrid i 'heronjve' shpirtërorë të identifikuar nga Thomas Carlyle (1841), 'kapitenëve' të përkushtuar të lavdëruar nga Samuel Smiles (1859) dhe të famshmit e kudo-ndodhur të epokës së medias, të qortuar nga Daniel J. Boorstin (1962). Kompleksiteti i figurës së saj përcakton natyrën multidisiplinare dhe ndërdisiplinore të këtij studimi.*"

Më pas në hyrje, Alpion vë në dukje trashëgiminë etno-kulturore të Nënë Terezës dhe thekson: "*Trauma, sfidat dhe arritjet e Nënë Terezës si person dhe misionare, dhe kompleksiteti i saj shpirtërore, duhen trajtuar në kontekstin e rrënjëve të saj. Kjo bazë është thelbësore për të kuptuar se si kjo ikonë moderne shpirtërore dhe humanitare arriti të mishërojë ADN-në 'kulturore dhe shpirtërore' të kombit të saj të lashtë*" (f. 3). Alpion sqaron se "[*n*]ë *këtë studim, unë e përdor konceptin e 'ADN-së' njëkohësisht në kuptim kulturor dhe shpirtëror, si dhe në një kontekst më specifik, krahasuar me mënyrën se si Gurnek Bains e përdor atë kur trajton 'ADN-në kulturore'*" (f. 210).

Ndërsa në Pjesën e Parë, autori ndalet në historinë hershme të shqiptarëve. Në kapitullin e parë, *"Viktimizimi i shqiptarëve"*, ndër të tjera autori ndalet në traktatin e Berlinit, si rezultat i të cilit shqiptarët u ndeshën me një kërcënim ekzistencial. Alpion thekson se fjalët e Otto von Bismark, se "*Shqipëria është thjesht një shprehje gjeografike: nuk ka komb shqiptar*", mund të ishin bërë "epitafi i popullit shqiptar" (f. 10).

Alpion i referohet më pas edhe Aleksandër Lambert, i cili pretendon se ndryshimi i emrit të rajonit nga '*Iliri*' në '*Ballkan*', në fund të shekullit XIX-të dhe në fillim të shekullit XX-të, duhet parë në kontekstin e tendencës së fuqive të mëdha të kohës, për të injoruar shqiptarët dhe për të minuar historinë e tyre, veçanërisht pas vitit 1878 të Kongresit të Berlinit.

Roma dështoi ta latinizonte plotësisht popullin e Ilirisë, thekson Alpion. Serbët nuk mundën ta sllavizonin plotësisht Dar-

→

monografi

Monografia "Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj" është studimi më i fundit i Gëzim Alpion për figurën dhe personalitetin e humanistes së madhe shqiptare.

"Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj"

Studimi i Alpion nuk është një biografi në vetvete. Megjithatë, pasuria e informacionit e regjistruar këtu për herë të parë dhe analiza që ofrohet në këtë studim dëshmojnë se, ndryshe nga ç'është pretenduar nga disa biografë dhe hagiografë të Nënë Terezës, edhe kjo murgeshë ka biografinë e saj.



Gëzim Alpion
"*Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj*"
Bloomsbury: New Delhi, London, Oxford, New York, Sydney: 2020,296 faqe
ISBN: HB: 978-93-89165-05-0& 978-9389165-04-3; *eBook*:978-93-89165-06-7
https://www.bloomsbury.com/uk/mother-teresa-9789389165067/

daninë në shekujt XIII-XV-të e as më pas në shekullin e XIX-XX-të. As otomanët nuk mundën ta otomanizonin Ilirinë, përgjatë 5 shekujve të pushtimit. Kështu Alpion vazhdon me ekspozimin e historisë së kombit të Nënë Terezës, që nga antikiteti ilir, e deri në epokën postmoderne.

Në kapitullin e parë, vëmendja është në historinë e trazuar të kombit shqiptar nga gjysma e dytë e shekullit XIX deri në fund të shekullit XX, kohë kur kanë jetuar edhe gjyshërit, prindërit, vëllai dhe motra e Nënë Terezës. Po këtu, katalogohen përpjekjet e Greqisë dhe Jugosllavisë për pastrimin etnik të territoreve të banuara nga shqiptarët, në periudhën e fundit të dhe pas shembjes së Perandorisë Osmane, si dhe shqyrtohet agjenda prapa pretendimit se gjoja shqiptarët kanë ardhur 'vonë' në Ballkan.

Kapitulli i dytë sfidon mitin e shqiptarëve si 'dashamirësit' e sundimit osman. Ai ekspozon disa nga marrëveshjet e hapura dhe të fshehta të Perandorisë Osmane dhe pasardhëses së saj, Turqisë, me Serbinë, Jugosllavinë dhe Greqinë, për të ndryshuar përbërjen demografike të territoreve të populluara nga shqiptarët, në dëm të kombit shqiptar. Duke u mbështetur në disa gjetje kryesore të Ilirologjisë dhe Albanologjisë në katër shekujt e fundit, kapitulli i tretë eksploron gjenealogjinë Pellazgo-Ilire të shqiptarëve modernë, ku jepet edhe një përmbledhje e rrënjëve apostolike të krishterimit shqiptar.

Kapitulli i katërt regjistron sfidat kryesore me të cilat u përballën ilirët dhe pasardhësit e tyre modernë, shqiptarët, për të ruajtur besimin e krishterë. Fokusi është në përpjekjet e serbëve dhe osmanllinjve për të minuar krishterimin ndër shqiptarë. Këtu analizohet edhe ndikimi i agjendës së Selisë së Shenjtë mbi Evropën Juglindore, dhe në pjesë të ndryshme të kombit shqiptar, që nga fillimi i Mesjetës. Alpion konkludon se Selia e Shenjtë u tregua indiferente ndaj fatit të kombit shqiptar në shekujt XIX-të dhe XX-të, duke favorizuar kështu sërbet dhe Kishën Ortodokse Serbe.

Në kapitullin e pestë eksplorohet mbijetesa e katolicizmit romak në Kosovë, në kontekstin e disa profesioneve të lidhura me njerëzit, që ndjekin këtë besim, ku vëmendja u kushtohet kryesisht bukëpjekësve dhe argjendarëve. Alpion vë në dukje faktin se, shqiptarët e marrin për të dhënë që identiteti i tyre kombëtar është parësor mbi atë fetar. Kjo vihet re te emrat shqip, që shqiptarët zgjedhin për fëmijët e tyre, e jo emra fetarë.

Në kapitullin e gjashtë përdoret një perspektivë onomastike, për të ilustruar përpjekjet e katolikëve romakë shqiptarë për ruajtjen e identitetit të tyre etnik dhe besimit fetar. Këtu përmenden emrat e Nënë Terezës, vëllait dhe motrës së saj, si shembuj që nxjerrin në pah një të përbashkët të dukshme: mënyrën se si shqiptarët i emërtojnë fëmijët në momente kritike të historisë kombëtare. Nikollë Bojaxhiu ia vë emrin 'Gonxhe', vajzës së tij të vogël, e cila më vonë do bëhej humanistja e madhe Nënë Tereza.

Në këtë kapitull tërheq vëmendjen poezia, që Goxhja e mitur, në moshën 9 vjeçe, kishte krijuar për të kaluar traumën dhe dhimbjen e madhe, që ajo dhe familja e saj përjetuan me vrasjen e të atit. Në vitin 1946, Motër Tereza i tregon për poezinë e saj një vajze të trembur nga dhuna që kishte shpërthyer ato ditë në Kalkutë. Murgesha shqiptare e kështillon nxënësen të mos trembej, por të shkruante e recitonte me veten një poezi, siç kishte bërë ajo në moshë nëntë vjeçe kur i kishin vrarë babain. "Mesazhi i poezisë është *të besosh në dashuri, Marie, edhe kur çdo gjë, që sheh rreth teje, është urrejtje dhe shkatërrim*", e qetëson vajzën Motër Tereza (f.78).

Pesë kapitujt në vijim (*7-11*) përqendrohen kryesisht në gjenealogjinë e murgeshës shqiptare dhe vlerësojnë ndikimin e prejardhjes së saj në vendimin për t'u bërë murgeshë dhe në natyrën e misionit të saj bamirës. Shumica e informacionit dhe analizave të regjistruara këtu, në lidhje me Nënë Terezën, shfaqen për herë të parë. Me rëndësi, që në fillim, del në pah origjina:

Prindërit e Nënë Terezës vijnë nga Kosova. Të dy kanë lindur në rajon. Origjina e gjyshërve dhe gjysheve të murgeshës është më komplekse. Ndërsa të katërt ishin shqiptarë etnikë, ka arsye për të besuar, se ata e kishin origjinën dikur nga Mirdita, një rajon në veri të Shqipërisë." (f. 83)

Kapitulli i shtatë hulumton rrënjët dhe profesionet e të afërmve atërorë të Nënë Terezës si dhe përpjekjet e tyre për të ruajtur besimin katolik romak. Të injoruar plotësisht nga biografët e Nënë Terezës deri më sot, të afërmit e nënës së murgeshës janë thelbësor për katër kapitujt e tjerë.

Kapitulli i tetë përqendrohet në tre aspekte të rëndësishme: rajoni në Shqipëri, migrimi i tyre në Kosovë dhe pasojat e përfshirjes së tyre në fenomenin e gjakmarrjes. Bëhet fjalë për familjen e Rozës (e cila njihej edhe me emrin Drane), nëna e Nënë Terezës. Të afërmit e Rozës ikën nga Mirdita dhe u vendosën në fshatin Novosellë në Kosovë, ku i ati i saj, Ndue Bardhi bëri shtëpinë më të madhe dhe më impresionuese në fshat. Por në pak vite, Ndues i vrasin të atin Pjetrin, pastaj vrasin edhe Nduen, e kur vrasin edhe të vëllain e Rozës, Gjonin, e ëma e Rozës, Drania, merr fëmijët e saj dhe largohet nga fshati për në Shkup. Shtëpia e Ndues u rrëzua nga regjimi komunist jugosllav në vitin 1974, kur u bë e qartë se Nënë Tereza po bëhej ylli i ri i krishterimit katolik. Serbët ortodoksë nuk donin të linin asnjë shenjë në Kosovë që kishte të bënte me origjinën shqiptare të të parëve të saj.

Kapitulli i nëntë tregon detaje të panjohura për prindërit e Nënë Terezës në Shkup, para fejesës së tyre dhe si çift i martuar. Vëmendja pastaj zhvendoset në historitë mjaft të pazakonta të suksesit të dy individëve: dajës Mark të Nënë Terezës dhe babait të saj, Nikollë. Por ky sukses nuk zgjati shumë.

Kapitulli i dhjetë tregon disa nga momentet më të trishtueshme në jetën e Nënë Terezës, gjatë viteve të saj në Shkup dhe vlerëson ndikimin e tyre afatgjatë mbi të. Vëmendja në këtë kapitull është kryesisht në vdekjet, në harkun e tre viteve, të babait të saj (si rezultat i një vrasje me motive politike) dhe i shtatë anëtarëve të familjes së dajës së saj (kryesisht nga Gripi Spanjoll: 1918-1920). Këtu si duket e ka fillesën edhe ajo që konsiderohet si "nata e errët e shpirtit" të Nënë Terezës, ose e thënë ndryshe, dyshimi i saj në besimin në Zot, me të cilën është marrë dhe po merret Alpion. Partneri venecian i Nikollës, ia merr të gjithë pasurinë atij, duke e lënë gruan e tij të ve dhe 3 fëmijët, pa asnjë burim të ardhurash.

Kapitulli i njëmbëdhjetë prezanton një anëtar të ri, deri tani të panjohur, të familjes së Nënë Terezës: vajzën e dajës së saj ose motrën e adoptuar, Filomenën, gjashtë vjet më e re se Gonxhja, e vetmja anëtare e mbijetuar e familjes së dajës Mark, pas vdekjes së tyre nga gripi spanjoll dhe vdekjes në fund edhe të nënëdajes Drane. Bazuar në kujtimet e Filomenës, kapitulli ofron një tregim të ri, të gjashtë viteve të fundit të Nënë Terezës në Shkup, përpara se ajo të hynte në jetën fetare dhe shkaqet, që e drejtuan atë drejt besimit. Filomena trashëgoi një pasuri jo të vogël nga i ati, të cilën e përdori për të shkolluar në Austri vëllain e Nënë Terezës, Lazrin, dhe motrën e saj, Agen në Beograd. Filomena mbeti vetëm me nënën Roza, pasi Lazri dhe Agia ikën për në Shqipëri, dhe Gonxhja u nis drejt Irlandës në vitin 1928, e më pas drejt Indisë, për t'u bërë pjesë e misionit fetar Loreto, si murgeshë.

Pjesa e Tretë, eksploron personalitetin, punën dhe trashëgiminë e Nënë Terezës nga dy këndvështrime. Nga njëra anë, përqendrimi këtu është në rolin domethënës, që Vatikani ka luajtur në jetën e Nënë Terezës, si besimtare dhe mbështetjen, që ajo mori kur ky institucion fetar e kuptoi rëndësinë e shërbesës së saj, për katolicizmin romak, në kontekstin e Indisë. Nga ana tjetër, kjo pjesë e librit analizon marrëdhëniet e saj me vendin e lindjes dhe njerëzit, që nga vitet e para të saj në Shkup, deri në fund te jetës.

Kapitulli i dymbëdhjetë eksploron qëndrimin e Vatikanit ndaj kombit shqiptar gjatë gjithë jetës së Nënë Terezës. Theksi këtu vihet kryesisht në marrëdhëniet komplekse të këtij institucioni me shtetin modern shqiptar, që nga fillimi i shekullit XX dhe qëndrimi i tij ndaj Kosovës gjatë dhe pas luftës së vitit 1999. Ky kapitull shërben si një sfond i dobishëm, për të kuptuar ndikimin e Vatikanit në qëndrimin e Nënë Terezës ndaj popullit shqiptar, nivelin e interesimit dhe angazhimin me pjesë të veçanta të kombit të saj të copëtuar.

Kapitulli i trembëdhjetë ka një trajtesë mjaft intelektuale të shkaqeve që e çojnë Nënë Terezën drejt misionit fetar. Humbjet që ajo pësoi në jetë, sidomos të babait të saj, bënë që ajo ta shohë figurën e Jezusit si mbrojtës, pas zbrazëtisë së madhe, që i la i ati i vrarë. Pohimi kryesor këtu është se, përveç përcaktimit të vendimit të saj për t'u bërë një murgeshë, këto humbje gjithashtu kontribuan në tjetërsimin e saj nga familja, populli dhe kombi i saj. Në moshën 12 vjeçare, Goxhja mori 'thirrjen e parë', që të bëhet murgeshë, por jo me 'vizione' siç ka ndodhur në raste të mistikëve të tjerë. E ëma e Goxhes, Roza nuk donte, që e bija të bëhej misionare dhe u mbyll për 24 orë në dhomën e gjumit, kur mësoi se e bija ishte pranuar si murgeshë nga urdhëri i Loretës. Goxhe i tha të ëmës kur u largua nga Shkupi në 1928: "*Nuk do të flas më shqip derisa të takohemi herën tjetër*". Ata nuk u takuan kurrë më, pasi u ndanë pas disa ditësh në Sarajevë.

Po ashtu edhe i vëllai Lazri, tashmë oficer në ushtrinë mbretërore shqiptare, e kështilloi Gonxhen të hiqte dorë nga ky synim, pasi ajo "po e varroste veten për së gjalli në Indi". Gonxhja, e fyer, ju përgjigj: "*Ti mendon se je i rëndësishëm, se je oficer dhe i shërben një mbreti të dy milion njerëzve. Unë i shërbej mbretit të të gjithë botës! Cili prej nesh është më mirë?*" (f. 167).

Kapitulli i katërmbëdhjetë tregon se Nënë Tereza e kuptoi që nga fillimi i jetës së saj misionare se krishterimi nuk i heq diskriminimet. Duke u bazuar në trajtimin e saj në Loreto, argumenti kryesor këtu është se ajo ishte diskriminuar nga disa eprorë irlandezë në Kalkutë, për shkak të origjinës së saj etnike si shqiptare gjatë shtatëmbëdhjetë viteve, që ajo ishte anëtare e këtij komuniteti. Murgeshat irlandeze shkuan deri aty, sa e akuzuan atë si të 'çmendur', dhe aluduan se ajo kishte patur 'marrëdhënie jo normale', një eufemizëm për '*aferë seksuale*' me drejtorin e saj shpirtëror, atë Celeste Van Exem, gjë që nuk ishte e vërtetë.

Kapitulli i fundit e krahason dhe vë në kontrast Nënë Terezën me Gjergj Kastriotin, dy personalitetet më të njohura shqiptare që nga shekulli XV. Theksi këtu është në zgjedhjet dhe përparimin e tyre të karrierës dhe marrëdhëniet e tyre me familjet dhe kombin e tyre. Alpion mendon se këto dy figura nuk mund të krahasohen në të njëjtin plan. Kapitulli vlerëson megjithatë rëndësinë e vizitave të Nënë Terezës (1989-1995) në Shqipëri dhe rëndësinë e tyre për kombin shqiptar, si dhe në përmirësimin e marrëdhënieve me Vatikanin.

Studimi i Alpion nuk është një biografi në vetvete. Megjithatë, pasuria e informacionit e regjistruar këtu për herë të parë dhe analiza që ofrohet në këtë studim dëshmojnë se, ndryshe nga ç'është pretenduar nga disa biografë dhe hagiografë të Nënë Terezës, edhe kjo murgeshe ka biografinë e saj.

Me Nënë Terezën, në mënyrë të pavetëdijshme dhe të vetvetishme, kombi shqiptar i dha botës një pjesë të shpirtit të vet. Doli në dritë në një formë universale e altruiste, dëshira jo-egoiste e shqiptarëve, për të bërë mirë më shumë për të tjerët, se sa për veten e tyre.

Rruga e Arbërit nr. 179 180
koment

Ekipi i stërvitjes së Luizës që bënë krenar gjithë shqiptar është i cunguar, pa mjek profesional, pa psikolog, pa seanca coaching që maksimalizojnë dhe harmonizojnë faktorët psikologjikë të sukseseve të saj.

Luiza - kampionia olimpike përpara së cilës duhet të ndjehemi të turpëruar

Nga **ARBEN MALAJ**

Ishte ftesa e Robb, PAM dhe ekipit të Qendrës Lincoln (https://lincolnalbania.org/) që më krijoi mundësinë e jashtëzakonshme të njihja nga afër Luiza Gegën, atleten tonë olimpike dhe fituese të shume çmimeve ndërkombëtare dhe trajnerin e saj Taulant Stermasin, vlerat e tyre humane dhe sukseset e përbashkëta sportive.

Rrëfimi jetësor i Luizës dhe Taulantit, vështirësitë e saj kritike për të arritur këto rezultatet, kushtet minimale të stërvitjes aq sa në Tiranë stërvitet në një pistë të shtruar me mbetje qymyri që janë të dëmshme për shëndetine saj.

Stërvitjen bazike të përditshme duhet ta bëj në stadiumin e Elbasanit, ku i kërkonin të paguante për përdorimin e pistës - shpresoj të jetë zgjidhur.

Ndërsa Universitetet më elitare në botë u ofrojnë bursa sportistëve dhe artistëve që krijojnë modele suksesi, Luiza kishte paguar edhe tarifa studimi penalizuese sepse nuk i kishte dhënë në kohën e duhur provimet duke e paguar vetë një kosto rreth 1 milion lekë më shumë për arsimimin e saj në Akademinë e Sporteve.

Mbështetja nga Ministria dhe Bashkia e Tiranës është minimale.

Fisnikëria e Luizës u shfaq në faktin se, trajneri i saj dhe Luiza, kanë bindjen se një brez i ri i vajzave atlete me premisa për të qenë kampionët e ardhshme, ekziston në Shqipëri, por kërkohet një përkujdesje e veçante dhe një proces trajnimi intensiv dhe thellësisht profesional kanë një perspektivë shumë premtuese. Por përgjigjja burokratike e MASR për të filluar një program trajnimi të dedikuar për to për një prezantim dinjitoz në Olimpiadën e Parisit 2024 - ishte jo vetëm zhgënjyese.

Mbështetja financiare për Luizën, trajnerin e saj dhe atletet e reja me perspektive sfiduese është në nivele minimale dhe penguese për trajtimin e përditshëm dhe për përgatitjet intensive në prag dhe gjatë garave në nivele rajonale, evropiane dhe olimpike.

Ekipi i stërvitjes së Luizës që bënë krenar gjithë shqiptar është i cunguar, pa mjek profesional, pa psikolog, pa seanca coaching që maksimalizojnë dhe harmonizojnë faktorët psikologjikë të sukseseve të saj.

Nga ajo darkë dhe ai aktivitet i mrekullueshëm fisnik i qendrës "Lincoln" dhe me fokus mirënjohjen ndaj Luizës - ika i trishtuar.

Luizës publikisht i premtova se do të lobojа dhe ndihmoja të financonte kostot shtesë të përditshme fillimisht me një mbështetje 2000 euro në vit të ndara proporcionalisht për çdo muaj.

Fatmirësisht kompania e parë që kontaktova u shpreh menjëherë e gatshme për këtë financim. Besoj dhe këmbëngul se në komunitetin e biznesit por edhe shoqëria jonë në tërësi ka shumë njerëz fisnikë mirënjohës për Luizat dhe çdo sportist apo artist që na bën krenarë. Shumë prej tyre nuk i njohin këto vështirësi fizike dhe financiare të Luizave kampione.

Luiza është një heroinë e heshtur, e ndrojtur të flasë për jetën, vështirësitë dhe sukseset e saj, deri e zverdhur në fytyrë për të mos e bërë publike jetën dhe karrierën e saj të vështirë.

Një kërkesë publike për mediat e vendit tim- i ftoni ose i "detyroni" ata që na bëjnë krenarë me arritjet e tyre - të ndajnë me publikun rrugëtimin e tyre, t'i tregojnë vështirësitë e suksesit, të inspirojnë të rinjtë në çdo lagje, fshat dhe qytetet të vendit tonë për të qenë më ambiciozë, për ta arritur dhe jo pritur suksesin.

Një kërkesë publike për ata që nuk lënë rast për t'ua "vjedhur" një pjesë të suksesit kampionëve tanë - me foto, me lajme, me vizita apo takime publike të "rastësishme" - edhe pse mbështetja e tyre reale për suksesin e Luizave është më pak se minimale - financoni me prioritet kampionet jo thjeshtë këngëtaret e koncerteve elektorale apo koncertet qiellgërvishtëse.

Mirënjohje Luizës për krenarinë që i dhuron shqiptarëve!!

Mirënjohje Taulantit - trajnerit të Luizës së suksesshme!!

Falënderim të veçantë Pam, Robb dhe kolegëve të mrekullueshëm të"LincolnCenter".

Le të bashkohemi me kontribute sado modeste që t'i inspirojmë, mbështesim dhe t'iu shprehim mirënjohjen reale talenteve dhe kampionëve tanë në sport, në art, në shkencë.

** Publikuar për herë të parë në faqen personale të autorit në Facebook.*

Gara e 3000 metrave me pengesa

Gega zë vendin e 13 në botë

Luiza Gega doli e 13-ta në botë në finalen e atletikës për 3000 metrave me pengesa më Olimpiadën e Tokyos. Ajo shënoi kohën 9:34.10.

Gega është sportistja e parë që arrin në finalen e lojrave Olimpike deri më tani.

Ajo u bë sportisja e parë shqiptare që fitoi një medalje në atletikë në kampionatet evropiane në 3000 metra për femra në vitin 2016 në Amsterdam, Holandë.

Ajo doli e katërta në Kampionatin Evropian në vitin 2018, në Berlin me kohën 9:27.78.





> Luiza është një heroinë e heshtur, e ndrojtur të flasë për jetën, vështirësitë dhe sukseset e saj, deri e zverdhur në fytyrë për të mos e bërë publike jetën dhe karrierën e saj të vështirë.

> Një kërkesë publike për ata që nuk lënë rast për t'ua "vjedhur" një pjesë të suksesit kampionëve tanë - me foto, me lajme, me vizita apo takime publike të "rastësishme" - edhe pse mbështetja e tyre reale për suksesin e Luizave është më pak se minimale - financoni me prioritet kampionet jo thjeshtë këngëtaret e koncerteve elektorale apo koncertet qiellgërvishtëse.

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**,
por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...
JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!
Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

Bëj pajtimin tënd me PayPal
përmes emailit **<rrugaearberit@gmail.com>**
Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

cyan magenta yelloë black

Gara qe vërtet e madhe jo vetëm nga pjesëmarrja e sportistëve, jo vetëm nga pjesëmarrja e të ftuarve por, e në radhë të parë, nga cilësia e saj dhe trofetë që u fituan

Një "kala" në Kalanë e Bashtovës

Nga **GAFUR MUKA**



Përzhitës ishte dielli dje, e përflakur u bë mbrëmja në Kalanë e Bashtovës. E përflakur në shkëlqim, e përndritur në fitore dhe e malkulmuar për arritjen e madhe-kurorëzimin kampion bote në KikBox për një djalë Bulqize, nxënës të kampionit të madh Ismail Keta, Ferit Ketën.

Shumica e atyre që u nisën drejt Kalasë udhëtonin përherë të parë. Pejsazhi gjatë gjithë rrugës të ofronte fushë, ndërsa udhërrëfyesi ishte i regjistruar për tek Kalaja. Çfarë kalaje mund të ketë këtu midis fushës? - pyesnin të gjithë ata të herës së pare. Kur ja, midis fushës, krejt afër detit dhe pothuajse në lartësinë e tij, ngrihen muret e një kalaje. Tani nuk është më nevoja e internetit për të të shpjeguar historinë e saj, atë e dinë të gjithë ata që banojnë aty pranë. Gjithë kjo prurja e sotme për to ngjan me një karvan furnizues. Po me çfarë do të furnizojnë ardhësit e sotëm këtë kala të moçme? Padyshim me vlera-mendojnë vendasit. Dhe nuk gabojnë. Këtë radhë kjo kala do të marrë aq vlera sa me to do mjaftonte të ngrihej një "kala" tjetër, ajo e vlerave.

E pati këtë fat Kalaja e Bashtovës në sajë të angazhimit të ish kryetarit të saj të ndjerë Haxhi Memolla. Një takim i rastësishëm me të- tregon kampioni, trajneri, atdhedashësi dhe humanist i rrallë Ismail Keta- më bëri t'ja premtoj një aktivitet në këtë kala, pikërisht atij burri që me heshtjen e tij fisnike këmbëngulte për të promovuar vlerat e veçanta turistike të saj. Por...Haxhiu ndërroi jetë në stadiumin e vendlindjes sime, Dibër. Duket se u prishën planet, kur një ditë mësoj se kryetari i ri i bashkisë së Rrogozhinës ishte nipi i të ndjerit Haxhi, Edison Memolla, i cili më telefonoi për ta shpënë në vend amanetin e xhaxhait të tij. Të them të derjtën m'u bë qejfi për interesimin por...kush ishte ky Edisoni?!. Për ta njohur më nga afër organizuam një takim. Gjatë takimit unë u binda që të angazhohesha për t'a shpënë në vend amanetin e Haxhiut.

Dhe sonte, në këtë aktivitet e mori fjalën, i emocionuar sa më s'ka, edhe Edisoni. Ai e falënderoi në mënyrë të veçantë Ismailin dhe ekipin e tij. Ai falënderoi me gjithë zemër pjesëmarrësit në aktivitet. Po ashtu ai u blatoi respekt dhe mirënjohje atyre që sponsorizuan dhe e mundësuan këtë garë të madhe sportive aty, në kështjellë të Boshtovës.

Dhe gara qe vërtet e madhe jo vetëm nga pjesëmarrja e sportistëve, jo vetëm nga pjesëmarrja e të ftuarve por, e në radhë të parë, nga cilësia e saj dhe trofetë që u fituan. Pikërisht, aty në Bashtovë, u kurorëzua një Kampion Bote, nxënësi dhe njëkohësisht vëllai i Ismailit e Gjetanit, Ferit Keta. Aty u rikonfirmua si kampion Europe gjermani Pascal Wollters, aty nisi karrierën me fitore kundër një boksieri të fortë serb, Ervin Keta, aty fitoi me dinjitet një ndeshje dinjitoze tetovari Lulzim Ismaili, aty regjistroi edhe një fitore të radhës boksieri durrsak me origjinë dibrane Ardit Murja, aty dy boksierë rreth 10 vjeçarë matën forcat e tyre me premtimin që një ditë do të bëhen zotër të ringut.

Në këtë kala të Bashtovës ishin të pranishëm shumë personalitete, ku nuk mund të mos përmendet prezantuesi

Në përfundim të aktivitetit ndjehesh krenarë: për kurorëzimin me shumë sukses të punës së palodhur të Ismail e Gjetan Ketës, për trofeun e madh të Ferit Ketës, për nismën premtuese të Ervin Ketës, për sedrën garuese të Mikel Alliut, për konfirmimin e formës së mirë sportive të Lulzim Ismailit, për rritjen e koleksionit të fitoreve të Ardit Murjes

i shquar amerikan Mike Matham, i cili krahas Dëfrim Methasanit e Hygerta Sakos bënë që këtë ndeshje ta ndiqnin e t'a shijonin miliona shikues. Po ashtu platforma televizive gjermane Bild ua përcolli mbi 120 milion shikuesve të saj drejtpërsëdrejti Kalanë e Bashtovës, aktivitetin brenda saj por edhe një pjesë të potencialeve turistike të vendit tonë.

Në përfundim të aktivitetit ndjehesh krenarë: për kurorëzimin me shumë sukses të punës së palodhur të Ismail e Gjetan Ketës, për trofeun e madh të Ferit Ketës, për nismën premtuese të Ervin Ketës, për sedrën garuese të Mikel Alliut, për konfirmimin e formës së mirë sportive të Lulzim Ismailit, për rritjen e koleksionit të fitoreve të Ardit Murjes, për organizimin e suksesshëm dhe mbështetjen me zemër të Bashkisë Rrogozhinë si dhe për kontributorët shumë të vlefshëm që sponsorizuan këtë aktivitet.

Që nga 14 gushti 2021, Brenda Kalasë së Bashtovës, vizitorët do të njihen edhe me "kalanë" që ndërtuan Ismail e Gjetan Keta, duke i dhënë sportit të boksit kampionë të mëdhenj dhe kalasë së vjetër një shkëlqim të ri.

Që nga 14 gushti 2021, brenda Kalasë së Bashtovës vizitorët do të njihen edhe me "kalanë" që ndërtuan Ismail e Gjetan Keta, duke i dhënë sportit të boksit kampionë të mëdhenj dhe kalasë së vjetër një shkëlqim të ri.



printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Rruga e Arbërit nr. 179 180

Dhjetëra trofe dhe çmime të para në disa festivale kombëtare e ndërkombëtare për Ansamblin Artistik që mban emrin e artistit të madh dibran

kulturë

Ansambli Artistik **"Hazis Ndreu"-** *"Nderi i Kombit"* **fiton Çmimin e Parë** *në Festivalin e Deçanit*

Nga **Halil RAMA**



Çertifikata e Çmimit fitues iu dorëzua Presidentit të këtij Ansambli, Z.Muharrem Gjoka - "Mjeshtër i Madh", nga Presidenti i Unionit të Artistëve të Kombit Shqiptar Azgan Haklaj.

Presidentit i Ansamblit, Z,Muharrem Gjoka, i cili gjendet prej vitesh pranë këtij grupimi artistik, si një dorë e ngrohtë, inkurajuese dhe mbështetëse, një emër, i cili e nisi jetën e tij artistike si një talent i skenës dhe i valles dibrane dhe sot nderohet si një burrë Dardhe dhe Dibre, i vlerësuar me Titujt "Mjeshtër i Madh" nga Presidenti i Republikës dhe "Nderi i Qarkut Dibër", nga Këshilli i këtij qarku shprehet se: "Ansambli Artistik "Hazis Ndreu" – "Nderi i Kombit", i themeluar dhe drejtuar nga i biri i tij artist, koreografi Avni Ndreu – "Mjeshtër i Madh", është një Ansambël grupesh zinxhir (akademi) të organizuar në grupe nga mosha 5 vjeç e lart. Janë me qindra artistët që kanë kaluar në përvojën e këtij Ansambli në këto 10 vjet, duke mbushur skenat dhe sheshet e Tiranës, Kamzës, Ulqinit, Dibrës.

Mes 23 grupesh konkurruese, Ansambli Aristik "Hazis Ndreu"- "Nderi i Kombit" fitoi Çmimin e Parë në Festivalin Folklorik "Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen", që u mbajt para disa ditësh në Deçan të Kosovës.

Çertifikata e Çmimit fitues iu dorëzua Presidentit të këtij Ansambli, Z.Muharrem Gjoka-"Mjeshtër i Madh", nga Presidenti i Unionit të Artistëve të Kombit Shqiptar Azgan Haklaj.

Gjatë kësaj ceremonie mbresëlënëse ai evidentoi vlerat artistike me të cilat konkurroi ky Ansambël në Festivalin folklorik që organizohet thuajse çdo vit në nderim të rapsodëve të mirënjohur shqiptarë Dervish Shaqe e Demush Neziri.

Z.Haklaj, themelues i disa festivaleve folklorike kombëtare e ndërkombëtare, ndër të tjera ai vlerësoi interpretimin me mjeshtri të lartë artistike nga valltarët e këtij Ansambli në pjesët: Suitë koreografike "Nuset tona"; valle festive me motive të Tropojës; vallen me motove matjane "Kërcej me fyell e çifteli" me solistë Erida Stana, Marsida Zhgjuni e Fabjon Isufaj; "Dhëndurët e kurbetit"(suitë koreografike); "Tokë e shqiponjave" (tablo koreografike-Solistë: Ergys Doçi, Krisilda Halili, Rexhina Qerimaj dhe grupi i fëmijëve) etj.

Ndërkohë Presidenti i Unionit të Artistëve të Kombit Shqiptar Azgan Haklaj tha se meritë kryesore për këtë arritje kanë drejtuesi i grupit Avni Ndreu- "Mjeshtër i Madh" dhe vajza e tij Earta Ndreu si koreografe dhe menaxhere.

Me performacën e shkëlqyer, valltarët e këtij Ansambli ngritën peshë zemrat e artdashësve që ndoqën këtë festival nga dhjetëra komuna të Kosovës. Emocione të fuqishme shkaktoi tek të pranishmit interpretimi i këngës "Jam zambaku i Dardanisë" nga këngëtarja dhe valltarja e talentuar Erida Stana.

Kështu ka ndodhur edhe në festivalet tjera në treva të ndryshme shqipfolëse. Në harkun kohor të tre muajve të fundit Ansambli Artistik "Hazis Ndreu"- Nderi i Kombit është fitues i disa çmimeve të para e trofeve në disa festivale.

Vetëm para pak ditësh ky Ansambël triumfoi në edicionin e 18-të të festivalit mbarëkombëtar "Sofra Dardane", që u mbajt në Tropojë me pjesëmarrjen e 40 grupeve, ku u nderua me Çmimin e Madh të këtij Festivali. Në repertorin e këtij Ansambli numërohen me dhjetëra valle, këngë e interpretime të tjera krijuese, me të cilat ka "pushtuar" hapësirat mbarëkombëtare e ato ndërkombëtare si në: Turqi, Rumani, Bullgari, Itali, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, etj.

Të shtunën e 10 korrikut ky ansambël konkurroi dhe u vlerësua si më i miri në Festivalin e 14-të ndërkombëtar në Kërçovë, Maqedonia e Veriut. Këtu, Ky është para së gjithash vlerësim i Drejtorit të Festivalit Mazllam Osmani.

Presidentit i Ansamblit, Z,Muharrem Gjoka, i cili gjendet prej vitesh pranë këtij grupimi artistik, si një dorë e ngrohtë, inkurajuese dhe mbështetëse, një emër, i cili e nisi jetën e tij artistike si një talent i skenës dhe i valles dibrane dhe sot nderohet si një burrë Dardhe dhe Dibre, i vlerësuar me Titujt "Mjeshtër i Madh" nga Presidenti i Republikës dhe "Nderi i Qarkut Dibër", nga Këshilli i këtij qarku shprehet se: "Ansambli Artistik "Hazis Ndreu" – "Nderi i Kombit", i themeluar dhe drejtuar nga i biri i tij artist, koreografi Avni Ndreu – "Mjeshtër i Madh", është një Ansambël grupesh zinxhir (akademi) të organizuar në grupe nga mosha 5 vjeç e lart. Janë me qindra artistët që kanë kaluar në përvojën e këtij Ansambli në këto 10 vjet, duke mbushur skenat dhe sheshet e Tiranës, Kamzës, Ulqinit, Dibrës, Tropojës, Strugës, Tetovës e mbarë Shqipërisë" Në shfaqjet e organizuara herë pas here nga ky ansambël kanë performuar artistët: Arif Vladi – Mjeshtër i Madh dhe "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut, Qerim Sula – Mjeshtër i Madh dhe "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut (pas vdekjes), Liri Rasha – Mjeshtër i Madh dhe "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut, Vera Laçi – Mjeshtër i Madh, Sherif Dervishi – Mjeshtër i Madh (pas vdekjes), Dardan Pepkola, Zaim Tollja si dhe këngëtarja dhe valltarja e Erida Stana, valltarët: Adem Kurti, Fabjon Isufaj, Fatjona Ismailukaj, Eralda Jaurri, Serxho Rriçku, Ergys Doçi, Kristjan Kavalli, Marsida Zhgjuni, Orinda Prenci, Rexhina Qerimi, Livia Bushpepa, Ledion Zhgjuni, Jugers Muça, Sara Ndreu e tjere. Krijmtaria e këtij ansambli, e ardhur nga ajka e kompozitorëve si: Përparim Tomçini – Mjeshtër i Madh (pas vdekjes), Edmond Zhulali – Mjeshtër i Madh dhe "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut", Kol Susaj – Mjeshtër i Madh, dhe udhëheqja artistike nën drejtimin e "Mjeshtrit të Madh" Xhelil Ymeraj dhe mjeshtrit të koreografisë Avni Ndreu – "Mjeshtër i Madh", ia kanë rritur vlerat dhe përmasat këtij ansambli duke i dhënë statusin e një ansambli kombëtar profesionist.

Ansambli ka performuar në disa televizione prestigjioze ndërkombëtare e kombëtare si: Rai Uno, Tv Romania, TRT Turk, RTK Kosovë, RTV Koha Tetovë, Top Channel, Vizon Plus, Tv Klan, TVSH, etj. Krenare për arritjet e këtij ansambli ndjehet edhe koreografja e valltarja e talentuar Earta Ndreu, edhe për faktin që Ansambli mban emrin e gjyshit të saj, Hazis Ndreu – këngëtar, koreograf, valltar, studiues dhe shkrimtar i përmasave mbarëkombëtare...

Drejtuesi i këtij Ansambli, koreografi i talentuar Avni Ndreu - "Mjeshtër i Madh" shprehet me krenari se ky bilanc suksesesh është meritë e një grupimi artistësh të talentuar, që ka lënë kaq shumë gjurmë dhe ka fituar kaq shumë çmime brenda dhe jashtë vendit. Ndaj dhe duhen përgëzuar për atë rol të pazëvendësueshëm që kanë luajtur dhe vazhdojnë ta bëjnë, si përçues dhe frymëzues për brezat e sotëm dhe për ata që do të vijnë! Arti mbi të gjitha është pasion dhe mision, të cilin Muharrem Gjoka, Avni H.Ndreu dhe artistët e ansamblit që ata drejtojnë e kanë kryer me shumë përkushtim dhe me shumë atdhedashuri.

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

BOTIMET M&B
mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283
Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia ose mund t'i porosisni online.
Posta brenda vendit është FALAS

përshkrim

Shi lotësh te praku i derës



Nga **SELMAN MEZIU**



Isha larguar prej kohësh. I fundit u largua vëllai i vogël, duke lënë pa bluar thesin e fundit të drithit. Trojet nën ujë, më thoshte babai, janë flori. Toka e plleshme prodhonte gjithçka. Edhe fikun kishte filluar ta piqte të amël. Kumbullat e verdha vareshin mbi degë. Rrushi i thanxër kishte krijuar një trup me perimetër pesëmbëdhjetë centimetra. Shermenet mbulonin gjysmën e oborrit, veshët vareshin poshtë si kona mbështjellë me rruaza të kuqe. Ftonjtë në vjeshtë sa një kokë deleje dukeshin paksa të mbuluar nga gjethet. Lumi Murra, me atë zhurmën e ujit e freskinë e tij, të zgjonte në mëngjes mbushur me gëzim e trupin të lehtë si pupël zogu.

Ecja me përtesë udhës së hollë ndërtuar brigjeve gjysmë shekulli më parë. Shkurre të gjithallojshme më shoqëronin. Pas dy vjetësh kthehesha këtu. Ecja për tefi të vijës me ujë. Muret e kuzhinës kishin hapur gojën. Dikur më ushqenin. Sot rënkonin të dërmuara. Ato sikur donin të më hanin. Gurë, drurë, baltë e një derë e mbyllur që të lidhte me kurtin. I shikova për pak sekonda me dhimbje e mall. Braktisja kishte sjellë humbje, shëmtirë, gërmadha. Ndoshta të paripërtërira kurrë ndonjëherë.

Dera te stani nuk hapej. Ajo ishte lidhur me tela me gjemba. Më thernin duart. Me zor e hapa. Muret prej gurësh e gëlqere, qoshet e daltuara bukur i kishte mbuluar ferra, hithra barëra të gjithëfarshme. Gjithçka ishte egërsuar. Nën këmbë kërciste bari i thatë. Matanë gardhit një kasolle, një tub hekuri që mezi dukej e më tej shtrihej jonxha e lulëzuar. Ajo më dhuroi pak buzëqeshje.

Kulmi i kasolles kishte përveshur buzët. Ju ngjanin tullumbaceve të Lulit vocërr të Migjenit. Me një ndryshim, kjo ishte hapur nga ikja e shtëpiarëve. Jo më tepër se një vit. Copa tjegullash të thyera dukeshin aty-këtu përzier me copa drurësh, dërrasash, gurësh etj. Dera e haurit të gjasë së gjallë ishte mbyllur me dry. Sapo kishte filluar ndryshkja. Qoshet e gdhendura të shtëpisë shkëlqenin dhe me një vertikalitet të përsosur. Ato mbanin dy faqet e shtëpisë dykatëshe. Ndërsa unë s'po mbaja veten nga rreshpja e kujtimeve.

Kurti apo oborri në gjuhën letrare, edhe ai vajtonte. Nga etja për ujë, bari i thatë, lulet e thara. Veshët e rrushit me erë me kokrra të rrudhosura. Peizazhi i shëmtuar, që fatkeqësisht i kishte rënë hija e vdekjes. Nuk pashë zogj të fluturonin sipër. Një skelet molle me degë e trup të tharë, plotësonte skenën rrënqethëse. E mua përsëri lotët e dhimbjes filluan të pikonin në trojet e rreshkura nga dhimbja, vetmia, braktisja. Dhimbja, mërzia po depërtonin vrikshëm në palcën e shpirtit. Tortura vazhdonte.

Ashtu si në be të rreshme i afrohem stelit të qenit. Ai dukesh pak. Hithrat, barishte pothuajse i kishin mbuluar muret e ulta, mbulesën me tjegulla e derën prej dërrase të hapur. Ai ishte bosh. Disa krimba lëviznin në strofullin e tij. Dikur dëgjoja të lehurat. Nana i afrohesh e i lëshonte bukë e gjellërat e mbetura. Natën ajo i hapte hallkën prej hekuri. Ai natën bridhte trojeve të të zotërve të shtëpisë. Tani mbretëron heshtja, natë e ditë. I ngjashëm me varrin e mbuluar me pordia lisi e dhé. Mua, të paktën, kështu më ngjan. Ndoshta shkaktuar prej mallit, prej fajit, ndoshta prej...

Ulem në pragun e derës prej guri të skalitur. Mbështes kokën në kolonën vertikale. Dëshpërimi më kishte pushtuar çdo qelizë të trupit. Tëmthat më rrihnin pa pushim. Fytyra kishte marra pamjen e një fatkeqi. Më kujtoheshin mysafirë nga Tirana, Burreli, Shkodra, Lushnja e Saranda që kishin shkelur shqemën e skalitur.

Çezma mbështetur në kasollen ku mbanim lopët e mushkën. E rrethuar me barëra të shumta kërcej e gjethe të thara ose të vyshkura. Gurët e mermerit kuqëlonin me ca damar të bardhë të degëzuar çrregullisht. Ishin sjellë nga babai prej minierës së mermerit, ku ai punoi prej shumë vitesh. Tubi xinkato ishte i nxehtë. Mixha duar flori e kishte ndërtuar me plotë art. Por ai të përvëlonte nga të nxehti. Nuk mund të lagje buzët. Kush ishte kulçedra që kishte pirë ujin? Ndoshta fati i të vdekurve e të gjallëve. Ndoshta...

Paqja, urtësia, krenaria ishin skalitur mbi e anash dy dyerve. Gjithë gur skalitur mjeshtërisht. Nga e majta, emri mbiemri i gjyshit, poshtë një degë ulliri e skalitur nga duar të kujdesshme. Një shqiponjë e zezë me dy krena. Pastaj një pëllumb i bardhë në fluturim. Ne mes skalitur dukshëm: viti 1968. Dy dyer të gjelbërta prej dërrasash, me dryna të kyçura. Merimangat ishin thurur në qoshet e tyre. Në tavanin e mbulesës mbi dyert një fole dallëndysheje. Ato gjithmonë e ndërtonin brenda me baltë, bar e ngjitur me pështymën e tyre. Siç duket pa dëshirë e kishin vendosur këtu. Ato vinin e iknin dhe shtëpinë e gjenin hapur. Çdo vit ndërtonin fole të re. Tani ato nuk po vinin. Unë i prisja me mall e kureshtje. Sikur do të më çmallnin. Unë isha si ato. Fluturoja e kthehesha në shtëpinë time. Edhe unë e gjeta të mbyllur pas dy vjetësh. Unë dhe dallëndyshja - dy qenie në fluturim. Dy qenie që vuajmë, qajmë, lodhemi, ëndërrojmë, pushojmë në foletë tona që duhet me i ndërtue.

Hapa drynin. Shtyna derën me lehtësi. Në fotografinë mbi kuzhinë nana më shikonte me qortim. Në dhomën tjetër një djep bosh. Me veshjen e tij. Nuk kishte fëmijë që të përkundej. Tronditëse pamja. Heshtja. Pluhuri kudo. Zymtësi. Keqardhje. Lotët si shi rrokulliseshin faqeve të mia. Ato ishin të kripura. Ndoshta të hidhura. Ose...

Ngjitem në katin e dytë. Tavanet me njolla rrethore ngjyra të zbehta. Një qoshe tavani e çarë. Kashta kallamash, copa suvatimi mbi parketin të njollosur nga shiu. Peizazh vetmie, pa njeri. Krevati dopio mbuluar nga pluhuri, kashta, copa binarësh. Gjendje vajtuese. Nuk mund ta mbaja veten. Isha vetëm. I dhashë kurajë vetes. Dola nga aty, ku më shëmbëlleu me një varr. Më dridheshin këmbët kur po zbrisja shkallët.

Ja çfarë korrëm që ikëm.

Dhoma e rrethuar me mindere. Mbi oxhak prindërit në një fotografi, sup më sup. Me vështrimin nga dera ku hyhej në dhomë. Por ato ishin shumë seriozë, nuk më buzëqeshën. Çudi! Përse vallë kësaj radhe po sillen kështu të egërsuem? Ndoshta e kanë nga vetmia! Ndoshta nga braktisja e shtëpisë, bahçes, mullirit, lopës, deleve ...

Ulem në pragun e derës prej guri të skalitur. Mbështes kokën në kolonën vertikale. Dëshpërimi më kishte pushtuar çdo qelizë të trupit. Tëmthat më rrihnin pa pushim. Fytyra kishte marra pamjen e një fatkeqi. Më kujtoheshin mysafirë nga Tirana, Burreli, Shkodra, Lushnja e Saranda që kishin shkelur shqemën e skalitur. Ata kishin qenë ministra, drejtorë, vullnetarë të rrugës së rinisë, dekanë fakulteti, kryetarë kooperativash, kryeagronomë etj. Kishin ushqyer dashuri e fjetur në dyshekët e mbuluar me jorganë, miqtë e dashamirët e familjes tonë. Tani pluhuri ka mbuluar shenjat e daltës e çekanit të gurëskalitësit. Nuk kalon askush. Heshtje. S'ka as muhabet Dibre, as qarje fëmijësh, as blegërima qengjash. Po çfarë ka? Asgjë. Shkretizimi ka mbuluar gjithçka. Po pse? Ku jemi? Ku jetojmë? Diku po, sigurisht. Fatkeqësisht këtë kullë, askush.

01.09. 2021

Libri i ri



Haki Stërmilli
FYELLI I DIBRËS
Botimet M&B
Çmimi: 700 lekë

Së shpejti nga i njëjti autor
- **Dibra në prak të historisë** - botohet për herë të parë dhe **Rruga e Lirisë** - version i pacensuruar

Rruga e Arbërit nr. 179 180

recensë

Libri publicistik "Gjerdan fjale" është gjerdan i jetës, gjerdan i dritës së krijuesve, gjerdan i shpirtit dhe mençurisë së popullit

Një libër për traditat, fisnikërinë dhe vlerat kombëtare

Nga **MEVLUD BUCI**

Rrezatuese dhe tërheqëse, e thjeshtë dhe e madhërishme, e bukur dhe mbresëlënëse, një arkiv tradite, fisnikërie dhe vlerash njerëzore është pa mëdyshje libri publicistik i të përkushtuarit të pendës, Hamdi Hysuka. Cilido lexues, a çdo studiues që lexon e gjykon me sytë e zemrës e të mendjes, do të meditonte a vlerësonte realisht tematikën dhe shtjellimin e problemeve, të cilat pasqyrohen me mjeshtëri, humanizëm e korrektësi në librin publicistik *"Gjerdan fjale"*.

Më fort se kurrë në kohët që kalojmë, publicistika, libri i ditës, merr rëndësi të veçantë, sidomos si ky i penëndriturit Hysuka, ndërkohë kur shumë ngjarje, figura e dukuri jetësore mbeten nën hije, si i thonë, kur fshatra, zona a lagje janë pa muze, pa dëshmi të pasqyruara qartazi për brezat tanë.

Trinomi i z. Hysuka: tradita (kulturë), fisnikëri dhe vlera përshkon gjithë librin *"Gjerdan fjale"* prej 376 faqesh, botuar në maj 2021. Autori ka punuar me pasionin e gjeologut që gjen minerale të çmuara, që gërmon në tokën e shtrenjtë me pasion e frytshmëri. Ky autor i mirënjohur, ish-Normalist shembullor, krahas mësuesisë e drejtimit arsimor, krahas shembëllimit si veprimtar organizator e krijues, botues i disa librave poetikë, ka gdhendur në udhët e jetës tradita, fisnikëri e vlera, të cilat vërtetë janë dëshmi e pasionit, e zotësisë, dëshmi e atdhetarisë, e shpirtit human, janë gjerdani i shndritshëm në kulturën e popullit të Matit, të kombit e më gjerë.

Në caqet e një shkrimi, si ky i yni, kurrsesi nuk do të analizohej krijimtaria e gjerë e të palodhurit Hysuka. Theksojmë se për këtë nuk do të mjaftonin një apo disa libra. Libri më i ri *"Gjerdan fjale"* është vërtetë arkiv, një muze vlerash, traditash e fisnikërie. Pse? Në çdo shkrim lexuesi a studiuesi i zbulon nëpër gjetjeve, të të shkruarit thjeshtë e me argumente, të të shkruarit me shpirt e qartësi, me barrën e rëndë prej misionari e vizionari të kohës.

Publicisti Hamdi Hysuka shpërfaq gjurmët dhe vlerat e kulturës, të figurave, të jetës, të diturisë e mbi të gjitha të shpirtit të fisnikëruar njerëzor. *"Autori i librit publicistik "Gjerdan fjale",* -shkruan studiuesi e krijuesi i talentuar Gjokë Dabaj, *-ka bërë një punë të madhe, të përditshme, të lodhshme, por të domosdoshme, veçanërisht për kohën tonë, kur punë të tilla pakkush po i zë me dorë. Cilësia e parë e tij, si gazetar, por edhe si njeri, është kjo: Duke qenë matjan i Matit, është njëkohësisht edhe shqiptar i i krejt Shqipërisë, nga Prekazi e Presheva, në Margëlliç e Paramithí..."*

Autori Hysuka me përkujdesje, saktësi e pasqyrim ka bërë kritikë reale (analizë e përshkrime) për shkrimtarë, artistë, këngëtarë, valltarë, ngjarje, mbresa e mbi të gjitha ka pasqyruar me pasionin e bletës gjurmët e kulturës, momente të jetës, tradita, të cilat përbëjnë arin e këtij libri publicistik. Është krenari legjitime jo vetëm për autorin Hysuka, por edhe për të gjithë ne e ata që do të vijnë, ajo që citon të madhin, të paharruarin Dritëro Agolli, i cili ka thënë: *"Kombi shqiptar fillon nga Mati"*.

Një poezi është brilante, testament dashurie, një trestrofsh hymn, krijuar me zjarr zemre, me shkulme malli për vendlindjen, Shëlliun e Matit:

Me freskinë djaloshare / drejt Shëlliut i çoj sytë,

pa dyshim them hapur fare: / -Si Shëlliu s'ka të dytë!

Në shkrimin *"Skënderbeu, krenaria e kombit"* autori Hysuka gdhend me mjeshtërinë e tij prej gazetari e studiuesi vlerat e kësaj figure legjendare, na pasqyron me gjetje krejt të re virtytet, qëndresën, vlerat dhe jehonën e Skënderbeut, deri te poezia e Kadaresë me



- **Libri "Gjerdan fjale" na dhuron ide, mesazhe e portrete për figura që mbartin vlera, na pasqyron integrim kulturor dhe artistik, hulumtime letrare, vlera trashëgimie të artit folklorik, arkiv të pushtetit të katërt.**
- **Pasqyrimet mjeshtërore për vlera trashëgime të artit folklorik dhe arkivi i pushtetit të katërt përmbushin në plotësi tematikën dhe vlerat e këtij libri publicistik. E veçanta e librit është stili letrar-publicistik, përshkrimet, gjetjet artistike, të shkruarit thjeshtë, bukur e me kompetencë, pasqyrimi i traditave kulturore, letrare e mbi të gjitha gjurmët e atdhetarisë e të fisnikërisë.**

titull *"Portreti i Skënderbeut"*. Te *"Gjerdan fjale"* shpërfaqet historia, tradita, jeta, fisnikëria, ku z. Hysuka përshkruan dhe argumenton se poezia nis me Budin e Gurit të Bardhë, gdhend fakte për martirin e fjalës (Pjetër Budin, autori MB), ku midis të tjerash shkruan: *"Në kuadrin e 23 prillit, Ditës Ndërkombëtare të Librit, më 23 prill 2016, në Gur të Bardhë e Klos u përkujtua 450-vjetori i lindjes së shkrimtarit të parë shqiptar, Pjetër Budi. Veprimtaritë nisën me vizitën në Gur të Bardhë, vendlindja e Budit, ku ka trashëgimtarë të Budëve të vjetër. Pas ndërrimit të fesë nga katolikë në myslimanë ato quhen Bode. Studiuesi Behar Gjoka, së bashku me grupin organizator, trokitën në shtëpinë muze të lindjes, ku u pritën nga zonja e shtëpisë, Sofie Bode. Një nga pasardhësit, Osman Bode, rrëfen se "kjo derë që nga Pjetër Budi i madh, sot ka gjashtëmbëdhjetë breza trashëgimtarësh"*.

Ra në sy mënyra tradicionale e pritjes, ku veç të tjerash shquhej veshja specifike e gruas gurabardhëse, e trashëguar qytetëse me elementë dallues, që e bëjnë të zërë vend të veçantë në fondin e artë të veshjeve tona kombëtare. Detajet përshkruese si dhe fotot dëshmojnë fakte, ngjarje e vlera të traditës. Çdo shkrim që lexon të ngjall krenari, të bën të meditosh e mbi të gjitha të mëson gjëra të reja, të le mbresa të thella. Që në titull, *"Gjerdan fjale"*, metaforë mjaft e goditur e te çdo nënkapitull (pesë të tillë, autori MB) te çdo shkrim me vlera publicistike e studimore, lexuesi gjen tituj të goditur, mjeshtërorë e sintetizues, pas të cilëve shpërfaqen ngjarje, episode, fakte, emra e përshkrime frymëzuese, të cilat ngjajnë me prushet në acar, që ngrohin zemrat e lexuesit, që gurgullojnë fisnikëri njerëzore, thjeshtësi e realizëm në jetën tonë, në gjurmët e brezave, në vlerat e çmuara të provave për jetën, për kulturën, për atdhetarinë.

Janë të një bukurie e realizmi të veçantë shkrimet *"Më shumë se grada e tituj pëlqente mbiemrin"*, kushtuar guvernatorit dhe komandantit të përgjithshëm të Tripolit, Rexhep pashë Matit, *"Ndihmesë në fushën e albanologjisë"*,*"Mes kolegëve danezë"*,*"Krenaria e detarisë shqiptare"*, kushtuar komandantit të FLD Abdi Mati, nderi i ushtrisë dhe krenaria e Matit, *"Ky është Gjokë Dabaj"*, *"Kjo Shqipni la lindun burra"*, kushtuar patriotit të madh, Shahin Toçi, *"S'iu tremb vdekjes për të drejtën"*, kushtuar emigrantit qëndrestar, martir i përkushtimit për jetën, punën, të drejtën, birin e Matit e të shqiptarisë, Flamur Pisli, *"Vlera natyrore e historike e Varoshit"* etj, pasqyrojnë me argument ngjarje, fakte, si dhe nëpërmjet përshkrimit realist e frymëzues portretizon me korrektësi figura të ndritura, të cilat janë lavdia e Matit, nderi dhe fisnikëria e kombit dhe e brezave tanë.

Nëpërmjet krijimit e frymëzimit, fragmenteve e gjetjeve artistike, fakteve e saktësimeve, publicistika e gazetarit Hamdi Hysuka merr vlera për lexuesit, për kohën, për njohjen sa më mirë të traditave, të kulturës, të vlerave. Autori i këtij libri, i shkruar me përgjegjësi e humanizëm, rrok tema të rëndësishme, shpërfaq vlera, dukuri e ngjarje, ku autori u jep atë çka vlejnë, çka rrezatojnë e meritojnë. Tërheqin vëmendjen shkrimet *"Historiku i himnit kombëtar"*, *"Aksioni i parë luftarak i çetës së Matit"*, *"Dita e të paharruarve"*, ku saktëson 172 dëshmorët e paharruar të Matit historik. Autori, krahas përshkrimit, u kushton dhe vargje, të cilat mbartin idenë e përjetësisë e të heroizmit të dëshmorëve, krenarinë legjitime të atyre që vijnë në tokën tonë të regjur me luftra, të njomur me gjakun e dëshmorëve:

Zemrat na rrahin pranë lapidarëve,
flladi magjepës nëpër lirishta harliset,
pranverat do ulen dhe në prag
të dëshmorëve
shkundin mozaikë lulesh me mall për viset...

Këtë mozaik përjetësisht do ta mbledhim
dhe në kurora do ta lidhim çdo 5 Maj,
tokës së shtrenjtë me nderim do ia falim
si dekoratë në gjoks të lapidarëve të saj...

Libri *"Gjerdan fjale"* na dhuron ide, mesazhe e portrete për figura që mbartin vlera, na pasqyron integrim kulturor dhe artistik, hulumtime letrare, vlera trashëgimie të artit folklorik, arkiv të pushtetit të katërt.

Gjetjet në rrokjen e temave, pasqyrimet e përshkruara me thjeshtësi, qartësi e mjeshtëri artistike na japin vërtetë një libër arkiv, libër publicistik muze, me plot bukë, me përmbajtje të argumentuar, ku autori Hysuka shpërfaq bukur e krenarisht botën shqiptare, dritën njerëzore të pendës, rrezatimet e botimeve letrare, forcën dhe madhështinë e kulturës, të artistëve, të folklorit të popullit.

Pas rileximit të librit publicistik *"Gjerdan fjale"* (edhe letrar e studimor, autori MB) të vjen më mendje thënia filozofike e rilindasit të madh, Sami Frashëri: *"Mos shiko çka ke fituar, shiko çka ke bërë, sepse pasurinë që ke fituar do ta humbasësh kur do të vdesësh, se mirësitë që ke bërë do të qëndrojnë në botë dhe shumë kohë, dhe do të bëjnë të përmendesh për të mirë"*.

Autori Hamdi Hysuka ka punuar me pasion e korrektësi, ka gdhendur materiale, ka përshkruar e studiuar, ka bërë një punë pasionante me shpirt misionari për traditat, fisnikërinë, kulturën, vlerat; ka përthithur nektarin e jetës, ka dritësuar figura e ngjarje, vlera të botimeve, ka sintetizuar me mjeshtëri, ide, analiza, probleme që lartësojnë kulturën, artistët, botuesit, udhët e jetës, provat e atdhetarisë, të figurave të ndritura nga Mati, kombi ynë e më gjerë. Është vërtetë pikant, tërheqës e i mirërealizuar shkrimi *"Reformator i fjalës poetike"*. Autori udhëton që te Budi, Mjeda, Asdreni, Shiroka, te Fishta, Konica, Noli, Migjeni, arbëreshët Jeronim de Rada, Gavril Dara (i riu), Anton Santori, Zef Serembe, më tej Esad Mekuli, poeti i parë dhe më i njohur i Kosovës, Ali Podrimja, Azem Shkreli, Rifat Kuka, Eqrem Basha, Sabri Hamiti e deri në kohën e sotme. Autori Hysuka argumenton me kompetencë e realizën *"shkallën e lartë e ndjeshmërinë poetike"*, *"vokacionin poetik krejt i veçantë dhe origjinal"*, "çdo varg *një figurë artistike* (përkthime të Lasgushit të madh, autori MB), *"mos e pifshim këtë gotë"*. *"Lasgush Poradeci,* - shkruan autori Hysuka, - *qe optimist për një çlirim të shpejtë të Kosovës dhe për bashkimin tonë në një shtet të vetëm"*. Lasgushi është poeti i dhimbjeve, gjithnjë për t'u bërë fli e tyre, *"e nëse dhimbjet venë e vijnë, / jam gati të vuaj më, / kush më njohu dhembshurinë, / s'pati njohur kurgjë..."*

Shkrimet *"Nderim për poetin Esad Mekuli"*, *"Libri, udhërrëfyes në jetë"*, *"Autoriteti i kritikës letrare"*, *"Art poetik me vlerë të përhershme"* (ku autori pasqyron antologjinë e poezisë matjane), librin testament të krijuesve mbarëkombëtarë e më gjerë, te konkurimet në festivalin e poezisë *"Muza Poetike Budiane"*, shkrimet *"Festë e fjalës budiane"*, *"Poetë që u njohën pa u parë"* mund të quhen pa mëdyshje tribunë e bashkëvanëve të krijimtarisë, bij të pendës që hijeshojnë *"Gjerdanin e fjalës"*. Hulumtimet letrare kushtuar Aleksandër Moisiut, mbresat e krijimet për Driteroin, *"Ushtarak edhe poet"* për të paharruarin e të talentuarin Hysni Milloshi, *"Ambasador i përjetshëm i Rusisë në Shqipëri"* (për librin e Vasil Premçit për Eseninin), *"Koha i dha emër"* kushtuar poetit Basir Bushkashi (Eseninit të Matit, autori MB), shkrimet për poetin çam Namik Selmani dhe librin e tij *"Gurra e Budit"*, *"Bukuria e mesazhit të një amaneti"* kushtuar shkrimtarit Skënder Tuna, shkrimet për Bashkim Frangun, Jolanda Lilën, dr. Sali Kurtin *"Mjeshtër i Madh"*, për Isak Gutën, Trandafile Mollën, Bajram Canametin, Kasam Shaqirvelën e plot të tjerë janë thesare në duart e çdo lexuesi dashamirë i letërsisë, dritare për cilindo studiues e mësues të letërsisë, një kurorë që bleron dituri e fisnikëri për kohën e motet që vijnë, Autori i përkushtuar Hysuka analizon dhe argumenton mjaft bukur libra të autorëve Drita Llukovi (Aliaj), Xhavit Gasa, Gëzim Buna, Jani Thanas Caci, Hasan Pasha, Shefqet Merra, Faik Xhani, Riza Doda, Skënder Xhika, Shyqyri Koçi, Valbona Xhepi, mendimet dhe analizat, idetë e mesazhet që jepen qartë e kuptueshëm nga autori, i cili shpërfaq qartazi atë që kërkon analiza e një vepre letrare. Pasqyrimet mjeshtërore për vlera trashëgime të artit folklorik dhe arkivi i pushtetit të katërt përmbushin në plotësi tematikën dhe vlerat e këtij libri publicistik. E veçanta e librit është stili letrar-publicistik, përshkrimet, gjetjet artistike, të shkruarit thjeshtë, bukur e me kompetencë, pasqyrimi i traditave kulturore, letrare e mbi të gjitha gjurmët e atdhetarisë e të fisnikërisë.

Libri publicistik *"Gjerdan fjale"* është gjerdan i jetës, gjerdan i dritës së krijuesve, gjerdan i shpirtit dhe mençurisë së popullit, gjerdan që gdhend fjalën dhe vlerat, libër që përcjell mesazhe fisnikërie, kulture e vlerash, libër arkiv për brezat.

cyan magenta yelloë black

Tubë këngësh e fjalësh të urta popullore,
të mbledhura në krahinën e Ujemujës të qarkut të Dibrës

Këngë dhe fjalë të urta popullore

*Nga dr.***Fejzulla GJABRI**

Studiuesi Hajri Shehu është kthyer në vendlindje për së dyti herë. Herën e parë, me fjalën e Ujemujës*. Tani, me krijimtarinë folklorike të Ujemujës.

Libri ka gjashtë pjesë: këngë djepi; këngë motmoti; këngë dashurie; këngë dasme; fjalë të urta; gjëegjëza. Autori nuk zgjatet në komentimin e tyre, pasi ato flasin vetë. Por aty ku ia ka dashur puna, jep komente e shpjegime letrare, gjuhësore, stilistike etj.

Një si hyrje, me titull "Në vend të një fjale të dytë" i paraprin tërë lëndës folklorike. Te "Fjalë të urta" ka një parathënie të spikatur studimore, e cila na thotë çfarë janë e si janë fjalët e mençura popullore.

Trualli ku është mbledhur lënda, është Ujemuja, një zonë etnografike gjuhësore e Dibrës, në kufi me fshatrat e Lumës (në anën perëndimore të malit të Korabit). Në të dyja zonat visari popullor është i pashtershëm.

Siç dihet, populli ynë e ka përdorur folklorin për riprodhimin artistik të jetës dhe të ndërgjegjes kombëtare. Dhe si mjet vetedukimi artistik. Si i tillë, folklori është pasuruar dhe zhvilluar vazhdimisht bashkë me shijet dhe kërkesat e kohës. Por për shkak të veçantive të tyre, disa gjini e forma folklorike kanë shkuar drejt rënies (p.sh., legjendat e përrallat); ndërsa po bëjnë një jetë këngët epike-historike e këngët lirike. Por edhe anekdotat e fjalët e urta. Nxjerrja në dritë, veçanërisht e atyre gjinive, që pak aktivizohen, është mirë të bëhet, ende pa u zhdukur plotësisht, siç ka ndodhur në vendet e zhvilluara. Kjo përmbledhje ka, ndër të tjera, edhe këtë synim.

Këngët e djepit, të përkundjes ose të gjumit formojnë grup më vete e këndohen, zakonisht, duke përkundur djepin, që fëmijën ta zërë gjumi. Por, jo vetëm kaq. Nëna e do fëmijën të shëndetshëm, të bukur, të mirë, me shkollë e me dije: *Nina, nona caucën-o, / Fij moj cauc e nonës-o, / Je orxhon i nonës-o. / Hajde xhum i amël-o, / Përsheshin me tamël-o. / Nona tai t'ka si moll, / Tashtai rraitesh, t'çoj në shkoll.* Dhe nëna uron e lutet për më të mirën.

Këngët e dashurisë na vijnë me ngjyra, krahasime e epitete të bukura. Janë rreth 60 këngë. Për dashatarët. Dhe për dashurinë dashatarët nuk kursejnë asgjë. Sepse është ajo ndjenja e fuqishme njerëzore. Shih për këtë te kënga "T'i bohem Nailes": Zog do që të bëhet djali, vetëm sa ta shohë vajzën, për të cilën i rreh zemra fort.

Këngët e dasmës. Dasma tradicionale është institucionale: Ajo ka normat e saj. Këto norma vijnë nga kohët e hershme. Por, sigurisht, kanë pësuar ndryshime të herëpashershme sipas pëlqimit të shumicës. Nga dasma vjen ripërtëritja e individit dhe nëpërmes tij – ripërtëritja e gjithë shoqërisë njerëzore. Me anë të institucionit të dasmës njeriu ka rregulluar biofilinë, dashurinë për jetën. Dhe respekti për biofilinë vjen në momentin më të rëndësishëm të një individi me këngë, valle, rite, lojëra etj. Dhe, duket se të gjitha këto së bashku e kanë mbajtur institucionin e dasmës tradicionale.

Këngët e dasmës nisin me shkuesin e shkuesinë e me zanien e nuses. *E zanmja nuse* është një ditë e rëndësishme familjare. Këngët këndohen te shtëpia e djalit (më pak, ose aspak, te shtëpia e vajzës). Janë këngët që japin lajmin për këtë gëzim. Në lagje dhe në katund.

Disa muaj para dasmës janë *këngët e çerepëve*. Gjithnjë, në shtëpinë e dhëndrit.

Nga këngët e dasmës, që jepen edhe në këtë përmbledhje, mund të veçojnë *ato që këndohen kur berberi shkurton flokët e dhëndrit dhe ato të nusërimit*. Te këngët e berberit, që përbëjnë një cikël më vete (të këngëve të dasmës), berberi vetë e zgjat qethjen e rrojën me qëllim: Ka kohë derisa të kthehen krushqit me nusen e prandaj "duhet me këndue". Në këtë pjesë të ditës së dasmës, ky çast është, zakonisht i vetmi argëtim në shtëpinë e dhëndrit, kur në shtëpinë e nuses derdhen lot se po ikën një njeri nga ajo derë. Është interesant: Në të dyja shtëpitë ka lot. Dhëndri përlotet nga "kangët e cucave", por edhe më pas, kur vishet e u jep dorën nënës, babës e gjithë të afërmve. Te pala tjetër, në shtëpinë e nuses, lotët derdhen kur vajza hipën në kalë (tani, në makinë). Thonë se lotët janë lehtësim shpirtëror. Ja një këngë e berberit e për berberin: *O berber i pazanat, / Majte dhonrrin tre sahat.*

Këngët e nusërimit janë ndër më të bukurat. Kur zbret nusja nga kali (tani, më së shumti, nga makina), ka një pauzë të shkurtër. Nuk këndohen këngë derisa të hyjnë cucat e gratë brenda. Moment çlodhjeje, krejt njerëzor. Te pragu i derës (që në këto anë i thonë *shemë*) ka kujdes të veçantë. Nusja nuk e shkel, por e kapërcen sepse "shema



KËNGË DHE FJALË TË URTA POPULLORE
(Nga Ujemuja, qarku i Dibrës)
I mblodhi dhe i përgatiti për botim: HAJRI SHEHU
ISBN 978-9928-353-18-4

Krijimtaria gojore është, siç dihet, formë e ndërgjegjes shoqërore. Dhe, njëherazi, është edhe një lloj i veçantë arti. Kjo do të thotë se përmbajtja e çdo vepre folklorike (poezi, përrallë, anekdotë etj.) përcaktohet nga kushtet materiale të zhvillimit. Por, njëherësh ajo është shprehje estetike e marrëdhënieve reale historiko-shoqërore, e veprimtarisë së përditshme të njeriut, e jetës, e jetesës, e punës, e zakoneve dhe e traditave.

Shpresojmë që në këtë tubë këngësh e fjalësh të urta popullore, të mbledhura në krahinën e Ujemujës të qarkut të Dibrës, lexuesi ta shohë këtë zhvillim dhe këtë shprehje estetike. Ato janë pjesë e kulturës sonë kombëtare. Shpresojmë, gjithashtu, që ato t'i rikthehen popullit si një mjet i vyer i kësaj kulture.

e derës asht e shejtë". Studiuesit thonë se është rit që vjen nga lashtësia. Në anët tona ka një porosi nga më të mëdhenjtë për të rinjtë e për të rejat: *Mos rri në shemë të derës!* Riti na thotë: Kujdes! Shema e derës nuk asht vetëm "vend i shejtë, por edhe i rrezikshëm". Fundja, shema e derës lidh "jashten me mbrenen". Kama e djathtë është e pëlqyeshme të kapërcejë para. Jo vetëm për nusen që drejtohet nga njerëzit e afërm të shtëpisë, por për gjithkënd që hyn e del. Kur hyn nusja, shemës së derës i lëshohet sheqer.

Te këngët e nusërimit lavdërohet bukuria e nuses. Nuk ka nuse më të bukur se kjo që na ka hyrë në këtë shtëpi. Ndonjë shembull? Ja dy shembuj:

Nër dullak oj çiçe, ç'ar m'i kije?*

- Nër dullak oj çiçe, ç'ar m'i kije? /dullak = duvak
  / qyqe çfarë m'i ke
- M'i kam dada fjokët korb i zije.
- Po nër fjok, oj çiçe, ç'ar m'i kije?
- M'i kam dada ballin bukurije.
- Po nër ball, oj çiçe, ç'ar m'i kije?
- M'i kam dada vetllat gajtanlije.
- Po nër vetlla, oj çiçe, ç'ar m'i kije?
- M'i kam dada sait si rraush i zije. / sytë
- Po nër sai, oj çiçe, ç'ar m'i kije!
- M'i kam dada hunën si çirije. / qiri
- Po nër hun, oj çiçe, ç'ar m'i kije?
- M'i kam dada gjojën si kutije.

Folkloristët kanë një lëndë të vyer në këtë libër, për të njohur këngën popullore dhe mendësinë popullore të Ujemujës e pse jo, edhe të Dibrës. Edhe etnografi ka se ç'sheh. Këngët na vijnë me të folmen e krahinës. Dhe për këtë arsye janë një burim autentik për një studim dialektologjik të kësaj të folmeje.

- Po nër gjoj, oj çiçe, ç'ar m'i kije?
- M'i kam dada njekrën parelije. / *parelije* = me qukë

N'at kraie si molla në maje

N'at kraie, si molla në maje. / krye
N'at shtat, si molla n'bajrak.
N'at ftair, kulaçi inairë. / yndyrë; si kulaç
N'ato duer, lum lala si t'muer! yndyre
N'ato kam, kone rrait në Gram. / *Grama* rrafshnaltë
nën Korab

Këngët e motmotit

Dita e Verës dhe *Shëngjergji* kanë këngët e veta. Këngët i këndojnë verës, ikjes së dimrit, por edhe natyrës etj. Ja një këngë për Ditëveren: *Ori zogi ferrës, / Na erth Dita Verës. / Dita Verës erth, / Dukati me rreth.*

Nuk mungojnë edhe këngët humoristike (p.sh., një grup vajzash të një fshati thurin vargje cytëse për vajzat e djemtë e fshatit tjetër). Djemtë luajnë lojëra popullore, si, brezahipas, rrasash etj. Për të gjuajtur me gurë të vegjël përdoret *bahja* (= hobeja). Aty ku vihet guri, është një cohë e endur me pe leshi, ngjyra-ngjyra. Anash, bahja ka dy gjalma të thurur gërshet, po me fije leshi ngjyra-ngjyra, të gjatë deri 70 cm, që përfundojnë – njëri me një vëng, ku hyjnë gishtat e mesit të dorës, kurse tjetri – me një tufë penjsh pambuku a mëndafshi, të cilët, kur lëshon gurin, japin një krismë karakteristike.

Fjalët e urta

Çdo popull ka, siç thotë edhe autori, fjalët e tij të urta, të ndërtuara sipas psikologjisë dhe përvojës së tij jetësore, historike e filozofike. Në libër duhet të jenë mbi 1000 fjalë të urta. Ato janë renditur në trajtë fjalorthi e lexuesi e ka shumë të lehtë t'i shohë e t'i ndjekë. Parathënia e autorit është, siç e cekëm edhe pak më sipër, një studim i mirëfilltë folkloriko-gjuhësor.

Dhe pastaj - **gjëzat**, të cilat, me përshkrimet e tërthorta na bëjnë të mendohemi shumë. Dhe, kur ngecim, i gjejmë me fjalën që na jepet në kllapa.

Mendojmë që ky libër folklorik i prof. Hajri Shehut vjen në kohë. Themi *në kohë* sepse brezat edhe ikin. Veç kësaj, lëvizja e popullsisë po bën punën e vet, duke lënë shumë fshatra me pak banorë. Sido që njerëzit marrin me vete shumë nga kjo pasuri e tyre, mund të ndodhë që diçka të humbasë rrugës. Dhe ne nuk duam të na humbasë asnjë këngë e popullit e asnjë fjalë e mençur e popullit. Mbase, mu për këtë, autori thotë në fjalën e tij, që i paraprin lëndës: *I nderuar lexues! Në këtë libër - jo dhe aq vëllimor janë përfshirë më së shumti këngë lirike, fjalë të urta dhe gjëegjëza. E kemi librin vetëm me këtë tematikë (p.sh., pa këngë historike, pa këngë të rinjohjes etj.), duke menduar se në ndonjë rast, mbase është edhe si një përdorak e le të themi, ndonjë brezatare e sotme a e nesërme mërgimtare gjen ndonjë këngë për ta kënduar a një fjalë të urtë për ta thënë. Vetëm këngë këndofshim e vetëm fjalë të urta thënçim!*

Libri mund të lexohet me ëndje, jo vetëm për këngët e bukura popullore e fjalët e mençura popullore, por edhe për shpjegimet letrare-gjuhësore që jepen si poshtëshënime.

Folkloristët kanë një lëndë të vyer në këtë libër, për të njohur këngën popullore dhe mendësinë popullore të Ujemujës e pse jo, edhe të Dibrës. Edhe etnografi ka se ç'sheh. Këngët na vijnë me të folmen e krahinës. Dhe për këtë arsye janë një burim autentik për një studim dialektologjik të kësaj të folmeje. Edhe për leksikologët – për studimin e fjalës dhe të shprehjes popullore. Me fjalët e urta, libri është edhe për mësuesit, për t'u dhënë detyra nxënësve, për të rritur fjalorin e tyre me fjalë, shprehje të figurshme e formime të panjohura fjalësh. Kurse gjëzat janë për nxënësit, për të zhvilluar më tej të menduarit e tyre.

* Kënga tradicionale është me dullak (duvak). Por tani, zor se sheh dullak diku.

Rruga e Arbërit nr. 179 180

recensë

"Histori qëndrese" në romanin e katërt të Dogjan Dervishit

Nga **Halil RAMA**

Me katër romane të botuara dhe të mirëpritura nga lexuesi , në harkun kohor të tetë viteve: "Zhgënjimi" (2013), "Shpresë e thyer" (2017), "Përandoria e medjave" (2019) dhe "Një histori qëndrese " (2021); Dogjan Dervishi rënditet padyshim me elitën krijuese dibrane, dhe pse jo edhe me atë kombëtare.Nëse me romanin e parafundit "Përandoria e medjave" u njoha fillimisht gjatë promovimit të tij para dy vitesh në një nga sallat e Hotel Tirana international, me pjesmarrjen e dhjetra personaliteteve krijuese dhe me pas e lexova me një frymë, romanin e fundit të këtij autori "Një histori qëndrese" , pata fatin ta kemë në dorë që në dorëshkrim.

Kjo vepër letrare e këtij autori është e gjitha përformancë bashkëkohore që të imponohet që në faqet e para dhe në vijim, deri në faqen e fundit, me subjektin dhe përmbajtjen e veçantë si dhe me formën e bukur artistike të rrëfimit, të ndërtimit , të gërshetimit të linjave e të kapërcimeve kohore.

Trilli artistik i këtij autori nis që në hyrje, ku personazhi kryesor Artur Semini që ka humbur gruan nga një sëmundje e rëndë dhe ku në kulmin e dëshpërimit, vajza e tij Shpresa me banim në Danimarkë e fton për ta njohur me një zonjë të rrallë, me të cilën mund të kalonte vitet e pleqërisë , ndonse kjo qe një zonjë fisnike, Arturi refuzon kategorikisht kur mësoi për orientimin seksual të djalit të saj. Reflektim ky i përnjëçastshëm i mentalitetit shqipëtar për ripërtritjen e jetës nëpërmjet martesave burrë-grua, kundër homoseksualizmit.

Më pas vijon, shtrirja e subjektit në dy kohësipas një ndërtimi kompozicional mjaftë original : para viteve '90 kur personazhi kryesor i tij Artur Semini arrin të shkollohet dhe të krijojë një familje solide me mësuesen Filomena, si dhe në tridhjet vitet e



fundit, kur jeta e tyre merr rrokullimën e fatit. Kësisoj ky roman sjellë befasi për lexuesin

Autori Dervishi, me një bagazh të pasur jetsor ka ditur të përveçojë ngjarje interesante të përjetuara intensivisht nga personazhet dhe të skalis asosacionet më pikante.Parë nga ndërtimi kompozicional, përshkrimi i ngjarjeve në dy kohë e bën më tërheqës këtë roman. Kjo për faktin se në pjesën e parë lexuesi, sidomos brezi i ri do të mësojë për vitalitetin e rinisë së asaj kohe, për nivelin bashkohor të sistemit arsimor që nxorri kuadro të denjë të konkuronin kudo denjësisht, si dhe për mundësinë që edhe rinia shkollore të përgatitej për të qenë e aftë ushtarakiaht në rast të një agresioni të mundshëm ndaj vendit tonë. Pikrisht në raste të tilla nis dhe njohja e ngjizja e dashurisë së sinqertë mes Artur Seminit nga Dibra dhe Filomena Priftit nga Kuqi i Vlorës, kur nxënësit e shkollës së mesme me drejtor Vasil Panon kryenin stërvitjen ushtarake në repartin kundërajror të Arturit.

Mjaftë bukur, me një gjuhë të pasur e mjete shprehëse interesante përshkruan autori bukurinë hyjnore dhe atë shpirtërore të Filomenës, çka të bën të dallosh tek ai stilin bashkohor të shkruarit të prozës sonë. Për dy nga personazhet gjallues të romanit, gjejmë edhe momente dramatike , sidomos pas incidentit në qitjen me kundërajror në Divjakë. Arturi po përjetonte peshën e fajit pas asaj që ndodhi me operatorin e aparatit të drejtimit të zjarrit Kastriot Muça, i cili kishte harruar të kthente çelsin në pozicionin " Qitje me pasqyrë", dhe në qoftëse qitja do të kishte qenë e preçizionit të lartë, do të ishte shkatërruar avioni dhe do të kishte humbur jetën piloti. Edhe në këto çaste, ndërsa Arturi përgatitej për llogaridhënien dhe eutokritikën në organizatën e Partisë, Filomena do t'i qëndronte pranë në çdo moment me këshilla shpresëdhënëse për t' i larguar stresin bashkëshortit.

E gjithë kjo përbën një lëndë interesante të këtij romani , për të vazhduar më tej në retrospektiv, ku lëvrijnë mardhëniet dashurore të dy bashkëshortëve, që ksisoj arrijnë të krijojnë një familje solide. Mjaftojnë, qoftë dhe trillet e përdorura në përshkrimin e këtyre mardhënieve, për të kuptuar se Dogjan Dervishi e ka shkruar këtë roman më së pari me vizionin e një artisti.

Ndërkohë, krahas portretizimit artistik të dy personazheve burrë-grua, si personazhet kryesore që përshkojnëromanin, nga fillimi deri afër mbarimit të tij, në romanin e autorit Dervishi, ngjarjet i gjejmë tëgërshetuar me periudha historike kyçe të asaj kohe, si dalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës apo shkëputja e mardhënieve me Bashkimin Sovjetik. Komenti i ngjarjeve të tilla dëshmojnë për një autor njohës të mirë të historisë dhe përçues eutentik të tyre tek lexuesi.

Në pjesën e dytë të romanit ngjarjet zhvendosen në tridhjet vitet e fundit të tranzicionit të tejzgjatur. Ndërsa vazhdon jetën ushtarake , madje në dikasterin kryesor, Arturi i brumosur me një atdhedashuri të zjarrtë, të trashëguar nga familja dhe të kalitur me punë e sakrifica, refuzon të drejtojë operacionin kundër popullsise civile në jug të vendit në '97-tën e rebelimit të armatosur, duke dhënë dorëheqjen nga funksioni.

Ngjarjet rrjedhin vrullshëm, pas sëmundjes së bashkëshortes, vdekja e parakohëshme e sëcilës, i shkakton dhimbje të madhe. Por jeta gjithsesi vazhdon. Padyshim ngjarjet më interesante të kësaj pjese janë ato në Azilin e pleqëve, ku pas vetmisë së madhe, e gjen veten në Azil edhe ish ushtaraku Artur Semini. Pikërisht këtu vjen linja e dytë e dashurisë me ish shoqen e gjimnazit "Sami frasheri", Donika Stërmasi, me të cilën vjen dhe martesa e dytë në mjediset e azilit, si dhe shoqëria me mësuesin Bastri Yzeiri. Edhe në këtë pjesë romani është tërheqës, me ngjarje e personazhe të përshkruara mjeshtërisht.

Autori Dogjan Dervishi ka skalitur veçanrisht portretin e Donikës, qoftë duke sjellë në memorie ngjarje nga jeta shkollore e para shumë viteve, qoftë dhe përjetimet gjatë infektimit me flamën covid-19 që e përballojnë me stoicizëm pranë njeri-tjetrit.

Duke e marrë në tërsinë e tij, mund të konkludojmë se ky roman është radiografi e shoqërisësocialiste, por edhe prognozë e zhvillimeve të këtij çerekshekulli. Pa hyrë me tej në detaje të subjektit, me qëllim që të mos zbehim kureshtjen e lexuesit, do të thoja se romani "Nje histori qëndrese" është një sprovë e forcës emotive të shprehjes, e një bukurie tërheqëse shkrimi, si dhe e një stili të krehur mirë e të veçantë të këtij autori. I uroj atij suksese në krijimtarinë e tij të mëtejshme, sa më produktiv dhe cilësor.

Bota fëmijënore në poezinë e Selim Çerpes

Nga **Ilmi DERVISHI**

Shpeshherë, kur shkruan për një libër të një autori me të cilin ke miqësi, është e vështirë të bësh një vlerësim për krijimtarinë e tij, pa u ndikuar prej miqësisë. Por me librin "Cicërimat në agime"- poezi për fëmijë të poetit Selim Çerpja, e kam të lehtë. Sepse, së pari e kam njohur krijimtarinë e tij në pikturë, në poezi e interpretim, por e kam njohur autorin edhe si djali i Sali Çerpes, një valltar virtuoz i ansamblit të Dardhës në Dibër, si nip i Qazim Selimit, - themeluesi, organizatori dhe interpretues i grupit folklorik të Zall Dardhës, që me punën e përkushtimin e tij, e çoi këtë ansambël deri në Moskë, në Festivalin e Rinisë Botërore. Ansambli i Zall Dardhës ka vite që jehona e këngës dhe e valles i ka kapërcyer kufijtë shtetërorë, nga Europa në SHBA. Por, e kam njohur autori edhe kur lexoja poezitë e tij në gazetën "Zëri i Rinisë" në vitet 1975-1980.

Pas botimit të vëllimit poetik "Gonxhe në muzg", Selim Çerpja vjen me librin më poezi për fëmijë "Cicërima në agime". Ky vëllim me vjersha, mund të themi se është një arritje nga ana e nivelit artistik, krahas emrave të njohur në letërsinë për fëmijë të brezit të poetit Selim Çerpja. Ky është nga ata libra që çdo prind duhet marrë për bibliotekën e fëmijëve.

Bota fëmijënore vjen në këto poezi në një kohë ku realiteti në ditët e sotme, interneti, ka ndryshuar shumë gjëra. Ai e ndërton poezinë



mbi një fabul, më gjetje artistikisht bukur, më një mesazh të qartë artistik dhe edukuese siç janë poezitë "Bota e fëmijëve", "Kur çelin lulet", "Ne dhe fëmijët" etj., të shkruara bukur, të kuptueshme e të dashura për fëmijët.

Në letërsinë për fëmijë, botërore apo shqipe, ka poezi e fabula më kafshët shtëpiake apo të pyllit, e këto lexohen shumë, por dhe në libër do të gjejmë poezi si "Dhia më keca", "Delja laramane", "Zogu" etj., shkruar me një këndvështrim origjinal e me një vërtetësi e sinqeritet fëmijënor.

Keq si bëra askujt
Qengjin tim që kapi,
Aman mos më thuaj
Që e mori kasapi.
(Delja laramane, f. 24)

Edukimi i fëmijëve, mirësjellja, i gjen në disa poezi, që me detaje të thjeshta, por që kanë kuptim, si poezia "Jo refugjat", "Celular" etj.

Në poezinë "Gabimi", autori na jep portretin e një vajze, e lidhur shumë me babain, që mbjell një lule, e rrit e pret një ditë feste që t'ia dhurojë atij. Vjen ai moment dhe, kur po i dhuron lulen babait, sytë i shkuan të buzëqeshja e mamit.

"Gabimin e kuptova,
Se bëj përsëri,
Kur lulen e mbolla
Të kisha mbjellë dy..."
(Gabimi im, f. 37)

Poezia vjen e freskët, lexohet rrjedhshëm, vargjet kanë muzikalitet dhe janë shkruar me dashurinë e poetit prind për fëmijët, për nipërit e mbesat, për të gjithë fëmijët.

Suksese dhe më libra tjerë Selim Çerpja!

Libri i ri



Nizar Kabani
BIEN GRA NË VEND TË BORËS
Përzgjodhi dhe solli në shqip: Elmaz Fida
Shtëpia Botuese AJAN
Çmimi: 500 lekë

Bien gra në vend të borës" është libri më i ri në kolanën letërsi, pas librit "Nostalgjia është aroma" që vjen nga Ajan Books, pëmbledhur dhe përkthyer nga Elmaz Fida dhe redaktuar nga Elvana Zaimi. Plot në 223 faqe të tij libri gëlon nga fjalë dashurie e romancash të shkruara nga një poet universal dhe ndërkombëtar, si Nizar Kabani. I nxitur atëbotë si përgjigje ndaj një vendi dhe kulture ku femra nënçmohej dhe shihej si mekanizëm seksual nga mendësia partiarkale arabe.

Xhafer Martini përkthehet në hungarisht dhe esperantisht

"Këmisha e njeriut të lumtur"

Nga **SHAQIR SKARRA**

Para një viti shkrimtarit Xhafer Martini nëpërmjet WhatsApp-it i vjen ky mesazh:

"Mirdita Xhafer, jam Bardhyl Adem Selimi, mësues në pension (në fakt ka qenë pedagog i filozofisë), 75 vjeç, mik i Vesel Hoxhës dhe i Ylli Xhaferit. Para ca vitesh lexova përrallën tuaj "Këmisha e njeriut të lumtur". Më pëlqeu. E përktheva në esperantisht dhe e futa në një nga numrat e Buletinit elektronik dymujor të Shoqatës Shqiptare të Esperantos. Një mikeshë hungareze e pëlqeu dhe dëshiron ta përkthejë në hungarisht, pastaj ta përfshijë në një përmbledhje përrallash. Ajo kërkon miratimin tënd për këtë. Nëse pranon , formulo miratimin në shqip.

Shpresoj në mirë kuptimin tënd".

Martini i bëri një deklaratë ku u shpreh se ishte dakord që tregimi tij të përkthehej në hungarisht dhe të botohej në përmbledhjen përkatëse, duke falënderuar njëkohësisht të gjithë ata që e nisën dhe do të merreshin me këtë punë.

Dhe tani (22 korrik 2021) vjen lajmi nga zoti Selimi se tregimi "Këmisha e njeriut të lumtur" është botuar në librin dygjuhësh hungarisht dhe esperantisht, një përmbledhje autorësh të ndryshëm nga shumë vende. Autorit i vjen edhe tregimi i përkthyer bashkë me kopertinën e librit.

Tregimi "Këmisha e njeriut të lumtur", është botuar në librin voluminoz të Xhafer Martini me titull "Dasma me 300 nuse" (Tiranë 2010), ku në 660 faqe përfshihen tregime të lashta popullore, legjenda, gojëdhëna, përralla, margaritarë nga jeta e popullit(praktika kanunore, rrëfime, ngjarje të jetuara, alegori, dialogë filozofikë, anekdota etj.)

Tregime të lashta popullore, ku bën pjesë edhe tregimi "Këmisha e njeriut të lumtur", hapin vëllimin dhe shkojnë deri në faqen 133. Janë rreth dyzet tregime të një proze popullore që në të kaluarën diktatoriale jo vetëm nuk mblidhej, botohej dhe arshivohej, por edhe emrin nuk ia zije dot në gojë, pasi, sipas përcaktimit të Leninit për dy kulturat, kjo krijimtari bënte pjesë në kulturën e klasave sunduese.

Në të vërtetë kjo kulturë përbën shtresën më të hershme të folklorit gojor, ku "bashkëjetojnë" në harmoni të plotë shpirti dhe trupi, bota e këtushme me botën e përtejme, realiteti dhe fantazia, perceptimet konkrete dhe asociacionet. Problematika e këtyre tregimeve është shumë e pasur. Trajtohen probleme filozofike, morale, ekonomike, shoqërore, familjare, estetike, fetare, mitike etj. Në këto tregime kemi një galeri të pafundme karakteresh dhe tipash: të mirin dhe të keqin, të mençurin dhe budallain, tolerantin dhe intolerantin, të drejtin dhe të padrejtin, të ndershmin dhe batakçiun, shpresëdhënsin dhe nihilistin, bujarin dhe kopracin, fisnikun dhe vulgarin, të përkorin dhe grykësin, trimin dhe frikacakun etj.

Rreth 40 tregime të kësaj natyre Martini ka mbledhur dhe ka botuar edhe në librin "Fjala priu", Tiranë 2008, si dhe në shumë libra të tjerë ku paraqiten si lëndë ilustruese. Po t'i mbledhësh të gjithë bëjnë rreth njëmijë faqe. Po kryesore nuk është sasia e tyre, por cilësia. Lexohen me kënaqësi dhe të sjellin emocione për subjektet interesante, për humorin, për skenat dhe situatat që krijohen, zgjidhjet, gjuhën e gjallë dhe të figurshme, stilin elegant dhe metaforik.

Përmbajtja e tregimit "Këmisha e n jeriut të lumtur" është e thjeshtë dhe interesante: mbreti i një vendi, me anë të propagandës dhe mjeteve që kishte në dispozicion, kishte krijuar në popullin e atij vendi përshtypjen që qeveris me drejtësi dhe se për këtë arsye njerëzit ishin të lumtur.

Dikur në qeverinë e atij vendi kishte ekzistuar një zyrë ku paraqiteshin ankesat dhe kërkesat e popullit, por edhe atë e shkrinë përderisa, thonin ata që merreshin me propagandën, asnjë letër nga populli nuk kishte ardhur prej shumë vjetësh. Nuk kishte më ankesa dhe kërkesa.

Në këtë eufori sëmuret vetë mbreti dhe nuk la doktorë, brenda e jashtë vendit, pa thirrur për ta vizituar. Por të gjithë ngritën supet dhe thanë: është një sëmundje e padëgjuar, nuk jemi ndeshur kurrë me të. Ndërsa mbreti po tretej e thahej nga mungesa e oreksit, dhe po i shkriheshin kockat nga zjarrmia, kalon para pallatit mbretëror një plak, që thotë se ai mund ta shëronte mbretin. Mbreti dha urdhër të futej në pallat, por nuk bisedoi me të sy për sy. Plaku u takua me ministrin e Informacionit dhe doli që mbreti nuk shërohej nga doktorët dhe ilaçet, por vetëm po të vishte këmishën e një njeriu të lumtur në mbretërinë e tij. Ky njeri nuk duhej të ishte në oborrin mbretëror, por larg në vendet më të thella të mbretërisë ku nuk dihej asgjë për sëmundjen e mbretit dhe për mënyrën se si mund të shërohej ai. U nis komandanti i gardës bashkë me një trupë kalorësish për të kërkuar njeriun e lumtur që t'i merrnin këmishën. Kërko

Tregime të shkrimtarit Xhafer Martini, kështu në mënyrë krejt spontane, pa asnjë suport, janë botuar edhe më parë në gjuhë të huaja. Kështu si shembull, tregimi "Telefoni", (vëllimi "Fëshfërinte pylli i mështeknave", shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1979), është botuar në suedisht në një revistë të ilustruar. Kam bindjen se krijimtaria e këtij autori do të mund të përhapet dhe të çajë në botë për shkak të nivelit artistik që buron nga tema dhe motive krejt të reja, të freskëta dhe nga mënyra se si i ka paraqitur autori.



Kopertina e librit në gjuhën hungareze.

këtu e kërko aty, nuk gjetën. Edhe më të pasurit, ata për të cilët betoheshe se do të ishin të lumtur, jepnin shembuj dhe të dhëna për të treguar se jo vetëm nuk ishin të lumtur, por ishin fatkqinj.

Kur ishin rraskapitur së kërkuari dhe kur e kishin vendosur të ktheheshin misiondështuar, kalojnë bregut të një lumi ku ishte një arë me misra të vonë, ende të gjelbër. Aty ata dëgjuan një burrë që po këndonte. Pamjen ua pengonte gardhi i hideve por, si kapërcyen atë, para syve u doli një burrë i shëndetshëm, në gjysmë të moshës, por i veshur keq, mbuluar me një antari rupa – rupa. Kthehemi ta pyesim mos është i lumtur, thotë komandanti i Gardës Mbretërore dhe kur e pyetën ai pohoi me plot gojën që ishte i lumtur. Piqte misra të njomë në zjarr dhe këto ishte vaktet e ngrënies së tij. Kur e pyetën pse ishte i lumtur, tha"jam", por as vetë nuk e dinte shkakun. Nxire këmishën të ta blejmë me flori, se kështu e kështu e kemi punën, i thanë të gëzuar të dërguarit e mbretit.

- Po unë nuk kam këmishë, zotëri, - tha burri dhe si hapi kinat e antarisë doli gjoksi i tij i zhveshur.

Kështu me subjekte interesante dhe me të papritura shumë herë jo të këndshme janë të gjitha tregimet e këtij autori. Këto tregime me siguri nuk do të linin asnjë lexues pa i ngjallur emocione, por ne nuk kemi forma dhe mënyra për ta "ekspozuar" krijimtarinë tonë dhe, nëse ndonjëherë kjo edhe ndodh, bëhet për autorët dhe veprat që në asnjë mënyrë nuk e përfaqësojnë dot letërsinë shqipe.

Tregime të këtij autori, kështu në mënyrë krejt spontane, pa asnjë suport nga jashtë, janë botuar edhe më parë në gjuhë të huaja. Kështu si shembull, tregimi "Telefoni", (Vëllimi "Fëshfërinte pylli i mështeknave", shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1979), është botuar në suedisht në një revistë të ilustruar. Kam bindjen se krijimtaria e këtij autori do të mund të përhapet dhe të çajë në botë për shkak të nivelit artistik që buron nga tema dhe motive krejt të reja, të freskëta dhe nga mënyra se si i ka paraqitur autori. Po deri atëherë mund të shkojnë edhe shumë vjet, se nxitje dhe përkrahje të posaçme nuk ka.

Përtej një urimi në 65 vjetorin e lindjes

Arif Vladi, këngëtari emblematik i Lurës, Dibrës dhe gjithë shqiptarisë



Nga **Gëzim LOKA**

Arif Vladi, këngëtari emblematik i Lurës, Dibrës dhe krejt trojeve tona etnike, mbush 65 vjeç. Në këtë përvjetor të shënuar të jetës së tij, i urojmë dhe njëqind vite të tjerë lumturie e fisnikërie, kënge e qëndrese në emër të vlerave të shqiptarisë, të cilave iu këndoi dhe vazhdon të ju këndon në çdo ditë të jetës së tij, me pasionin dhe përkushtimin e një artisti të madh.

Arif Vladi e ka identifikuar jetën e tij me muzikën dhe këngën, kryesisht epike, ku me zërin e tij gjëmimtar, krejt të veçantë e do të thoshim unik në përbashkësinë e të gjithë atyre që e lëvrojnë këtë zhanër të këngës, është bërë një simbol i vlerave që mbart dhe përcjell arti i vërtetë tek të gjitha shtresat dhe nivelet e shoqërisë shqiptare, kudo që flitet gjuha jonë e bukur, pa kufijtë e ndarjet artificiale që na vendosën ne shqiptarëve kohët e vështira të trazimeve tona kolektive.

Këngëtari virtuoz ka një zë magjik, përtej të zakonshmes, madje do të thoshim të papërsëritshëm, ku me këngët e tij më të mira, veçanërisht me ato të epikës dibrane, si Kënga e Hajredin Pashës etj., krijoi mitin e një zëri unik, duke hyrë në zemrën e çdo shqiptari brenda e jashtë atdheut administrativ. Këngët e tij në vite mbeten në kujtesën e njerëzve të thjeshtë, u bënë hite dhe janë të preferuara edhe sot nga publiku, që e do dhe e çmon këngëtarin që i dhuroi publikut shqiptar, vetë Historisë së Muzikës Shqiptare, zërin e tij të artë, përkushtimin dhe dashurinë e pakufishme ndaj artit, dashurinë për vendin e saj, të cilin ai e mbarti kudo që vajti, në të gjitha skenat e botës, si një peng malli e përkushtimi, për t'i shërbyer deri në fund, me përkushtimin dhe përgjegjësinë e një artisti të shquar.

Majat e shkëlqimit të tij artistik dhe vetë karrierës së tij si këngëtar do të arrinte në vitet e luftës së Kosovës, ku këngët e tij si "Marrshi i UÇK-së", "UÇK-ja shpat më shpat" etj., u bënë hite dhe pjesë e ritme të përndezura të qëndresës së madhe të Kosovës martire ndaj barbarisë së fundit sllave në Ballkan. Këto këngë me autorë tekstesh poetë të mirënjohur si Gjokë Beci, Naim Plaku, me kompozitorë virtuozët Edmond Zhulali, Përparim Tomçini e të tjerë, janë jo vetëm kulme artistike të Arif Vladit, por dhe një angazhim i drejtpërdrejtë dhe aktiv i tij në valët e asaj lufte të madhe që do të sillte lirinë dhe pavarësinë e Kosovës sonë.

Arif Vladi ka shkëlqyer në festivale folklorike kombëtare e aktivitete ndërkombëtare, ka marrë mjaft çmime, duke iu dhuruar artdashësve magjinë e zërit të tij të fortë dhe plot ngjyrime jetësore e kombëtare. Këngët e tij janë saga qëndrese epiko-dramatike, që herë ngjajnë me vikamat e eposit të kreshnikëve, herë me ritmet e trazuara të përditshmërisë, por nuk mungojnë dhe këngë të tilla si "Shtatë liqejt e Lurës", si dhe të tjera këngë malli e dashurie, dhimbje e trishtimi, ku këngëtari shpalos fuqinë dhe kreativitetin e artit të tij të veçantë.

Arif Vladi spikat jo vetëm për zërin e veçantë, atë timbër të dridhshëm dhe plot solemnitet, por dhe për shpirtin e tij të vrullshëm, që iu përgjigjet këtyre joneve që dalin nga thellësitë një zemre të dashuruar me vendin e tij, me historinë dhe bashkëkombësit, mes të cilëve ndihet gjithmonë i rrethuar me dashuri, respekt e mirënjohje të pakufishme.

Si drejtor i Qendrës Kulturore Dibër, Arif Vladi ka vënë në lëvizje zembrekun e artit dhe kulturës dibrane, me veprimtari të shumta, ku mund të veçojmë konkursin poetik "Dibra dhe Kastriotët", promovuar para disa kohësh në Sinë, festimin madhështor dhe me një spektakël të mrekullueshëm artistik të 23 Gushtit, festës së Çlirimit të Dibrës etj.

Në këtë përvjetor të udhëtimit të tij të jetës dhe të këngës, i urojmë edhe një herë artistit të përmasave madhore, mjeshtrit unikal të këngës, Arif Vladit, jetë të gjatë dhe të lumtur, këngë e vetëm këngë të na dhurojë me zërin e tij aq të veçantë, për të cilën kemi aq shumë nevojë në këtë kohë gjithë ngarkesa negative dhe trazime, me të cilat po përballet jo vetëm atdheu ynë, por i gjithë globi...

Rruga e Arbërit nr. 179 180

Etnia dibrane është e vendosur brenda katër pikave gjeografike, të cilat në zhargonin popullor thuhen, "Gur e Mbigur dhe Mall e m'Zall.

traditë

DISA MBIEMRA NË TREVËN E DIBRËS

Nga **Haki Përnezha**
Valdrin VLESHA

Etnia dibrane është e vendosur brenda katër pikave gjeografike, të cilat në zhargonin popullor thuhen, *"Gur e Mbigur dhe Mall e m'Zall"*. Pra etnia dibrane shtrihet në hapsirën mes Gur Lurës dhe Shën Mbigurit, në drejtimin Perëndim - Lindje dhe nga Mall-a (përroi i Mallës në Reç) e deri në Zall (Zalli i Okshtunit). Këto pika natyrore nuk tregojnë ekzaktësisht territorin etnokulturor dibran, por në të folurën e përditshme, merret si e saktë. Gjetjet e ndryshme arkeologjike tregojnë për hershmërinë e kësaj treve. Ndër to, gjetja e një numëri të konsiderueshëm të shkrimeve në gurë, si në Gur Reç, Zall Reç, Zall Dardhë, Mustafe, Rabdisht, Luzni,Shupenzë, etj, tregon për jetë e zhvillim që nga prehistoria e deri në ditët tona e për pasojë objekt i shkrimit do të jenë fiset që banojnë në këtë hapësirë. Duke bërë një kapërcim në kohë, po kujtojmë se nga shumë studiues të cilët janë marrë me sistemin fisnor të Shqipërisë së Veriut kanë treguar arsyet e lëvizjes së shumë grupimeve njerëzore nga perëndimi drejt lindjes dhe anasjelltas. Sipas mendimit tonë, përgjatë periudhës së pushtimit osman, Dibra është dominuar nga lëvizje me drejtim nga perëndimi drejt lindjes. Lëvizje demografike drejt trevës dibrane kanë ndodhë që në periudhën paraosmane por më të mëdha ishin ato të pas shek XVIII. Baroni Nopça, duke ndjekur zhvillimet demografike të fiseve të Veriut, mendon se ato u konsoliduan në vitet 1450-1650. Pikërisht pas kësaj periudhe filloi edhe lëvizja e shumë familjeve dhe grupfamiljesh drejt Dibrës e më gjerë. Në biseda të ndryshme, plot bashkëbisedues të tregojnë për prejardhjen e tyre, por jo gjithmonë kumtet e tyre janë të sakta. Pikërisht për të ndihmuar sadopak në saktësimin e prejardhjes së ndonjë fisi (mbiemri) që banojnë aktualisht në Dibër, po ju paraqesim një pasqyrë me "gjurmët" ku disa fise dibrane mund krahasojnë prejardhjen e tyre. Gjithë materiali i servirur bazohet në *"Gjurmime etnologjike në trevat veriore shqiptare" të vitit 1999 të autorit Preng Gjika.* Për të qënë më të qartë në lexim, po sqarojmë termat ***bark, gjini, fis***, terma të cilët janë përdorë kryesisht në material: ***Disa familje me afërsi gjaku quheshin bark. Disa barqe formonin gjininë ndërsa disa gjini formonin fisin.*** Edhe pse në Dibër kjo mënyrë e organizimit shoqëror ka ndryshime të mëdha, shënimet e mëposhtme mund të sjellin më shumë informacion për shumëkënd. Për çdo fis të përshkruar janë paraqitur disa variante "gjurmë" dhe secili lexues mund të përzgjedh vet variantin më të besueshëm. Lexim të këndshëm.

1. Çela: -bark në Gjininë *Buloshaj*, fis në Dukagjin; bark në gjininë Rringaj Fisi Yzeve në Pukë; bark në gjininë Hoxha, fisi Gashi, Malësia e Gjakovës.

2. Kola: - bark në Gjininë *Kolgjonaj* në Dukagjin; -bark në Gjininë Ndërvigj, Fisi Gashi; -bark në gjininë Palojas Fisi Thaçi; -bark në gjininë Kokdodë Fisi Bobi, jeton në Bugjon; -gjini në Fisin Yzeve në Pukë; -bark në gj Palbibaj Fizi Yzeve; -bark në gj Kabali Fisi Pa Emër në Prosekë.

3. Mema: -Gjini në Dukagjin; -bark në Gjininë Buçgjeç, Fisi Thaçi në Miliska dhe Gojan; -bark në Gjininë Buçgjeç, Fisi Thaç në Fan; -bark në Gjininë Karaç, Fisi Fanëmëdhenjëve në Mirditë; -gjini dhe fis në Shosh, Fisi Shoshi.

4. Doçi: -bark dhe Gjini në Kir; -bark në Gjininë Bujan, Fisi Krasniq; -bark në Gjininë Kishaj, Fisi Bytyq; -bark dhe fis në Gjininë Doçi, Fisi Berishë; -bark dhe Gjini në Fisin Berishë në Kashnjet; -bark në Gjininë Buzëpalaj, Fisi Berishë në Rrasa e Butë dhe i afërt me Gjonin; -Gjini në Fisin Koman; -bark në gjininë Boçi Fisi Fanëmëdhenjë ardhë nga Klina Kosovës; -bark në gjininë Doda Fisi Mirditës në Simon Mirditë; -gjini e fis në Pështjesh, Fisi Blinisht; -Gjini i Fisit Blinisht në Perlat; -bark i gjinisë Kalthi në Fisin Pa Emër nga Proseka vendos në Mat; -Gjini në Fisin e Lurës i afërt me Vladin e Tollen.

5. Tanushi: -fis në Spaç nga Fisi i Yzeve bashkë me Doçin, Lalën dhe Brungën. Në Defterin e Sanxhakut të Shkodrës (1485): -Në fshatin Kuqik të Tuzit janë 3 banorë me këtë mbiemër; në Sevaç të Shkodrës një familje dhe në Çirna një banor.

6. Gjurra: -gjini dhe bark në Pelan; -bark në gjininë Kola, Fisi Yzeve , Pukë. Në Defterin osman të vitit 1485 në Pejë një banor, në Velik një banor, në Valez të Shestanit një banor, në Bgur të Mali të Zi një banor, në Koplik tre familje me këtë mbiemër.

7. Koka: -Gjini në Fisin Dushman; -bark në gjininë Kokëleka, Fisi Kabash në Pukë; -bark dhe gjini në Fisin Mirditë në Orosh; -bark në gjininë Ndreu, Fisi Blinisht në Perlat; -bark në gjininë Gjetpali, Fisi Pashtriku në Pështjesh; -bark në gjininë Baz, Fisi Zajsi nga Mati. Sipas *Valentinit* fq 324, "...vëllazëri në Brozhdë".

8. Begu: -bark i Gjinisë Vukjaka, Fisi Dushmanit në Shllak; -Gjini në Fisin Gash.

9. Lusha: -bark në Gjininë Shipshan, Fisi Gashi; -bark në gjininë Tota Fisi Yzeve në Spaç.

10. Ndreu: -gjini dhe bark në Fisin Blinisht në Perlat; -kreu i Gjinisë Blaz në Fisin Zojsi në Mat; -gjini në Fisin Yzeve në Velë Pukë, i afërt me Sulën; Ndreu në Lezhë një bark me Colin e Kolën; -Kreu i gjinisë Blazë, Fisi Zajsit në Mat. Sipas Gazullit "fis anas në Fisin Këlmend" (fq 273).

11. Kolleshi: -bark në gjininë Doçi, Fisi Blinishtve në Perlat.

12. Sul/-i,-a: -fis në Spaç në Fisin e Yzeve; -bark në gjininë Ndreu Fisi Yzeve Mirditë; bark në gjininë Hoxha, Fisi Gashi në Malsi të Gjakovës. -Sipas Gjuzepe Valentinit: *"8 veta me këtë mbiemër njihen si stradiot nga viti 1511-1565...Kemi fis Suli edhe në Mirditë dhe Sulaj* në *Ploshtan..."* Valentini fq 398.

13. Salla/k/h-u: -bark e gjini në Fisin e Blinishtve, sot në Blinisht dhe Zadrimë. Në Defterin e 1485, në zonën e Mbishkodrës janë regjistruar 2 familje me këtë mbiemër.

14. Markja-Marku: -bark në gjininë Sallaku, Fisi Blinishtëve, sot në Zadrimë; bark dhe krye gjinie në fisin Bobi.

15. Tuka: -bark në gjininë Martini, Fisi i Blinishtëve në lezhë.

16. Spata: - fis i cili përmendet që në 1304 në formën "spatos"; 9 veta "spatta" gjenden si stradiot nga 1512-1546. Ky mbiemër është i njohur edhe tek shqiptaret e Siçilisë. Sipas Defterve osmanë viti 1467, tre familje me këtë mbiemër gjenden në Kalanë e Stelushit.

17. Kuka: -bark në gjininë Gjoni, Fisi Fanëmëdhenjve në Xhuxhë; -bark në gjininë Taci, Fisi Pa Emër në Shebe.

18. Vorfi: -bark në gjininë Noka, Fisi fanëmëdhenjve ardhë nga Klina Kosovë; -bark në gjininë Xhaferi, Fisi Mirditëve në Orosh; -fis në Kthellë i ardhë nga Mamurrasi pjesë e Fisit Pa Emër.

19. Tusha: -bark në gjininë Boci, Fisi Fanmëdhenjve ardhë nga Klina në Mirditë; -bark në gjininë Lala, Fisi Blinishtëve; -fis dhe gjini në Fisin Ndërshen në Kthellë dhe Rrëshen; -gjini në Fisin Ndërshenë në Prosekë.

20. Lala: bark e gjini Fisi Mirditëve në Orosh; -bark, gjini dhe fis në Blinisht, Fisi Blinishtëve; -gjini në Fisin Zajsit; -fis në Gjoçaj i afërt me fisin Biba.

21. Koleci: -bark në Fisin e Mirditëve në Orosh; -gjini në Fisin Zajsi në Lëm të Madh, i afërt me *Krosin, Stafën***;** -bark në gjininë Noka, Fisi Zajsit në Kaçinar

22. Krosi: -bark në gjininë Noka, Fisi Zajsit në Kaçinar, i afërt me Kolecin, Stafën.

23. Paci: -bark në gjininë Lala, Fisi Mirditëve dalë nga Oroshi në Gëziq; -bark në gjininë Nexhgjinaj, Fisi Pashtrikas në Kuzhnen.

24. Kovaçi: -bark në gjininë Lala, Fisi Mirditëve në Gëziq i ardhë nga Oroshi; -bark në gjininë Gega, Fisi Yzeve Mirditë. Në Defterin osman të vitit 1485 me këtë mbiemër janë regjistruar në fshatin Bjelopojë 2 familje; një familje në Bushtinë të Plavës; një familje në Vllak në Shestan të Shkodrës.

25. Dida: -bark në gjininë Lala, Fisi Mirditëve, dalë nga Oroshi në Pllanë.

26. Voka: -bark në gjininë Xhaferi, Fisi Mirditëve, vendos në tresh.

27. Qoku: -bark e gjini, Fis Mirditëve në Korthpulë Pukë.

28. Duka: -gjini e fis në Perlat, Fisi Blinishtëve.

29. Cara: -bark në gjininë Tota, Fisi Yzeve në Spaç; -bark në gjininë Qefallarë, Fisi Mirditëve në Gëziq; -bark në gjininë Duka, Fisi Blinisht në Perlat; -gjini në Fisin Zajsi mes Lurës, Macukullit e Mirditës dhe fis në Zajs.

30. Shquti: - bark në gjininë Gegkola, Fisi yzeve Mirditë; bark në gjininë Vladi Fisi i Lurës, ndahet në Krosshqute e Canshqute.

31. Marknikolli = Manërkolli: -bark në gjininë Ndreu, Fisi Yzeve në Mirditë.

32. Feta: - bark në gjininë Ndreu, Fisi Yzeve në Mirditë.

33. Maca: -bark dhe gjini në Fisin Yzeve Mirditë; -bark në gjininë Duka në Perlat, Fisi Blinishtëve

34. Kukli = Kukeli: -fisi Kukeli nga Frangthi Fisi i Fanemedhnjëve, sot të zhdukur, kanë lënë gjurmë toponimike në Gojan dhe Kuzhnen.

35. Topuzi: -bark në gjininë Përgjonaj, Fisi Berishë në Fregen.

36. Margjoni: -bark në gjininë Teta, Fisi Berishë në Fan.

37. Rasku: -bark dhe gjini në Fisin Koman.

38. Mjeku: -bark në gjininë Karmi, Fisi Koman.

39. Beça: -bark në gjininë Zeza, Fisi Yzeve në Pukë.

40. Meha: -gjini në Fisin e Yzeve.

41. Uka: -bark dhe gjini në Fisin e Yzeve në Qelëz Pukë; -bark në gjininë Marlalaj, Fisi Zojsi, i afërt me Kaçorrin.

42. Dervishi: -bark në gjininë Uka, Fisi Yzeve në Pukë; -bark në gjininë Gjokola, Fisi Zajsit në German. Sipas Petër Bald: *"...duhet të ketë qënë fis ose bajrak në grupin e Dibrës"*; sipas Coronell *"...vëllazëri anas në Qelëz në Rekë"* (Valentini fq 83)

43. Biba: -fis dhe gjini në Spaç, Fisi Yzeve; -bark në gjininë Doda, Fisi Mirditëve në Orosh.

44. Xhetani: -gjini në Fisin e Yzeve në Mirditë.

45. Sula: -bark në gjininë Marku, Fisi Yzeve Pukë

46. Bushi: -bark në gjininë Marku, Fisi Yzeve Spaç; -bark në gjininë Tusha, Fisi Ndërshenëve në Rrëshen

47. Tota: -fis dhe gjini në Spaç, Fisi Yzeve i afërt me Carën, Lalën, Preçin etj.

48. Iskurti: -bark në gjininë Gjonlala, Fisi i Zojsit German.

49. Leshi; -gjini në Fisin Zajasi, i afërt me Kllezin (toponim në Sinë). *"...vëllazëri e fisit Leshi të Hajmelit e Zadrimës etj pas 1650 janë shpërndarë gjithandej..." Valentin fq 314.*

50. Bruçi: -bark në gjininë Blazë, Fisi Zojsi në Mat.

51. Kuca: -bark në gjininë Noka, Fisi Zajsit në Kaçinar.

52. Zo/g/k-u: -bark, gjini dhe fis në Fisin Blinishtëve në Kurbnesh; -Gjini në Fisin Bytyq.

53. Dushku-Dushkja: -bark në gjininë Zogu, Fisi Blinishtëve në Kurbnesh.

54. Visha: -bark në gjininë Gjini, Fisi Blinisht Kurbnesh.

55. Pula: -gjini në Fisin Blinisht në Kurbnesh. Sipas Petër Balt *"fis ose bajrak në Dibër" fq 393.*

56. Përndreca = Përnezha: -bark në gjininë Gjokgjinaj, Fis Blinisht në Manati; -bark në gjininë Paçukaj në Rrëshen, Fisi Ndërshenve.

57. Lleshi: -bark në gjininë Paçuku, Fisi Ndërshenve në Rrëshen; -gjini në Fisin Ndërshenë në Prosek; -bark në gjininë Gjetpalaj Fisi Pashtrikas në Pështjesh; -fis dhe gjini në Velë, Fisi Yzeve; -bark në gjininë Mici, Fisi fanemedhenjve në Xhuxhë.

58. Ruçi:-bark në gjininë Jushi, Fisi i Ndërshenve në Rrëshen i afërt me Preçin, Nokën, Kaçorrin etj.

59. Bardhi: -bark në gjininë Persimanaj Fisi Ndërshenve në Kthellë. Sipas Gazullit: *"fis i madh i shpërndarë"*.

60. Skana: -*"konsiderohet fis anas në Mashtërkor" Valentini fq 393;* Ndodhet në Orosh, Bukëmirë dhe Lurë (edhe në Kishavec Dibër).

61. Ndregjoni: -bark në gjininë Bokaj, Fisi Pashtrikas në Kuzhnen

62. Xhika: -bark dhe gjini në Fisin Pashtrikas në Mirditë.

63. Basha: -bark në gjininë Tusha në Fisin Pashtrikas në Kuzhnen.

64. Gjeçi: - gjini në Fisin Pashtrikas në Kuzhnen (e gjejmë edhe në shumë fise të tjerë)

65. Dema: -bark në gjininë Nezhgjinaj, Fisi Pashtrikas në Kuzhnen.

66.Çoku/**a:** -fis kryesor në Mirditë në hasmëri me Gjonmarkun; -bark në Gjininë Shoshana, Fisi Krasniq;- bark dhe gjini në Fisin Mirditve në Orosh dhe Korthpulë.

67. Gjoci: -fis kryesor në Mirditë në hasmëri me Gjonmarkun; -bark në gjininë Kolgeci, Fisi Krasniqe; -bark në gjininë Lala, Fisi Mirditë në Orosh; -bark në gjininë Ndrevasha, Fisi i Shalës.

68. Deda: -Një ndër fiset e Mirditës që kish hasmërri me Gjonmarkun; -gjini e fis në Shkrel; -bark në Gjininë Prenoj në Gjan Shkodër; -bark në gjininë Koman, Fisi Koman; -gjini në Fisin e Yzeve; -bark në gjininë Palbibaj, Fisi Yzeve, Spaç; -bark dhe gjini në Fisin Fanëmëdhenjve në Xhuxhë, ardhë nga Peja; -Gjini në Fisin Ndërshenve në Prosek.

69. Seli: -gjini në Fisin Kelmend.

70. Boba: -fis dhe gjini në Shalë; -vëllazëri në Fisin Dushman; -gjini në Fisin Shosh. Sipas Valentinit: *"vëllazëri e zanafillës në Gurrë dhe Nikaj të Shalës...Pas shek XVII u shpërndanë..." fq 272.*

71. Bali-Balja: -gjini në Fisin Këlmend; -fis në Vuthaj. Në Deftrerin osman të vitit 1485 në fshatin Ivrash të Malësisë së Madhe është regjistruar një familje.

72. Mertini-Martini: -gjini në Fisin Këlmend; -bark në Gjininë Gegdoçaj, Fisi Thaçi; -fis dhe gjini në Xhuxhë, Fisi Fanëmëdhenjve, ardhë nga Peja; -bark në gjininë Sallaku në Fisin Blinisht në Zadrimë; -gjini në Fisin e Ndërshenve në Prosek.

73. Grosha: -bark në gjininë Vuçinaj, Fisi Këlmend.

74. Rexha: -gjini në Fisin Këlmend.

75. Noka: -gjini në Fisin Zajs, në Kaçinar; -bark në gjininë Lelçaj, Fisi Këlmend i afërt me Lucën; -bark në Gjininë e Bolit, Fisi Këlmend; Gjini dhe fis në Temal, kreu i fisit Dushman; -bark në gjininë Buçgjeçaj, Fisi Thaç në Fan; -bark dhe gjini në Fisin Yzeve; -bark dhe gjini në Fisin e Fanëmëdhenjve, ardhë nga Klina (Kosovë); -bark në gjininë Jushi, Fisi Ndërshenve në Rrëshen; -bark në gjininë Kolpalaj, Fisi Pashtrikas, Mirditë; -bark në gjininë Gjetpalaj, Fisi Pashtrikas në Mirditë.

76. Luca: -bark në gjininë Lelçaj, Fisi Këlmend i afërt me Nokën.

77. Daci: -bark në gjininë Dedpepaj (Vulit), Fisi Këlmend; -bajraktar në Fisin Këlmend, Malsi e Madhe.

78. Muça: -bark në gjininë Gjonpepaj, Fisi Këlmend; -Gjini e fis i Fisit Bytyq, shperndarë në Has, Shënmëri, Kukës

79. Gjoka: -bark në gjininë Pepaj, Fisi Këlmend; -bajraktar në gjininë Gjoka Fisi Këlmend; -Gjini në Fisin Gash; -bark e gjini në Fisin Yzeve Pukë; bark në gjininë Cakoni, Fisi Fanëmëdhenjve në Dibërr (Mat); bark në gjininë Gjini, Fisi Fanëmëdhenjve në Xhuxhë ardhë nga Peja; -bark në gjininë Xhaferi, Fisi i mirditës në Orosh; - bark në gjininë Gjetpalaj, Fisi Pashtrikas në Mirditë; -bark në gjininë Lugja te Fisi Pa Emër në Kthellë.

80. Teta: -bark në Gjininë Pecaj, Fisi Bytyq; -bark dhe Gjini në Fisin Berishë; -bark në gjininë Biblekaj, Fisi Berishë; -bark në gjininë Levrushk, Fisi Koman; -bark në gjininë Uka, Fisi Yzeve Pukë.

81. Mata: -bark në Gjininë Zherg, Fisi Bytyq.

82. Nela: -bark në Gjininë Zherg, Fisi Bytyq.

83. Muja: - bark në Gjininë Vlahnaj, Fisi Bytyq.

84. Kaloshi: bark në Gjininë Vilicaj, Fisi Bytyq.

85. Shahini: -bark në gjininë Përgjeçaj, Fisi Thaçi.

86. Gjoni: -bark në Gjininë Geggjeçaj, Fisi Thaç; fis dhe gjini në Xhuxhë, Fisi fanëmëdhenjve, ardhë nga Peja; -bark në gjininë Sallaku në Fisin Blinisht në Zadrimë; -gjini në Fisin e Ndërshenve në Prosek.

(vijon numrin e ardhshëm)

kujtime

Me Ulvi Shehun, dibranin që më bëri mik të librit

Nga **PETRO MEJDI***

DUKE KËRKUAR BIBLIOTEKËN E QYTETIT

Nuk gjeta makinë për në Zall-Dardhë dhe atë pasdite e kalova në Peshkopi. Duke ecur në bulevardin "Gjok Doçi" (në Lurë kisha njohur të vëllain, Mustafën), në të dy anët kundërmonin blirët e çelur. Do të shkoja deri tej në Dobrovë, po të mos më kishte tërhequr vëmendjen një tabelë me të zeza mbi të cilën shkruhej "Biblioteka".

"Më dole përpara vetë", iu drejtova tabelës, a thua se po i flisja një të njohuri, i cili më kishte dalë papritur përpara. Nga sa më kujtohet, duhet të isha paralel me komitetin e Partisë, aty ku fillonte një rrugë e përpjetë, (në atë rrugicë kisha parë shpesh që të ngjiteshin jevgj grupe-grupe, ndoshta aty, pak më lart, ishte lagja i tyre.) U ktheva nga e majta dhe që aty dukej ndërtesa (ndoshta dykatëshe). Isha aq pranë saj, e gjeta menjëherë. Kjo është e bukura e qyteteve të vogla.

NË BIBLIOTEKË: ULVI SHEHU DHE. . .

Duke hyrë atë ditë atje nuk mund ta fantazoja se kjo vajtje atje bëri që të njihem me një njeri me të cilin u bëmë shumë miq. Ishte shtatmesatar, pak i zeshkët, fliste ngadalë dhe kishte një zë të ëmbël, qetësues, që ndihmonte për ta ndjekur në çdo gjë që thoshte. Gjithë pamja e tij të bindtte se ai ishte një njeri i mirë dhe me kulturë. Ndoshta kjo veçori kishte lidhje me mënyrën meditative të syve dhe gjithë pamjes së tij.

Biblioteka kishte një zyrë të drejtorit, një sallë leximi dhe salla e fondit të librave. Ajo mund të kishte dhe kthina të tjera, por unë ose aq pashë ose aq ruan kujtesa ime.

Ai e kuptoi, nga mënyra se si shikoja interierin e bibliotekës, se isha për herë të parë që hyja aty, më thirri dhe duke e shoqëruar ftesën dhe me dorë për të hyrë në zyrë.

Drejtori, pasi më pyeti se nga cili fshat minoritar isha, e kuptoi nga akcenti i shqipes time dhe shmangu atë pyetjen e parë:- Nga të kemi? - Kemi disa miq lexues nga ato anë.

Kur i thashë se jam mësues i letërsisë në Zall-Dardhë ai u çel në fytyrë. - Ti e ke bibliotekën? Pohova me kokë. - Ke ardhur si me porosi, tha ai. Besoj se e di nismën e Ministrisë së Arsimit për trajtimin shkencor të librit dhe në bibliotekat shkollore? Dhe u ngrit, shkoi në një raft përballë tavolinës, dhe me radhë mbushi dorën me letra, binte në sy një si libër.

Më bëri një seminar të shkurtër se ç'ishte trajtimi shkencor i librit, pasi ai hynte në inventarin e bibliotekës shkollore. Diçka kuptova dhe ai më qetësoi:

- Lexo me kujdes udhëzuesin, krijo një grup të vogël nxënësish për të të ndihmuar. Me fondet e librave të bibliotekave bëhen abuzime. Krijo një inventar të qëndrueshëm. I futi materialet në një çantë dhe duke ma dhënë atë më tha: - Do të vij në Dardhë, të shoh punën që do të bësh. Dolëm së bashku nga zyra e vogël dhe më shoqëroi në fondin e bibliotekës.



Në foto: ***Ulvi Shehu***

DHE DISA BOTIME TË AUTORËVE DIBRANË: HAZIZ NDREU, XHAFER MARTINI, INAJET SHEHU, ARIAN KADIU

















Mësova se ishte me origjinë nga Dibra e Madhe, Shehri, siç dëgjoja që ta thoshnin shpesh të vjetrit. Ata, të Dibrës kishin emrin e mirë për mençuri, kulturë dhe si tregtarë të dëgjuar. Shumë e thoshin me krenari dhe me zë të ulët, se ishin me origjinë nga ai qytet shqiptar i dëgjuar në historinë kombëtare, përtej kufirit. E kam parë atë qytet,i shtrirë në fushë, nga Ostreni dhe nga kloni, në udhën automobilistike buzë Drinit të Zi.

Iu drejtua një burri që diçka shkruante në tavolinën e sallës së leximit. - Shoqëroje në sallë dhe në fond, t'u hedhë një sy librave dhe periodikut. Kemi libra dhe revista në gjuhë të huaj, tha pas pak drejtori. - Edhe në greqisht? - i them. - Kemi nga disa gjuhë ballkanike, u përgjigj ai dhe më vështroi në sy. Ndoshta për të parë nëse u gëzova. Dhe vërtet ndjeva gëzim.

NIN RAJTA - POETI I LURËS

Ai që më shoqëroi në sallë ishte një fytyrë e njohur. Pas pak u kujtova se ku e kisha parë, në Krej-Lurë. Isha duke shëtitur në një pllajë të gjelbër, ndoshta një rudinë, me Bibë Doçin, drejtorin tim për 10 ditë, se më transferuan në Fushë Lurë, ai më foli për të. U afrua dhe u takuam. E kam takuar dhe në Fushë-Lurë. Bëheshin një grup më i madh, midis tyre kishte mësues, agronomë, Sul Vladi, rapsodi Ali Peka, (në e them saktë emrin). Oficerë, kujtoj Veip Lushën, doktorin e zonës etj. E kisha parë dhe në qytet. Që ta njoh më ndihmoi dhe ngjashmëria me të vëllanë Sokolin. Ishte Nin Rajta. Në almanakun "Dibra" dhe në gazetën lokale "Ushtima e maleve" kisha lexuar krijime të tij. Më së shumti artikuj dhe prozë. Kishte një problem shëndeti dhe me rekomandim të mjekëve e emëruan në qytet, për të qenë pranë tyre.

Duke parë fondin e librave dhe revistave në gjuhë të huaj, u befasova me disa libra dhe revista në rumanisht. I lexova me zë titujt e revistave. Ndoshta nga befasia se mund të gjeja botime në gjuhën rumune në Peshkopi. "Industria a lemnului" (Industria e drurit) dhe "Pëdurea mare"(Pylli i madh "). Nini, si pikasi habinë time më tha:- Peshkopia ka shumë pyje, ka disa stabilimente sharrash, ka dhe një fabrikë mobiliesh. Këtu, kohë pas kohe, janë emëruar inxhinierë që kanë studiuar për pyjet në Rumani. Librat në rumanisht që shikon janë dhurime të tyre, i linin kur transferoheshin. Mbaj mend një roman të Ion Sllavicit. Dhe një pjesë e librave në greqisht janë dhuratë nga kuadro minoritarë.

U kthyem tek zyra e drejtorit. - A i jepni jashtë bibliotekës revistat në rumanisht? - i them drejtor Ulviut. Ai u mendua pak dhe tha:- Në fakt nuk i nxjerrim jashtë, por meqë kanë vite pa i hapur njeri, do të ta bëjmë një lëshim. . . .

U hodha një sy revistave. E para "Industria e drurit" ishte teknike, e dyta "Pylli i madh", më ngjau pak me revistën tonë "Bujqësia socialiste". Ishte një revistë mozaik dhe shkencë për pyjet dhe kulturë dhe gazetari. Mora disa numra të "Pylli i madh". Kisha filluar mësimin e rumanishtes, do të më ndihmonte.

Nini i thirri drejtorit se po dilja. Ai më përqafoi dhe më tha se do të vinte në Zall- Dardhë.

Dhe vërtet erdhi. Unë me ndihmën dhe të një grupi nxënësish me përgjegjës Shefki Barën, gati e kisha mbaruar inventarin dhe skedimin e librave.

E ftova në shtëpi dhe kaluam një natë magjike. U bë magjike se u prish monotonia, e bënë të tillë biseda për librin dhe letërsinë. Të bisedoje për librin dhe letërsinë me Ulvi Shehun, ishte një kurs i shkurtër për letërsinë dhe artin. Ai njihte pikturën, ishe një enciklopedist. Njihte dhe shkrimtarë minoritarë, ata që ishin në fondin e bibliotekës. Atë mbrëmje njoha në thellësi këtë njeri me kulturë. Ai mishëronte virtytet dhe cilësitë e qytetit të tij të origjinës, Dibrës së Madhe, shehrin e Dibrës, siç i thoshin andej nga ana e Maqellarës dhe Shupenzës. Atë natë dhe fëmijët fjetën vonë. Kishim mik në shtëpi, gjë e rrallë për ta.

Ai kishte shumë miq nga e gjithë Shqipëria. Ata ishin që nga lexuesit e vegjël të shkollave të qytetit, kuadrot dhe specialistët vendas e deri tek kuadrot e ardhur nga rrethet e vëndit. Ata tek Ulvi Shehu gjenin një mbështetje të madhe për punët studimore dhe zbatimet shkencore në ndërmarrjet ku punonin. Falë njohjeve të tij në Bibliotekën Kombëtare dhe emrit të mirë që kishte atje, ai e pajisi bibliotekën me një bibliografi të pasur teknike dhe teorike në gjuhë të huaj. Miqtë e tij ishin mësuesit, mjekët, oficerët. Në sajë tij biblioteka e Peshkopisë ishte kthyer në një institucion në ndihmë të prodhimit dhe formimit teoriko-shkencor të inteligjencës së kohës, ajo kishte një emër të mirë në fushën e bibliotekave dhe botën shkencore të kohës.

INTERMEXO

Kur shkova në një seminar në Peshkopi i vajta për një vizitë në shtëpi. Na kishte ftuar atë mbrëmje në Zall- Dardhë.

- Banoj në Dobrovë, - më tha. Pyet për mua dhe do të ta tregojë dikush pallatin ku banoj. Dhe e gjeta kollaj apartamentin e tij në lagjen në hyrje të Peshkopisë. Aty njoha dhe të shoqen, Natashën, mësuese në qytet, e cila pas vitit 1990, u zgjodh deputete në Kuvendin e parë pluralist, me opozitën. Nuk e pashë më vonë në Kuvend. Unë që e njoha këtë çift të kulturuar nuk mund të përshtatej me atë klimë politike të atyre viteve. Mbaj mënd mobilimin e sallonit dhe bibliotekën e pasur. Ishte një vizitë plot ngrohtësi dhe kulturë që rrezatonte çifti Shehu.

EPILOG

Mësimet që mora nga Ulvi Shehu i vura në dobi të bibliotekës në Ulëz dhe të shkollave Bushkash, Shkopet, Stojan dhe Baz. Isha kryetar komisioni i lëndëve dhe me nxitjen dhe të metodistes së kabinetit pedagogjik Anthulla Kristo, bëra skedimin dhe inventarizimin e librit. Në një seminar të zhvilluar në Klos më habiti puna e Gjok Dabajt në bibliotekën shumë të madhe të shkollës.

Në bibliotekat e zonës së Baz-Shkopetit gjeta libra të mrekullueshëm, zgjodha disa dhe i ndërrova me libra të Ulzës. Jam penduar që në vitin 1992, koha kur ika, nuk mora disa nga këta libra, sidomos botimet e ciklit "Biblioteka e traditës", botime të cilat nuk do të përsëriten më.

Sa herë që më bien në dorë ose që i shoh në trotuare libra të skeduar, më kujtohet miku im, i miri dhe i paharruari Ulvi Shehu. Ndoshta bashkia e Dibrës e ka nderuar duke i vënë emrin e tij një rruge të qytetit verior.

(Marrë nga Facebook-u i autorit)

Rruga e Arbërit nr. 179 180

histori



Libri “Kongresi i Dibrës” i Qenan Zija Manastirit, dokumenti monumental

Nga **RAMAZAN S. ILNICA**

NË VEND TË HYRJES

Në gazetën “Rruga e Arbërit”, korrik 2009, jemi njohur me veprimtaritë në kuadër të 100-vjetorit të Kongresit të Dibrës dhe me materialet në konferencën shkencore për 100-vjetorin e Kongresit të Dibrës.

Atëherë kam lexuar dhe një kumtesë të Mr. Ruzhdi Lata, me temën “Kontributi i Qenan Manastirliut në Kongresin e Dibrës”. Autori shkruan: “Veprës së Qenan Manastirliut i ka bërë një studim të veçantë Haki Sharofi, por këtij libri i referohen gati tërë historiografët që janë marrë me këtë ngjarje historike...” Mr. Ruzhdi Lata ka shumë të drejtë për atë që thotë se “...mendoj se nuk është folur aq sa e ka merituar ky personalitet i shquar shqiptar...”

Duke u interesuar për Qenan Manastirin, gjeta një kopje të librit të tij, përkthyer dhe botuar nga z. Haki Sharofi më 1940. Pas leximit të librit, lexuesi bindet se të gjitha ato çka është shkruar për Kongresin e Dibrës janë marrë nga vërejtjet dhe komentet e përkthyesit, z. Haki Sharofit, por jo nga libri i autorit dhe asnjëherë nuk është cituar vepra dhe autori Qenan Zija Manastiri, ndonëse janë marrë faqe të tëra prej tij.

Pikërisht kjo më shtyu të shkruaj për autorin dhe librin e tij.

* * *

Libri “Kongresi i Dibrës” i Qenan Zija Manastirit një dokument me vlera të mëdha për Historinë e Shqipërisë dhe një panegjerik për qytetin e Dibrës së Madhe dhe të të gjithë delegatëve nga 5 vilajetet dhe nga qytete me rëndësi në çështjen kombëtare shqiptare.

Kongresi është mbledhur në Dibër të Madhe më 10 korrik 1325 (kal.hënor) ditën e premte që korrespondon me datën 23 korrik 1909, pra me njëvjetorin e vendosjes Kushtetutës së konstitucionit otoman. Në Kongres kanë marrë pjesë delegatët e pesë vilajeteve të Rumelisë: Selanik, Manastir, Kosovë, Shkodër e Janinë si dhe nga qytete te tjera dhe të etnive të tjera banuese brenda trojeve shqiptare. Në Kongres morën pjesë 325 delegatë nga të gjitha qytetet e vilajeteve shqiptare dhe nga ta gjitha besimet fetare, si: të krishterë, ortodoksë e katolikë, hoxhallarë e shehlerë, por këtu morën pjesë edhe 15 serbë dhe maqedonas në krye me Glisha Elezoviqin, 15 grekë në krye me Todorçe Naumin, nga Bullgaria mori pjesë Ilo Dimashov, ndërsa në Kongres morën pjesë edhe Bellomaçe – vlleh (revizor i shkollave), Pop Apostolli – serb nga Kosova etj.

Për nga përmbajtja e bisedimeve dhe nga veçoritë e problemeve të trajtuara në Kongresin e Dibrës së Madhe ka mbizotëruar karakteri shqiptar, por natyrisht nën suazën e mbretërisë Otomane.

Nga historiku i dhënë nga autori z. Qenan Zija Beu nga Manastiri si dhe nga vërejtjet dhe komentet e përkthyesit, z. Haki Sharofit, ne mendojmë se ka qenë fat i keq që historia e atij Kongresi ka mbetur në një heshtje të gjatë, sepse është i paktë dhe shumë i kufizuar numri i lexuesve shqiptarë që kanë pasur fatin ta kenë në dorë këtë vepër të vyer, madje dhe në studimet historike nuk është cituar dhe s’është përmendur libri në fjalë, ndonëse tashmë pranohet se është përshkrimi më real I historikut të Kongresit të Dibrës. Libri është shkruar në vitin 1909-1910 nga autori në turqisht dhe është botuar më 1912. Pastaj janë dashur 32 vjet për t’ua bërë të njohur shqiptarëve në shqip të botuar më 1944. Është rast fatlum që pasardhësit e të nderuarit Haki Sharofi ta ribotojnë te “Biblioteka Haki Sharofi” më 1990, pra plot 46 vjet më vonë.

Vepra e z. Qenan Manastirit është një libër me vlera të mëdha jo vetëm në aspektin historik, por dhe me vlera të mëdha kulturore për të njohur ngjarje të ndodhura mbi 100 vjet më pare dhe që sivjet mbushen 105 vjet nga botimi i parë.

Kongresi i Dibrës është një ngjarje me rëndësi historike kombëtare dhe vendimet e tij janë shkruar sipas dokumenteve të dhëna në Vendimet e Kongresit të Dibrës. Por në tërë studimet me karakter historik nuk citohet askund se materiali është marrë nga libri I shkruar nga Qenan Manastiri. Autori madje nuk njihej, nuk kishte shkrime për të në kohën kur u botua i përkthyer (më 1940) siç na e thotë dhe përkthyesi Haki Sharofi në “Vërejtjet e komentet e përkthyesit”: “Auktori edhe me këtë vepër të tij na provon edhe një herë se ka qenë nji ndër veteranët e çmuëm që ia kanë kushtue mundin e tyre lëvizjes kombëtare. Për fat të keq na mungon jetëshkrimii tij për të cilin s’dijmë kurrëgja. Na ka mbetë në dorë vepra e tij shumë e vlefëshme që është dokumenti monumental i Kongresit të Dibrës.”1 (Haki Sharofi) .

Libri “Kongresi i Dibrës” është libër kujtimesh relativisht i vogël, rreth 70 faqe, por me të drejtë duhet thënë se vërtet është një dokument me vlera të shquara dhe duhet vlerësuar si monumental, siç e ka thënë zoti Haki Sharofi.

KU QËNDROJNË VLERAT E LIBRIT DHE NË CILAT ASPEKTE DIBRANËT DUHET TA SHQYRTOJNË VEPRËN?

Së pari, veç që është një vepër që ngre lart patriotizmin, mençurinë dhe trimërinë e burrave më përparimtarë të Shqipërisë, “Kongresi i Dibrës” është dhe një vlerësim i bukur dhe plot dashuri nga një Manastirli i Madh për Dibrën dhe Dibranët. Lexuesi njihet me vlerësimet që u bën autori virtyteve të larta të Dibrës. Këto më së shumti janë paraqitur në Parathënien dhe në Hyrjen e librit, por dhe në përshkrimin e shkëlqyer të përcjelljes së kongresistëve. Ja si e fillon Hyrjen autori:

“Dibra asht nji vend historik. E pohoj dhe unë vetë që asht e famshme... qysh në fëmijërinë time pata ndigjue fjalët: “Dibra asht trazue, në Dibër po ngrifet nji kuvend!” ...Qe, tash po dukej Dibra, e cila kishte përzanë Prefektët e i kishte ba të ikin Pashallarët e kohëve despotike, Dibra që në kohët më të vështra të tiranisë, e thirrte në Zyrën telegrafike Sulltan Hamidin...” Në mënyrë të veçantë autori ngre lart mikpritjen e dibranëve, inteligjencën dhe hollësinë (mprehtësinë) mendore të tyne...” Autori ngre lart dhe lavdëron me fjalët më të mira burra të shquar të Dibrës, si: Vehbi Dibra, Hoxhë Vokrri, Ibrahim Daci, Zejnulla Efendi Hatibi, Jusuf bej Karasani e shumë dibranë të thjeshtë që i pritën me dashuri e bujari të jashtëzakonshme.

Së dyti, shqiptarët me të parë dhe me të dëgjuar se ku ishte qëllimi i të gjithëve atyre që e përkrahnin Perandorinë, si dhe i fanatikëve dhe puthadorëve të pushtetit, ndërmjet delegatëve zhvilluan diskutime të ashpra rreth rendit të ditës dhe pikave të hartuara nga xhonturqit, që shpeshherë solli debate të ashpra dhe me ndërprerje, e herë-herë edhe me ngritje të gjakrave. Por, falë zgjuarsisë së kryetarit të Kongresit, Vehbi Dibra, arriti të qetësohet gjendja.

Ndërsa turqit e rinj dhe pasuesit e tyre vazhduan bisedimet në vendin e quajtur Beledije(Bashki),atdhetarët shqiptarë u mblodhën në teqenë e Baba Shabanit.Këtu,në drejtim të qëndrimit burrëror të Qenan Zijait,u thanë shumë fjalë,me ç’rast edhe Vehbi Dibra kryetar i këtij Kongresi e përshëndeti aktin e këtij burri të shquar të Manastirit. Ndërsa Hafiz Ali Korça,pjesëmarrës në këtë tubim,shkruan : “Ata që e ndezën diskutimin në këtë komision ishin: Myfti Vehbi Dibra, Myfti Kara Rexhepi, Mytesim Këlliçi, Haxhi Ibrahim Pustina, Haxhi Ali Elbasani, Aqif Pashaj, Sadik Pash Janina, Mustafa Arifi, Ihsan bej Selaniku, Evrenoz Zadeja, Qenan bej Manastirliu, Abdyl Ypi dhe shumë të tjerë“.[1]

Së treti, vepra është shkruar me vërtetësi nga delegati i Manastirit që ka qenë një nga anëtarët më të shquar të Komisionit 45-anëtarësh të Kongresit të Dibrës. Përshkrimet e debateve të Komisionit tregojnë qartë se kanë vërtetësi reale të ngjarjeve. Të mos harrojmë se autori Qenan Manastiri e ka shkruar librin sipas shënimeve të marra direkt nga punimet e Komisionit duke u konsultuar me procesverbalet e Mbledhjeve të mbajtura nga sekretari i zgjedhur. Ndonëse botimi i librit është bërë më 1912, dorëshkrimi ka qenë i gatshëm që më 1909, pra me mbresat e freskëta të marra nga zhvillimi i punimeve të Kongresit. Dhe duhet theksuar se, ndonëse përkthyesi në fjalët e tij në pasthënie nuk e di biografinë e Qenan Manastirit (sipas citimit që bëmë më sipër), sepse tashmë e njohim mirë veprimtarinë e tij të çmuar kombëtare.

KRONIKË E SHKURTËR E ZHVILLIMIT TË KONGRESIT TË DIBRËS SIPAS LIBRIT

• E para mbledhje e Përgjithshme -

Në këtë mbledhje të të gjithë delegatëve dolën në pah dy korrente: Korrenti i parë ngulte këmbë sa më poshtë: “Komisioni nisiator që na ka ftue, paska hartue një program shumë të mirë; e aprovojmë dhe e shpallim këtë program edhe shpërndahemi.” Ndërsa ana tjetër thoshte: “Jo, nenet e atij programi mund të jenë të mira, por nuk erdhëm deri këtu vetëm për t’i aprovue atë program; mbledhja jonë nuk është miting, por Kongres; të bisedojmë sipas rregullit, të mejtojmë interesat e atdheut e të popullit; pse me u ngutë? A s’kemi ardhë këtu për të ba shërbim?”[2]

Me të drejtë dhe me shumë saktësi autori i librit i emërton me termat përkatëse: “Ligji natyral i njerëzisë edhe këtu e ushtroi autoritetin e pushtetin: Tashma u trajtuen Konservatorët e Përparimtarët. [4]

Autori i librit del që është një njeri që njeh mirë standardet civilizuese, kur në mbledhjen e bërë në teqen e Shaban Dedes propozon rregullat e kongreseve të shoqërive të përparuara. Ja se si u shpreh ai: “...Por bisedimet nuk mund të bëhen kështu. Asht e pamundun me u mbledhë në një vend kaq kallaballëk e me ra në marrëveshje. Si bajnë kudo, ashtu dhe ne t’u shtrohemi rregullave të Kongreseve. Të zgjedhim një Komision të përbamë prej përfaqësuesish të caktuem në emën të çdo Vilajeti...”[5] Në fund u zgjodh komisioni me dyzet e pesë anëtarë tue i lanë rast që të përfaqësohet çdo krahinë e të mos mbetet shtek me u marrë nëpër kambë dinjiteti i ndonjë vendi.”[6] Interesante është karakteri multietnik dhe përfaqësimi i pakicave në trojet me shumicë shqiptare të të gjitha trevave.

• Mbledhja e parë dhe dytë –

Në këtë mbledhje së pari u bë zgjedhja e kryetarit dhe e sekretarëve: kryetar z. Vehbi Dibra, myftiu i Dibrës, sekretarëu zgjodhën z. Ihsan bej Selaniku dhe z. Halid efendi Gjirokastra. Në mbledhjet e dy ditëve u diskutuan me replika dhe kundërshtime pikat e programit (nenet e shpërndara nga komiteti iniciator). Interesante për mendimin tonë janë diskutimet dhe deklarimet e komisionerëve përparimtarë për termat e telegramit: “besa, Shqipni, indipendencë, kombëtar”. Ndonëse kanë kaluar afro 110 vjet nga ai Kongres, evidentohet qartësia me të cilën ata njerëz të shquar dhe me kulturë të madhe që kanë dhënë përfundime me terma të sakta.

Ne do të citojmë disa prej tyre, sepse mendojmë që kanë rëndësi, ndërsa nuk do të zgjatemi shumë me vendimet e Kongresit të Dibrës që janë shkruar bukur nga historiografia shqiptare.

Debate u bënë kur Elezoviq Efendiu (përfaqësuesi serb), kundërshtoi termat “besë” (si diçka “barbare” tash në kohët moderne, sipas tij), termin “Shqipni” dhe “indipendencë” si ndjenja separatiste etj. Ja disa pasazhe nga shprehjet e disa përfaqësuesve:

Abdul Beu: - “... Shqiptarët, që janë bijtë ma të lashtë të gadishullit të Ballkanit, me besën e tyre e kanë ruejt qenien e vet dhe e kanë diftue veten... Shkurt: Shqiptari Besën e ka të paatakueshme e të pacënueshme. Shqiptarët me besë kanë jetue, me besë do të jetojnë.”

Rexhep Efendiu: - E refuzoj rreptësisht atakun me të cilin shoku jonë fyen. Besa asht nji nga gjanat e shenjta të një kombi...”

Hafiz Ali Efendiu (Korçë): - “Edhe me termën (Maqedoni) s’fitohet gja. Sepse (Maqedonia) don të thotë Shqipnija e Vjetër. Banorët autoktonë dhe të moçëm të Maqedonisë janë pellazgët, stërgjyshët e shqiptarëve.”[7]

Haxhi Ibrahim Begu (kryetari i bashkisë së Shkupit): - “Kosova më çdo anë është Shqipni; megjithatë Shqiptarët qysh prej kohësh jetojnë në harmoni me bashkatdhetarët e tjerë pa asnjë dallim; pra nuk asht e udhës të polemizohet për Besën Shqiptare, që don të thotë me dhanë fjalën e nderit e të ndërgjegjes...”

Halim Beu: - Duhet ta dijë shoku jonë se vendi i tij asht Shqipni. Pra s’asht e mundun t’i jepet tjetër emën këtij vendi.”

Qenan Manastiri (me simbolin “M.” në libër) : - “...Sa për emnin e Kongresit, Dibra si dhe vendi i lindjes së shokut tonë qysh prej kohëve kur ka fillue me u shkrue historija, janë atdheu i Shqiptarëve, pjesë e Shqipnisë... Shqiptarët, sikurse tha kolegu jonë Hafiz Ali Efendiu, janë popull autokton i këtyne anëve pa ndonjë rival qysh në kohët e lashta... dhe vendin e tyre e quejnë Shqipni, nuk hjekin dorë nga ky emën dhe nuk lejojnë me i dhanë emën tjetër. Prandaj unë kërkoj që Kongresi ta ruajë titullin e vet. (”Kongresi i Dibrës”).

Shanof Efendiu (Kostur): - ... Besa në Evropë nuk njifet me një kuptim të padenjë, por si një nga gjanat më të shenjta kombëtare. Unë kur u zgjodha prej vendit tem si delegat për me marrë pjesë në Kongresin e Shqiptarëve, mora porosi që të kem besim në Besën e Shqiptarëve dhe të bie dakord pikë për pikë me ta.”[8]

(Vijon numrin e ardhshëm)

homazh

Vasilika Vladi, bija e Lurës, që i kishte hije rroba ushtarake dhe fisnikëria…

Nga **MUSA RIÇKU**
GËZIM LOKA



Korrektesa e saj, zgjuarsia dhe intelekti, fisnikëria dhe mirësia, shpirti human dhe gatishmëria për të ndihmuar lurianët, ishin disa cilësi, që ajo i përcolli çdo ditë në punën e saj, në çdo gjurmë që la pas.

Dashuria për lurianët ishte dhe mbeti kryelajtmotivi i jetës së saj, shtytje drejt veprave fisnike e punëve të mira, drejt realizimeve të bukura, që mbartin farët e dashurisë dhe të mirësisë njerëzore.

Të shkruash për një bijë luriane që u nda nga jeta në një moshë ende të re, me gjurmë të lëna në kujtesën e lurianëve dhe jo lurianëve, është obligim dhe dhimbje, pasi për të duhet të flasim në kohën e shkuar. Ajo la pas një vepër dinjitoze në karrierën e saj ushtarake, la gjurmë fisnikërie për njerëzit që e deshën dhe e çmonin për atë që ajo ishte dhe për çfarë përcillte si mesazh me jetën e saj.

Të gjithë ata që e njohën e nuk e njohën, lurianë e dibranë, mirditorë dhe njerëz nga e gjithë Shqipëria, ushtarakë dhe civilë, e përcollën me lot në sy e dhimbje në zemër, bijën e Lurës, ushtaraken shembullore, vajzën fisnike Vasilika Vladi, që u nda nga jeta në një moshë ende të re, kur kishte aq shumë për të dhënë për familjen e saj, Atdheun dhe shoqërinë. Ajo ishte e bija e Nikoll Vladit, një ish ushtarak shembullor, kryetar i Veteranëve të LANÇL në Lurë, trashëgimi e një familje atdhetare, ku gjyshi i Vasilikës, Bibë Vladi ka qenë partizan dhe xhaxhai, Gjergj Vladi, gjeneral në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës.

Mbi bazën e kësaj tradite, ajo u rrit dhe u brumos me frymën e atdhedashurisë, të respektit për vendlindjen e saj, të nderimit të prindërve dhe të moshuarve, të gatishmërisë për të ndihmuar hallexhinjtë dhe të pamundurit.

Jeta e saj në çdo ditë dëshmoi energji dhe vlera pozitive, u bë një burim frymëzimi për të gjithë ata që kërkonin një model për të ecur përpara në jetë, pa u dorëzuar para asnjë sfide dhe vështirësie.

Lindi më 8/08/1966 në Fushë Lurë Dibër dhe deri në frymën e fundit mbajti veshur rrobën ushtarake, të cilës i shërbeu me ndershmëri e pasion, duke lënë pas gjurmë të bukura në jetën dhe karrierën e saj.

E nisi karrierën në vitin 1995, duke punuar si daktilografiste në repartin nr.7007, për të vijuar më tej si magaziniere kujdestare në një repart tjetër ushtarak, më tej ka qenë sekretare operative", për të vijuar si "instruktore për stërvitjen", ka kaluar më pas në pozicionin "nënoficere stërvitje" e kudo ka shkëlqyer për zgjuarsinë, intuitën, dashurinë për rrobën e ushtarakut, përgjegjshmërinë dhe shpirtin e sakrificës.

Më tej do të vijonte në detyra të tjera si nënoficere stërvitje dhe planizimi, nënoficere-specialiste sigurie, nënoficere stërvitje kursi fillestar, nënoficere, instruktore përgjegjëse për kursin fillestar, nënoficere për ruajtjen e sigurinë, gjersa doli në rezervë, me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr. 62, datë 22/01/2020, karrierë gjatë së cilës mbajti gradat kaptere IV, Rreshtere dhe në fund kaptere.

Ishte e motivuar në punë nga përgjegjësia e plotë për detyrën dhe misionin e ushtarakut, ku me pasion e përkushtim shembullor ia doli në krye çdo pune e misioni, duke qenë shembull korrektese e përgjegjshmërie për të gjithë ata që e rrethonin në përditshmërinë e saj.

Ishte një vajzë dinjitoze, ushtarake model, njeri shpirtmirë e zemërpastër, e cila bënte aq shumë për lurianët e saj dhe të gjithë ata që kishin nevojë për të dhe të cilët e donin dhe e çmonin si ta kishin motër.

Ishte e gjendshme, e papërtuar, fjalëmbël, modele e lurianes së edukuar, në një shtëpi të mirë e të fisme, në një familje ushtarakësh e atdhetarësh, që në breza kanë dhënë kontribute atdhetare.

Buzagazi dhe çiltërsia e saj të shoqëronin gjatë pas çdo takimi me të, pasi ajo dinte të respektonte gjithkënd e të ndihmonte cilindo që mundej, pa u lodhur dhe pa u ankuar asnjëherë.

Unë bashkautori Musa Riçku e kam pasur nxënëse dhe, kur më takonte, pas dekadash që nuk e kisha parë, më përqafonte me mall. Ishte shumë e shkathët dhe në garat sportive kishte zhdërvjelltësinë e një djali.

Korrektesa e saj, zgjuarsia dhe intelekti, fisnikëria dhe mirësia, shpirti human dhe gatishmëria për të ndihmuar lurianët, ishin disa cilësi, që ajo i përcolli çdo ditë në punën e saj, në çdo gjurmë që la pas.

Dashuria për lurianët ishte dhe mbeti kryelajtmotivi i jetës së saj, shtytje drejt veprave fisnike e punëve të mira, drejt realizimeve të bukura, që mbartin farët e dashurisë dhe të mirësisë njerëzore.

Vasilika tani nuk është më midis nesh, nuk na ngroh me buzëqeshjen e saj të shpenguar, me vrullin dhe energjinë që e karakterizonin në çdo punë, në çdo bisedë e komunikim njerëzor.

Por mbeten pas dhe nuk shlyhen kurrë kujtimet për të, për vajzën luriane që aq shumë e donte jetën dhe njerëzit, mbeten shenjat që ajo la në kohë, përkushtimi dhe dashuria për lurianët e saj, që ishin dhe mbetën deri në fund dhuntia e saj njerëzore, si bijë e Lurës dhe si bijë e shqiptarisë…

Dr. Fatmir Doda, mjeku i përkushtuar, personaliteti mjekësisë shqiptare

Nga prof. dr. Xheladin **ÇEKA***



Dr. Fatmir Doda ishte një mjek i përkushtuar, personalitet në fushën e mjekësisë shqiptare, që la gjurmë të pashlyera për aftësitë profesionale dhe për humanizmin e tij të pashoq.

Kolegë të lëndës së Anatomisë që e kanë njohur dhe kanë punuar me të, janë shprehur se ai ishte një pedagog i aftë dhe mjaft i përgatitur.

Ulind me 21 dhjetor 1933 në Durrës, ndërsa i ati, Xhelili ka lindur dhe është rritur në Reç të Dibrës. Në vitet 1955-1960 ka kryer Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 1961, menjëherë pas përfundimit të studimeve, për rezultatet e larta të arritura në këto studime, u emërua as/pedagog në lëndën e Anatomisë Normale, pas një peripecie paraprake që lidhej me emërimin e tij fillestar në Kardiologji. Në takim me Dr. Fatmir Dodën, ndonëse ai nuk "shprehej" për rezultatet e tij të larta që kishte arritur në studimet universitare, më ka pranuar se ndërkohë që ishte student, ishte përgjegjës i grupit mësimor ku bënte pjesë, duke qenë kështu një përfaqësues i zgjedhur i tyre. Kolegë të lëndës së Anatomisë që e kanë njohur dhe kanë punuar me të, janë shprehur se ai ishte një pedagog i aftë dhe mjaft i përgatitur. Por ndonëse Dr. Fatmir Doda qëndroi si as/pedagog i lëndës së Anatomisë Normale vetëm për një kohë të shkurtër dhe më pas për interpretime politike të kohës u largua nga fakulteti, ai ka lënë gjurmë në Katedrën e Anatomi-Histologjisë (sot Departamenti i Morfologjisë), si një pedagog i zoti i kësaj lënde, nga më të vështirat në Fakultetin e Mjekësisë. Më pas u transferua në Spitalin e Kukësit, si drejtor i këtij spitali, të cilin e drejtoi në vitet 1965-1971. Në periudhën 1972-1993 u transferua në Tiranë, ku kreu funksionin e Drejtorit të Shërbimit Shëndetësor në Ndërmarrjen Bujqësore "Gjergj Dimitrov". Njohës i disa gjuhëve të huaja; i specializuar në Patologji dhe Radiologji. Pas daljes në pension, punoi për një kohë të gjatë në klinikën e tij private në Sauk të Tiranës, duke iu ardhur në ndihmë banorëve të zonës me shërbimin e tij shëndetësor të kualifikuar. Dr. Fatmir Doda ishte një mjek i përkushtuar, personalitet në fushën e mjekësisë shqiptare, që la gjurmë të pashlyera për aftësitë profesionale dhe për humanizmin e tij të pashoq.

Nga biseda me Dr. Fatmir Doda, *si ish student i Fakultetit të Mjekësisë dhe si ish as/pedagog i lëndës së Anatomisë Normale në periudhën 1961-1962****, në një takim të realizuar me të në janar të vitit 2020 në Kafe 'Europa",*** *Dr. Fatmiri më ka treguar, se kur ai kishte ardhë as/pedagog në Lëndën e Anatomisë Normale, siç tregon ai, kishte patur "dy shefa, dy Skënderë": Dr. Skënder Dauti, Shef i lëndës së Anatomisë Normale dhe Doc. Skënder Çiço, Shef i lëndës së Histologji-Embriologjisë njëherësh dhe Shef i katedrës së Anatomi-Histologjisë. Për Dr. Skënder Dautin ai më ka sjellë në kujtesë thënien e një shokut të tij të fakultetit në Bukuresht, të Dr. Klement Shtetos, sipas të cilit Dr. Skënderi ishte një gjeni. Atë nuk e arrinte asnjë nga kolegët e tij. - Ngaqë kishte shumë dëshirë kirurgjinë, ndonëse s'u bë kurrë kirurg, shpesh herë ndodhte që grupet e tij të mësimit praktik t'i bëja unë, - tregon Dr. Fatmiri, - dhe ai shkonte të merrte pjesë në operacione deri në Berat, ku operonte kirurgu i talentuar Maksut Drrasa… Kishte qenë në fillim në Anatomi edhe Dr. Fiqiri Basha, por ai kishte kaluar në Anatomi Topografike. Kështu që në Anatominë Normale kishte mbetur vetëm Dr. Skënder Dauti. Pas tij erdhi Dr. Petro Papdhopulli nga Hungaria. Qe burrë i mirë dhe pedagog i zoti Dr. Petro, po ashtu Dr. Fiqiriu. Kështu pra, në fillim në Anatomi Normale kanë qenë Fiqiri Basha dhe Skënder Dauti. Më pas Dr. Fiqiriu kaloi tek Anatomia Topografike dhe në Anatominë Deskriptive-Normale, përveç Dr. Skënder Dautit erdhi Dr. Petro Papadhopulli. Në vitin 1957 erdhën dhe Dr. Klementina Llanga e Dr. Gazmend Velçani, nga kontigjenti i studentëve të porsambaruar të Institutit të Lartë Mjekësor. Më pas erdha unë, por qëndrova pak.... Dhe emërimet në Lëndën e Anatomisë vazhduan… - Kam ardhë pedagog në Lëndën e Anatomisë Normale në vitin 1961, pas një peripecie që lidhej me emërimin tim fillestar në Kardiologji tek Prof. Nikolla Shurbani - vazhdon të më tregojë Dr. Doda. - Por shpejt emërimi u ndryshua dhe përfundova në Anatomi. Jemi emëruar në Fakultetin e Mjekësisë në një kohë me Prof. Besim Elezi (Kirurgji) dhe Prof. Ilir Gjylbegu (Obstetrikë-Gjinekologji)". – Natyrisht, ardhja si pedagog në fakultet, direkt nga bankat e shkollës, lidhej në radhë të parë me rezultatet e larta në mësime – i them. - Siç do të ketë qenë dhe rasti juaj. Dhe Dr. Fatmiri me modestinë e tij e anashkalon këtë fakt me elegancë, por pranon atë që ndërkohë ishte student, ishte përgjegjës i grupit mësimor ku bënte pjesë, duke qenë kështu një përfaqësues i zgjedhur i tyre. Doktori vazhdon të më tregojë, për kohën që ai qëndroi si pedagog i Anatomisë Normale dhe më pas, për interpretime politike të kohës, u largua nga fakulteti dhe punoi për një kohë në Spitalin e Kukësit, si drejtor i këtij spitali dhe më tej në Tiranë, si Drejtues i Shërbimit Shëndetësor në Ndërmarrjen Bujqësore 'Gjergj Dimitrov" deri sa doli në pension. Dr. Fatmiri, përfundoi bisedën e tij me konsiderata vlerësuese për kolegët, ndërkohë që më foli shumë pak për vete…*

Drejtues i Departamentit të Morfologjisë
në Fakultetin e Mjekësisë



www.rruga earberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

GJITHMONË ME OFERTA...

Bigmarket

PESHKOPI MAQELLARË

DI ÇFARË ZGJEDH!